13 Parimi 12 i SIGMA-s: Legjislati është i njëjtë për nga struktura, stili dhe gjuha; kërkesat për hartimin e ligjeve zbatohen uniform në të gjitha ministrinë; legjislati publikohet për publikun. Treguesi WeBER i përdorur për monitorimin e këtij parimi në 2017/2018: Perceptimi i disponueshmërisë dhe qasjes së legjislatit dhe materialeve shpjeguese përkatëse nga shoqëria civile.

14 Anketa e OSHC-ve u administrua përmes një pyetësori anonim, në internet. Në Kosovë, aketa u zhvillua në periudhën nga 23 qershori deri më 4 gusht 2020. Metoda e mbledhjes së të dhënave përfshinte vetë-intervistim i ndihmuar nga kompjuteri (CASI). Mostra e anketësishte N = 49.

Treguesi i tretë mat transparencën e vendimmarrjes nga ana e Qeverisë (për sa i përket Këshillit të Ministrave), duke kombinuar të dhënat e anketës për perceptimet e shoqërisë civile me analizën e faqeve në internet të ministrave. Përveç publikimit të informacioneve për vendimet e Qeverisë, në analizën e faqeve të internetit shqyrtohen plotësia e informacionit, lehtësia e përdorimit nga qytetarët, afati kohor dhe vazhdueshmëria. Monitorimi u bë për secilën mbledhje të qeverisë në periudhën e gjashtë muajve - tre muajve të fundit të vitit kalendarik që i paraprinë monitorimit (2019) dhe tre muajve të parë në vitin e monitorimit (2020), me përjashtim të afateve kohore që maten krahas të gjitha mbledhjeve të qeverisë në periudhën prej tre muajsh nga fillimi i monitorimit (afërsisht nga fillimi i marsit deri në fillim të qershorit 2020).

Treguesi i katërt mat nëse institucionet publike ftojnë shoqërinë civile në përgatitjen e dokumenteve për politika të bazuara në prova dhe nëse faktet e përgatitura nga OSHC-të merren parasysh dhe përdoren në procesin e hartimit të politikave. Edhe këtu, për matjen kombinohen analiza e dokumenteve zyrtare nga ekspertët dhe një studim i të dhënave të shoqërisë civile. Në lidhje me të parën, shpeshësia e referimit të gjetjeve të bazuara në evidenca të OSHC-ve analizohet për dokumentet zyrtare të politikave pra dokumentet strategjike, koncept dokumentet dhe analizat e politikave të parapara dhe aktuale si dhe për vlerësimet e ndikimit për një model prej 3 fushave të politikave.¹⁵

Së fundi, treguesi i pestë, duke u fokusuar tek cilësia e përfshirjes së publikut në hartimin e politikave nëpërmjet konsultimeve publike, u modifikua në këtë cikël monitorimi për të përfshirë jo vetëm perceptimet e OSHC-ve të mbledhura nga zbatimi i anketës në internet, por edhe të dhëna shtesë cilësore përmes analizës të një shembulli të konsultimeve publike si dhe vlerësimi të portaleve qeveritare në internet të përdorura për konsultime publike. Më saktësisht, në këtë shtesë të Monitorimit të RAP treguesi u përmirësua me shtimin e analizës cilësore të fushëveprimit dhe ndikimit të konsultimeve publike mbi dokumentet e politikave dhe legjislacionin në periudhën prej gjashtë muajsh (gjysma e dytë e vitit 2019), disponueshmërinë dhe cilësinë e raportimit për konsultimet me publikun, funksionalitetet e portaleve të konsultimit publik dhe proaktivitetin e informimit nga institucionet përgjegjëse.

Rezultatet e monitorimit të WeBER

Parimi 5: Monitorimi i rregullt i performancës së qeverisë mundëson kontrollin publik dhe mbështet qeverinë në arritjen e objektivave të saj.

Treguesi i WeBER ZZHKP P5 I1: Publikimi i informacionit për performancën e qeverisë

Elementët e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2019/2020
Qeveria publikon rregullisht informacione me shkrim për veprimtarinë e saj	0/4	4/4
Informacioni i dhënë nga qeveria për veprimtaritë e saj shkruhet në mënyrë të kuptueshme	0/2	2/2
Në informacionin e dhënë nga qeveria ka detaje të mjaftueshme, përfshirë të dhënat sasiore dhe informacionin cilësi dhe vlerësime	0/2	4/4
Në informacionin e dhënë nga qeveria përfshihen vlerësime për arritjet me rezultate konkrete	0/4	2/4
Informacioni i dhënë nga qeveria për veprimtaritë dhe rezultatet e saj jepet në format të dhënash të hapura	0/2	0/2
Informacioni i dhënë nga qeveria për veprimtaritë dhe rezultatet e saj ka të dhëna që ndahen sipas gjinisë	0/2	0/2

¹⁵ Fushat e politikave ku një numër i konsiderueshëm i OSHC-ve punon në mënyrë aktive. Për Kosovën, tri fushat e zgjedhura të politikave janë administrata publike, zhvillimi ekonomik dhe antikorrupsioni.


Elementët e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2019/2020
Përqindja e raporteve të strategjive të qeverisë dhe planeve të saj që gjenden në internet	1/2	2/2
Rezultati i përgjithshëm	1/18	14/20
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5) ¹⁶	0	3

Vlerësimi jonë i reflektuar në elementët e treguesve të kësaj fushe bazohet në njoftimet për shtyp ndërmjet periudhës janar-dhjetor 2019, raportimin dy vjetor për punën e qeverisë dhe pjesën e raporteve për strategjitë dhe planet e qeverisë të cilat janë në dispozicion në internet. Qeveria e Kosovës publikon njoftime për shtyp në baza ditore për aktivitetet që janë zhvilluar, duke u bërë kështu një praktikë. Informacioni i paraqitur në njoftimet për shtyp është i kuptueshëm dhe shmang terminologjinë burokratike. Gjuha teknike mund të shihet vetëm kur i referohemi një dokumenti preciz (ligj, rregullore, etj.). Sa i përket raporteve vjetore për punën e Qeverisë, praktika e njëjtë si për njoftimet për shtyp nuk u mbajt. Bazuar në Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, neni 74 thotë që raporti i punës duhet të publikohet para datës 1 mars. Në nëntor të vitit 2019, Qeveria publikoi një raport të vetëm pune që mbulon periudhën kohore nga shtatori 2017 deri në korrik 2019. Duke marrë parasysh periudhën e raportimit, mund të konkludohet se raporti përfshin vetëm kohën kur ish-kryeministri Ramush Haradinaj ishte në detyrë dhe jo vitin 2017 në tërësi dhe as periudhën kur qeveria Haradinaj dha dorëheqje më 19 korrik dhe qeveria funksionoi si një qeveri në detyrë (në largim) deri në fund të muajit janar të vitit 2020. Duhet të theksohet se raporti është shkruar në një mënyrë të kuptueshme, përmban një përmbledhje menjëherë pas përmbajtjes e cila është e kuptueshme dhe nuk përmban terminologji shumë burokratike. Raporti përmban informacion sasior dhe cilësor duke përfshirë detaje në lidhje me objektivat, aktivitetet, masat dhe rezultatet e arritura, rezultatet e prodhuara, reformat dhe masat e ndërmarra, agjendën legjislative, rritjen e buxhetit, skemat sociale etj. Edhe pse vetë raporti është i shkarkueshëm, informacioni nga raporti nuk jepet në ndonjë format të hapur të të dhënave dhe ka disa informacione të veçanta nga raporti të përfshira në portalin kombëtar të të dhënave të hapura, për shembull të dhënat mbi kërkesat për qasje në dokumente publike. Por në përgjithësi, portalit i mungojnë shumica e të dhënave që përmenden në raport. Vlen të përmendet gjithashtu se raporti nuk përmban të dhëna të ndara gjinore. Lidhur me pjesëmarrjen në strategjitë/planet dhe raportet e tyre, gjetjet pasqyrojnë një boshllëk dhe një situatë që lë hapësirë për përmirësim. Qeveria shpërndau Programin për Reforma në Ekonomi 2020-2022 ku ka një përmbledhje për vitin 2019 nën zbatimin e politikave, një përmbledhje se si u zbatua buxheti i vitit 2019 dhe krahasimet/referimet për 2019 hasen në të gjithë dokumentin. Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) është publikuar në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme së bashku me raportin për zbatimin e tij. Strategjia Kombëtare e Zhvillimit është në dispozicion në faqen e internetit të qeverisë, por raporti për vitin 2019 apo edhe për vitin 2018 nuk janë në dispozicion në internet. Sa i përket Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2020-2022, ajo u botua në muajin prill 2019 dhe mbulon vitin 2018 dhe ofron një shpjegim për 2019 në të gjithë kapitujt. Sipas ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Llogaridhënies dhe gjithashtu siç është riformuluar në ligjin ndryshues, Qeveria duhet të paraqesë kornizat afatmesme të shpenzimeve në Kuvend deri më 30 prill. Si përfundim, Raporti i Punës i Qeverisë ishte dokumenti i vetëm për periudhën kohore nga shtatori 2017 deri në korrik 2019, në të cilin mungonte gjysma e dytë e vitit 2019. Vlera përfundimtare e treguesit u ndikua nga mungesa e një raporti të plotë dhe përmbushja e afateve sipas rregullores.

16 Konvertimi i pikëve: 0-5 pikë = 0; 6-10 pikë = 1; 11-15 pikë = 2; 16-20 pikë = 3; 21-25 pikë = 4; 26-30 pikë = 5

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi ZZHKP P5 I1: Publikimi i informacionit për performancën e qeverisë.



Treguesi i WeBER ZZHKP P5 I2: Perceptimi i shoqërisë civile për ndjekjen dhe arritjen nga qeveria të objektivave të saj të planifikuar


Elementët e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
OSHC-të mendojnë se dokumentet zyrtare të planifikimit të qeverisë kanë lidhje me zhvillimet aktuale në fushat e veçanta të politikave	0/2	0/2
OSHC-të mendojnë se Qeveria i raporton rregullisht publikut mbi progresin e arritjes së objektivave të përcaktuara	0/4	0/4
OSHC-të mendojnë se strategjitë zyrtare përcaktojnë veprimtarinë e qeverisë apo ministrive në fusha të caktuara të politikës	1/2	0/2
OSHC-të mendojnë se ministrinë publikojnë rregullisht raporte monitorimi për strategjitë e tyre sektoriale	0/4	0/4
OSHC-të mendojnë se prioritetet e anëtarësimit në BE integrohen ashtu siç duhet në dokumentet e planifikimit të qeverisë	0/2	0/2
OSHC-të mendojnë se raportet e qeverisë përfshijnë përditësimet e duhura për progresin e plotësimit të prioritetëve të anëtarësimit në BE	0/2	0/4
Rezultati i përgjithshëm	1/16	0/16
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5) ¹⁷	0	0

Rezultatet nga anketa tregojnë se OSHC-të kanë një perceptim negativ mbi punën e qeverisë, dhe nëse planifikon, monitoron dhe raporton në mënyrë aktive mbi punën e saj dhe përmes këtyre proceseve atëherë arrin objektivat që i ka premtuar publikut. Vetëm rreth 12% e të anketuarve shohin një lidhje midis zhvillimeve aktuale dhe planit të punës së Qeverisë dhe asnjë i anketuar nuk u përgjigj se ata "pajtohen plotësisht" për ekzistencën e një lidhjeje të tillë. Edhe më pak OSHC (5%) bien dakord që Qeveria raporton rregullisht tek publiku mbi progresin bazuar në planin e saj të punës - kurse 95% e të anketuarve që nuk ishin dakord që qeveria i raporton publikut për arritjet e saj mbi objektivat e përcaktuara në planin e saj të punës. Një qëndrim më pozitiv i OSHC-ve shihet kur pyeten nëse strategjitë zyrtare përcaktojnë veprimet e qeverisë ose ministrive në zona të caktuara (34% e të anketuarve ranë dakord). Sidoqoftë, një pjesë e vogël prej 7% e të anketuarve pajtohen që ministrinë publikojnë rregullisht raporte monitorimi për strategjitë e tyre sektoriale. Vlen të përmendet se 92% e të anketuarve nuk pajtohen që

17 Konvertimi i pikëve: 0-5 pikë = 0; 6-10 pikë = 1; 11-15 pikë = 2; 16-20 pikë = 3; 21-25 pikë = 4; 26-30 pikë = 5

ministrinë publikojnë rregullisht raportet e tyre për strategjitë sektoriale.

Figura 1. Perceptimi i OSHC-ve në lidhje me deklaratat e mëposhtme (%):



Shënim: Rezultatet janë rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt.
Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë duket se arrijnë deri në 100%
n=41

Pavarësisht nga Agjenda e Integritimit Evropian e Qeverisë, vetëm 12% e të anketuarve u pajtuan se prioritetet e procesit të anëtarësimit në BE janë integruar në mënyrë adekuate në planet e Qeverisë, dhe vetëm 7% ranë dakord që Qeveria përfshin azhurnimet e duhura për progresin ndaj grupit të prioritetëve për anëtarësim në BE në raportimin e saj.

Figura. Niveli i pajtimit të OSHC-ve me deklaratat e mëposhtme (%):


Declarata:	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	Neutral	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	Nuk e di
Prioritetet e procesit të anëtarësimit në BE janë integruar në mënyrë adekuate në planet e qeverisë.	7	34	41	7	5	5
Raportet e qeverisë përfshijnë azhurnimet e duhura për progresin ndaj grupit të prioritetëve të anëtarësimit në BE.	5	49	34	7	0	5

Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësura në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%

Numri i të anketuarve: N=49 n=41

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi ZZHKP P5 12: Perceptimi i shoqërisë civile për ndjekjen dhe arritjen nga Qeveria të objektivave të saj të planifikuara



Parimi 6: Vendimet e Qeverisë janë transparente dhe bazuar në gjykimin profesional të administratave sigurohet përshtatja ligjore e vendimeve

Treguesi i WeBER ZHKP P6 11: Transparenca e vendimmarrjes së Qeverisë

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
OSHC-të konsiderojnë se vendimmarrja e Qeverisë është në përgjithësi transparente	0/2	0/2
OSHC-të i konsiderojnë të përshtatshme përjashtimet nga rregullat e publikimit të vendimeve të Qeverisë	0/2	0/2
Qeveria i vë në dispozicion dokumentet nga mbledhjet e saj	2/4	2/4
Qeveria komunikon vendimet e saj në një mënyrë miqësore për qytetarët	4/4	4/4
Qeveria publikon dokumentet e miratuara në kohën e duhur	4/4	4/4
Rezultati i përgjithshëm	10/16	10/16
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5) ¹⁸	3	3

Gjetjet e këtij treguesi tregojnë se Qeveria i bën dokumentet pjesërisht të disponueshme në faqen e saj të internetit. Pas mbledhjeve javore, Qeveria publikon një komunikatë për media që përfshin një listë të vendimeve të marra, por rendi i ditës së takimeve dhe procesverbalet e takimeve nuk janë në dispozicion në internet. Procesverbalet e takimeve, bazuar në Rregulloren e Punës së Qeverisë (neni 23)¹⁹, konsiderohen konfidenciale.

Sa i përket vendimeve të miratuara, ato komunikohen në mënyrë të kuptueshme për qytetarët dhe me kohë (brenda një maksimumi prej një jave pas mbajtjes së mbledhjes). Përveç vendimeve të shpallura në njoftimin për shtyp, vendimet e hollësishme të Qeverisë publikohen në një seksion të veçantë në faqen e internetit të Qeverisë në seksionin e quajtur "Dokumente" nën "Vendimet e Mbledhjes së Qeverisë".

¹⁸ Konvertimi i pikëve: 0-5 pikë = 0; 6-10 pikë = 1; 11-15 pikë = 2; 16-20 pikë = 3; 21-25 pikë = 4; 26-30 pikë = 5

¹⁹ Rregullorja Nr. 09/2011 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3259>


Tabela: Vlerësimi i transparencës së vendimmarrjes së Qeverisë

Mbledhja nr.	Data	Rendi i ditës	Njoftimi për shtyp	Procesverbali i mbledhjes	Dokumentet/ vendimet
113	05.11.2019	JO	PO	JO	PO
114	26.11.2019	JO	PO	JO	PO
115	17.12.2019	JO	PO	JO	PO
116	10.01.2020	JO	PO	JO	PO
117	22.01.2020	JO	PO	JO	PO
118	29.01.2020	JO	PO	JO	PO
1	04.02.2020	JO	PO	JO	PO
2	12.02.2020	JO	PO	JO	PO
3	19.02.2020	JO	PO	JO	PO
4	28.02.2020	JO	PO	JO	PO
5	06.03.2020	JO	PO	JO	PO
6	10.03.2020	JO	PO	JO	PO
7	11.03.2020	JO	PO	JO	PO
8	12.03.2020	JO	PO	JO	PO
9	13.03.2020	JO	PO	JO	PO
10	14.03.2020	JO	PO	JO	PO
11	15.03.2020	JO	PO	JO	PO
12	17.03.2020	JO	PO	JO	PO
13	18.03.2020	JO	PO	JO	PO
14	20.03.2020	JO	PO	JO	PO
15	23.03.2020	JO	PO	JO	PO
16	26.03.2020	JO	PO	JO	PO
17	27.03.2020	JO	PO	JO	PO
18	28.03.2020	JO	PO	JO	PO
19	30.03.2020	JO	PO	JO	PO
20	31.03.2020	JO	PO	JO	PO

Burimi: <https://kryeministri-ks.net/>

Nga ana tjetër, përgjigjet e anketës së perceptimit të OSHC-ve tregojnë një rezultat mjaft të ndryshëm. Vetëm rreth 12% e të anketuarve ranë dakord që procesi i vendimmarrjes së Qeverisë është transparent, dhe asnjë i anketuar nuk u përgjigj se ata "pajtohen plotësisht". Në lidhje me atë nëse përjashtimet nga kërkesat për publikimin e vendimeve të Qeverisë janë të përshtatshme, vetëm rreth 5% e të anketuarve pajtohen që këto janë të përshtatshme, dhe asnjë i anketuar nuk u përgjigj se ata pajtohen plotësisht.


Figura. Perceptimi i OSHC-ve për transparencën e procesit të vendimmarrjes së Qeverisë (%)



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakosura në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të arrijnë deri në 100% N=49 n=41

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi ZHKP P6 I1: Transparenca e vendimmarrjes së Qeverisë



Parimi 10: Procesi i hartimit të politikave dhe hartimit ligjor është i bazuar në prova, dhe vlerësimi i ndikimit përdoret vazhdimisht në të gjitha ministrinë

Treguesi i WeBER ZHKP P10 I1: Përdorimi i provave të siguruar nga qendrat studimore, institucionet e pavarura dhe OSHC-të tjera në zhvillimin e politikave

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Frekuenca e referimit të gjetjeve të bazuara në prova të siguruar nga OSHC-të në dokumentet e miratuara të politikave qeveritare	2/4	2/4
Frekuenca e referimit të gjetjeve të bazuara në provat të siguruar nga OSHC-të në dokumentet e politikave dhe vlerësimeve të parapara të ndikimit	2/4	2/4
Pjesa e gjetjeve të bazuara në prova të siguruar nga një gamë e gjerë e OSHC-ve, siç janë qendrat kërkimore, institucionet e pavarura, organizatat me bazë lokale, referuar në analizat e politikave aktuale dhe vlerësimet e institucioneve qeveritare	0/2	0/2

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Ministritë përkatëse ose institucionet e tjera qeveritare ftojnë ose porosisin një gamë të gjerë të OSHC-ve, siç janë qendrat kërkimore, institucionet e pavarura, organizatat me bazë lokale, për të përgatitur studime të politikave, dokumente ose vlerësime të ndikimit për problemet ose propozimet specifike të politikave	1/2	2/2
Përfaqësuesit e ministrive përkatëse marrin pjesë në dialogun e politikave (diskutime, tryeza të rrumbullakëta, takime me dyer të mbyllura, etj.) që kanë të bëjnë me produkte specifike të hulumtimit të politikave.	2/2	2/2
Përfaqësuesit e një game të gjerë të OSHC-ve, siç janë qendrat kërkimore, institucionet e pavarura, organizatat me bazë lokale ftohen të marrin pjesë në grupe punuese/task forca për hartimin e politikave ose propozimeve legislative kur ata kanë propozime dhe rekomandime specifike të bazuara në prova	2/4	4/4
Ministritë përkatëse në përgjithësi ofrojnë informata kthyesë mbi propozimet dhe rekomandimet e bazuara në prova për një gamë të gjerë të OSHC-ve, siç janë qendrat kërkimore, institucionet e pavarura	0/2	0/2
Ministritë pranojnë propozimet e politikave të OSHC-ve në punën e grupeve punuese për zhvillimin e politikave dhe legjislacionit	2/4	2/4
Rezultati i përgjithshëm	11/24	14/24
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5) ²⁰	2	3

Në këtë tregues, tri fushat e zgjedhura të politikave ishin: Administrata Publike, Zhvillimi Ekonomik dhe Antikorrupsioni. Referencat e rastit të gjetjeve të bazuara në provat e siguruar nga OSHC-të u identifikuan në të tri fushat e politikave të analizuar, brenda strategjive nacionale qeveritare, dhe koncept dokumenteve të parapara të politikës. Në fushën e politikave të administrata publike kishte 6 strategji²¹, 4 koncept dokumente²² dhe 2 draft raporte/analiza aktuale të analizuar²³. Sa i përket fushës së zhvillimit ekonomik, kishte 5 strategji²⁴, 10 koncept dokumente²⁵ dhe 4 analiza të ndikimit/analiza²⁶ aktuale të analizuar. Në fushën e antikorrupsionit janë analizuar 1 strategji dhe 2 koncept dokumente²⁷. Në këtë fushë, nuk u gjetën analiza aktuale, vetëm vlerësime mbi mekanizmat anti-korrupsion dhe analiza të pajtueshmërisë me Standardet Ndërkombëtare kundër Korrupsionit. Në të gjitha dokumentet e përmendura më lart, kishte gjithsej 6 referenca të gjetjeve të bazuara në provat e siguruar nga OSHC-të. Në të njëjtën kohë, anketa e OSHC-ve tregon një perceptim disi pozitiv, megjithëse jo të kënaqshëm, në lidhje me praktikën e

20 Konvertimi i pikëve: 0-5 pikë = 0; 6-10 pikë = 1; 11-15 pikë = 2; 16-20 pikë = 3; 21-25 pikë = 4; 26-30 pikë = 5

21 1. Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikuar i Integruar) 2017-2021 (SPPKPK) 2. Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave (SRMF) 2016-2020 3. Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) e Kosovës 2016-2020 dhe Plani i Veprimit për Zbatimin e SRMFP 4. Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike (SMAP) dhe Plani i saj i Veprimit për Zbatimin e RAP; 5. Strategjia e Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik 2015-2019 (SKBFP) 6. Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0

22 1. Koncept Dokumenti për Organizimin e Administratës Publike të Republikës së Kosovës; 2. Koncept Dokumenti për Shërbimin Civil; 3. Koncept Dokumenti për Konkursin Administrativ; 4. Koncept Dokumenti i për Pagat e Paguara nga Buxheti i Republikës së Kosovës

23 1. Raporti: Analiza aktuale e Ligjit Nr. 04/L 003 për Shërbimin Civil; 2. Raporti: Analiza aktuale e Ligjit Nr. 04/L 139 për Procedurën Përmbartimore

24 Programi i Reformës Ekonomike të Kosovës 2020-2020 (PREK), Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021 (SKZH), Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftën kundër Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2021 dhe Plani i saj i Veprimit 2014-2021, Strategjia e Energjisë 2017-2026 dhe Plani i saj i Veprimit 2018-2020, Strategjia Minierare e Republikës së Kosovës 2012-2025, Plani Kombëtar për Burime të Energjisë (PKBE) 2011-2020

25 Koncept Dokumenti për Zhvillimin Ekonomik Lokal, Koncept Dokumenti për Ndërmarrjet Publike, Koncept Dokumenti për Ngritjen e Nivelit të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Bilanci Afatgjatë i Energjisë i Republikës së Kosovës 2015-2024, Koncept Dokument për Zonën Tregtare, Konceptit dokumenti për identifikimi elektronik, Koncept dokumenti për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, Koncept dokumenti në Fushën e Inspektimit, Koncept Dokumenti për Masat e Sigurisë së Rrjetit dhe Sistemeve të Informacionit, Koncept Dokumenti për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Lidhje me Transaksionet Elektronike.

26 Analiza e ndikimit të liberalizimit të tregtisë në shërbimet me vendet e CEFTA-s në sektorët e Transportit dhe Financave, Efektet e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit - BE: Ndikimi në Tregti, Projekt Raporti: Analiza aktual e Ligjit 04/L 048 për Tregtinë e Jashtme, Projekt Raporti: Analizë aktuale e Ligjit 2004/18 për Tregtinë e Brendshme

27 Strategjia Kombëtare kundër Korrupsionit 2019-2023, Koncept Dokumenti në Fushën e Procurimit Publik, Projekt Koncept Dokumenti për fushën e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë

bashkëpunimit ndërmjet institucioneve qeveritare dhe OSHC-ve.

Tabela 4. Frekuenca e referimit të gjetjeve të bazuara në prova e siguruar nga OSHC-të në strategjitë e miratuara qeveritare

Fusha e politikës	Numri i raporteve të OSHC-ve të cituara	Organizata dhe titulli i raportit
Administrata Publike		
Strategjia për Përmirësimin e Planifikimit dhe Koordinimit të Politikave në Kosovë (Sistemi i Planifikuar i Integruar) 2017-2021	0	
Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave	0	
Strategjia për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike	0	
Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike	0	
Strategjia për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik	0	
Strategjia për Rregullim më të Mirë 2.0 Zhvillimi Ekonomik	0	
Programi i Reformës Ekonomike të Kosovës 2020-2022	0	
Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021	0	
Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2021	0	
Strategjia Minierare e Republikës së Kosovës 2012-2025	0	
Plani Kombëtar i Burimit të Energjisë (PKBE) 2011 -2020	0	
Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare	1	Studimi i RIINVEST-it :“Business Perspective on Informality in Kosovo: To pay or not to pay”
Anti-korrupsioni		
Strategjia kundër Korrupsionit	1	Studimi i Institutit Demokratik të Kosovës “Vlerësimi i Sistemit Kombëtar të Integritetit në Kosovë”

Tabela 5. Frekuenca e referimit të gjetjeve të bazuara në provat e siguruar nga OSHC-të në koncept dokumentet e miratuara qeveritare.

Fusha e politikës	Numri i raporteve të cituara	Organizimi dhe titulli i raportit
Administrata Publike		
Koncept Dokumenti për Organizimin e Administratës Publike të Republikës së Kosovës	1	Raporti i Institutit GAP "Ndarja e Përgjegjësi në Inspektim ndërmjet Nivelit Qendror dhe Lokal" dhe Raporti "Inspektorët në Kosovë: organizimi dhe funksionimi"
Koncept Dokumenti për Shërbimin Civil	1	Raporti i Institutit GAP "Ndarja e Përgjegjësi në Inspektim ndërmjet Nivelit Qendror dhe Lokal" dhe Raporti "Inspektorët në Kosovë: organizimi dhe funksionimi"
Koncept Dokumenti për Konkursin Administrativ	0	
Koncept Dokumenti për Pagat e Paguara nga Buxheti i Republikës së Kosovës	1	Raporti i Institutit GAP "Ndarja e Përgjegjësi në Inspektim ndërmjet Nivelit Qendror dhe Lokal" dhe Raporti "Inspektorët në Kosovë: organizimi dhe funksionimi"
Zhvillimi Ekonomik		
5. Koncept Dokumenti për Zhvillimin Ekonomik Lokal	0	
6 Koncept Dokumenti për Ndërmarrjet Publike	0	
7. Koncept Dokumenti për Ngritjen e Nivelit të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit	0	
8. Koncept Dokumenti për Zonën Tregtare	0	
9 Koncept dokumenti për identifikim elektronik	0	
10. Koncept dokumenti për uljen e kostos së shtrirjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë	0	
11. Koncept dokument për fushën e inspektimit	0	Raporti i Institutit GAP "Ndarja e Përgjegjësi në Inspektim ndërmjet Nivelit Qendror dhe Lokal"
12. Koncept Dokumenti për Masat e Sigurisë së Rrjetit dhe Sistemeve të Informacionit	0	
13. Koncept Dokumenti për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Lidhje me Transaksionet Elektronike	0	
Anti-korrupsioni		
14. Koncept Dokumenti në Fushën e Prokurimit Publik	0	
15. Draft Koncept Dokumenti në fushën e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë	0	

Burimi: autori


Tabela 6. Frekuenca e referimit të gjetjeve të bazuara në provat e siguruar nga OSHC-të në analizën e paraparë qeveritare

Fusha e politikës	Numri i raporteve të cituara
Administrata Publike	
Projekt Raporti: Analiza aktuale e Ligjit Nr. 04/L 003 për Shërbimin Civil	0
Projekt Raporti: Analiza aktuale e Ligjit Nr. 04/L 139 për Procedurën Përmbartimore	0
Zhvillimi Ekonomik	
Analiza e ndikimit të liberalizimit të tregtisë në shërbimet me vendet e CEFTA-s në sektorët e Transportit dhe Financave	0
Efektet e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit - BE: Ndikimi në Tregti	0
Projekt Raporti: Analiza aktuale e Ligjit për Tregtinë e Brendshme	0
Projekt Raporti: Analiza aktuale e Ligjit 2004/18 për Tregtinë e Brendshme	0

Burimi: autori

Rezultatet tregojnë se institucionet qeveritare u drejtohen OSHC-ve për ekspertizën e tyre profesionale në mënyrë që të adresojnë probleme konkrete të politikave ose të zhvillojnë propozime të politikave (marrëveshje 50% ndërmjet OSHC-ve). Një pjesë e madhe e të anketuarve nga OSHC-të u përgjigjën se institucionet "shpesh" ose "gjithmonë" u përgjigjen ftesave të tyre për të marrë pjesë në dialogun politik (76%), por 54.7% e tyre thanë se institucionet ftojnë OSHC-të e tyre të marrin pjesë në grupe punuese/task forca për hartimin e politikave ose propozimeve legjislativë në fushat ku ata punojnë.


Figura. Perceptimi i OSHC-ve në lidhje me deklaratat e mëposhtme (%):



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt.
Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
N=49 n=41

Në lidhje me atë nëse institucionet japin përgjigje kthyesë për pranimin ose refuzimin e propozimeve dhe rekomandimeve të bazuara në provat e siguruar nga OSHC-të, vetëm 17% e të anketuarve u përgjigjën se institucionet ofrojnë një përgjigje kthyesë të tillë duke shpjeguar arsyet për vendimin e tyre. Së fundmi, rezultatet nga anketa e OSHC-ve tregojnë se më pak se një e treta e OSHC-ve të anketuara (31%) mendojnë se institucionet përgjithësisht marrin në konsideratë propozimet e tyre të politikave në punën e grupeve punuese për zhvillimin e politikave dhe legjislativës.


Figura. Perceptimi i OSHC-ve për përdorimin e provave të siguruara nga qendrat kërkimore, institucionet e pavarura dhe OSHC-të e tjera në zhvillimin e politikave (%)



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt.
Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
N=49 n=41

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi ZHKP P10 I1: Përdorimi i provave të krijuara nga qendrat kërkimore, institucionet e pavarura dhe OSHC-të tjera në zhvillimin e politikave



Parimi 11: Politikat dhe legjislati janë hartuar në një mënyrë gjithëpërfshirëse që mundëson pjesëmarrjen aktive të shoqërisë

Treguesi i WeBER ZHKP P11 I1: Perceptimi i shoqërisë civile dhe fushëveprimi i përfshirjes në politikëbërje

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Fushëveprimi i konsultimeve publike për dokumentet e politikave në administratën qendrore	1/4	n/a
Fushëveprimi i konsultimeve publike për legjislacionin në administratën qendrore	4/4	n/a
Disponueshmëria e raportimit për konsultimet publike për dokumentet e politikave nga administrata qendrore	0/4	n/a
Disponueshmëria e raportimit për konsultimet publike për legjislacionin nga administrata qendrore	4/4	n/a
Funksionaliteti themelor i një portali kombëtar të konsultimit publik	2/4	n/a
Funksionaliteti i avancuar i një portali kombëtar të konsultimit publik	1/2	n/a
Proaktiviteti i informimit për konsultimet publike	0/4	n/a
Përfshirja e konsultimeve të hershme publike në praktike	0/2	n/a
Cilësia e raportimit për konsultimet publike	1/2	n/a
Ndikimi i rezultateve të konsultimit publik në hartimin e politikave	1/2	n/a
OSHC-të konsiderojnë se procedurat zyrtare të konsultimit krijojnë parakushte për përfshirje me efektive të publikut në procesin e politikëbërjes.	1/2	2/4
OSHC-të konsiderojnë se procedurat zyrtare të konsultimit zbatohen në mënyrë të vazhdueshme	1/2	2/4
OSHC-të konsiderojnë se ato janë konsultuar në fazat e hershme të procesit të politikës	0/2	0/4
OSHC-të konsiderojnë se të konsultuarve u sigurohet në kohë informacion për përmbajtjen e propozimeve ose politikave legjislative	0/2	0/2
OSHC-të konsiderojnë se të konsultuarve u sigurohet informacioni i duhur për përmbajtjen e propozimeve ose politikave legjislative	0/2	0/2
OSHC-të konsiderojnë se ministritë sponsorizuese ndërmarrin veprime për të siguruar që larmia e interesave të përfaqësohet në proceset e konsultimit (grupet e grave, grupet e të drejtave të pakicave, sindikatat, shoqatat e punëdhënësve, etj.).	0/2	0/2
OSHC-të konsiderojnë se ministritë (sponsorët e politikave dhe propozimeve legjislative) ofrojnë informata kthyesë me shkrim për kontributet/komentet e të konsultuarve.	0/2	0/4
OSHC-të konsiderojnë se ministritë (sponsorët e politikave dhe propozimeve legjislative) pranojnë kontributet/komentet e të konsultuarve.	1/2	2/4
OSHC-të konsiderojnë se ministritë (sponsorët e politikave dhe propozimeve legjislative) zhvillojnë diskutime konstruktive se si pikëpamjet e të konsultuarve kanë formësuar dhe ndikuar në politikën dhe vendimin përfundimtar të Qeverisë	0/2	0/2
Rezultati i përgjithshëm	16/50	8/30
Vlera e treguesit (shkalla 0 - 5) ²⁸	1	1 ²⁹

Për shkak se gjatë periudhës së matjes Kosova kishte një qeveri në detyrë si rrjedhojë e dorëheqjes së ish kryeministrit Haradinaj, kishte mungesë të dokumenteve që do të bëheshin pjesë e analizës.

28 Konvertimi i pikëve: 0-5 pikë = 0; 6-10 pikë = 1; 11-15 pikë = 2; 16-20 pikë = 3; 21-25 pikë = 4; 26-30 pikë = 5

29 Shënim: vlerat nuk mund të krahasohen në këtë indikator për arsye që është ndryshuar metodologjia e monitorimit

Një nga arsyet kryesore për këtë mungesë dokumentesh ishin kompetencat e pashpjegueshme të një qeverie në detyrë e që vepron në mungesë të një ligji për qeverinë. Më 19 korrik 2019, Kryeministri i atëhershëm i Kosovës dha dorëheqje, duke e lënë Kosovën me një Qeveri në detyrë. Duke pasur parasysh këtë dhe kompetencat e pashpjegueshme në mungesë të një ligji për qeverinë, gjatë periudhës së matjes (gjysma e dytë e vitit 2019) nuk kishte asnjë dokument politikash të aprovuar nga Qeveria në detyrë përveç Strategjisë së Sigurisë së Republikës së Kosovës e cila u miratua në takimin e fundit të ish-Qeverisë (i njëjti takim ku dha dorëheqje Kryeministri). Strategjia në fjalë nuk ka kaluar nëpër procedurat e rregullta të parashikuara nga rregulloret, përfshirë këtu Rregulloren për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik³⁰, sepse kjo strategji, sipas kabinetit të Kryeministrit, plotëson kriteret për të qenë një përjashtim sipas kësaj rregulloreje. Sa i përket projektligjeve të miratuara nga Qeveria në gjysmën e dytë të vitit 2019, numri i projektligjeve të miratuar nga Qeveria ishte gjithashtu i ulët.

Sidoqoftë, u mbajtën konsultime, përveç rasteve kur Rregullorja për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit dikton të kundërtën. Konsultimet që u analizuan në këtë tregues janë: 1 Projektligji për Drogat, Substancat Narkotike dhe Substancat Psikotrope³¹, Projektligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat³².

Sidoqoftë, asnjë konsultim paraprak nuk u mbajt, bazuar në raportet përfundimtare të publikuara të konsultimit, të gjetura në Platformën për Konsultimet Publike. Jo të gjitha raportet përfundimtare të konsultimit që u publikuan përmbajnë: 1. të gjitha komentet dhe propozimet e paraqitura gjatë procesit të konsultimit publik të renditura individualisht, 2. Informacionin e qartë mbi komentet për secilin propozim individual 3. arsyen për refuzimin, ose miratim të pjesshëm dhe refuzim, të secilit propozim individual të paraqitur gjatë konsultimeve. Në përgjithësi, raportet përfundimtare të konsultimit publikohen, por jo në çdo rast. Rastet kur raportet nuk publikohen janë nëse një konsultim publik është aktualisht aktiv, në zhvillim e sipër, konsultimi do të përsëritet ose nëse Qeveria nuk e ka aprovuar dokumentin i cili ishte subjekt i konsultimeve publike. Në total, raportet e botuara të konsultimit që u analizuan përmbajnë 81 komente, dhe pak më shumë se gjysma u refuzuan, gjë që tregon se rezultatet e konsultimit kanë ndikim të moderuar në bërjen e politikave në Kosovë.

Vlen të përmendet se portali kombëtar i konsultimeve ka një bazë të dhënash të kërkueshme nga prilli i vitit 2017. Sa i përket kërkueshmërisë, platforma lejon këtë sipas këtyre kategorive: "emri i dokumentit", "periudha kohore" dhe "institucioni" por jo sipas llojit të dokumentit (p.sh. ligji, strategjia), përveç nëse specifikohet. Platforma gjithashtu ndahet në dy seksione: konsultime të mbyllura dhe të hapura. Rezultatet e anketës tregojnë se OSHC-të e shikojnë procesin e konsultimit publik të mangët sa i përket efektivitetit dhe bashkëpunimit.

Bazuar në përgjigjet, 45% e OSHC-ve konsiderojnë që procedurat zyrtare të konsultimit krijojnë parakushte për përfshirjen efektive të publikut në procesin e politikëbërjes dhe 36% u përgjigjën pozitivisht që institucionet qeveritare vazhdimisht zbatojnë procedurat zyrtare të konsultimit kur zhvillojnë politika brenda fushëveprimit të tyre. Sidoqoftë, vetëm 7% e OSHC-ve pohuan se institucionet përkatëse qeveritare konsultohen me OSHC-të në fazat e hershme të politikave dhe proceseve legislative para se të nxirret ndonjë draft dokument.

30 Rregullorja (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>

31 Konsultim i mbajtur përmes portalit të konsultimit publik: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40604>

32 Konsultim i mbajtur përmes portalit të konsultimit publik: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40552>

Figura. Institucionet përkatëse qeveritare konsultohen me OSHC-të në fazat e hershme të politikave ose proceseve legjislative (%)

Institucionet përkatëse qeveritare konsultohen me OSHC-të në fazat e hershme të politikave ose proceseve legjislative (para nxjerrjes së ndonjë projekt dokumenti).






Figura. Perceptimi i OSHC-ve lidhur me pjesëmarrjen e tyre në politikë dhe vendimmarrje (%)



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuara në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
N=49 n=42

Sa i përket deklaratës se “institucionet qeveritare japin me kohë informacion mbi përmbajtjen e propozimeve ose politikave legjislative gjatë procesit të konsultimit”, më pak se një e katërta e OSHC-ve bien dakord për këtë (23%). E njëjta përqindje (23%) pasqyrohet në deklaratën “institucionet qeveritare ofrojnë informacion të përshtatshëm për përmbajtjen e legjislacionit ose politikave gjatë konsultimit publik”.


Figura. Në procesin e konsultimit publik, institucionet qeveritare...



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt.
Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
N=49 n=42

Përveç kësaj, vetëm 7% e OSHC-ve ranë dakord që ministritë përkatëse “shpesh” ose “gjithmonë” sigurojnë që grupe të ndryshme të interesit të përfaqësohen në proceset e konsultimit publik (p.sh. gratë, pakicat, sindikatat, shoqatat e punëdhënësve, etj.). Për më tepër, vetëm 16% e të anketuarve të OSHC-ve deklaruan se ministritë përkatëse “shpesh” ose “gjithmonë” ofrojnë informatat kthyesë me shkrim për të konsultuarit nëse komentet e tyre pranohen ose refuzohen, dhe 32% pohuan që gjatë procesit të konsultimit ministritë përkatëse pranojnë komentet që vijnë nga organizata e tyre. Sa i përket zhvillimit të konsultimeve shtesë me OSHC-të jashtë fushës zyrtare të konsultimeve publike, një pjesë e vogël e të anketuarve (7%) deklaruan se institucionet përkatëse zhvillojnë konsultime të tilla shtesë.


Figura. Përvoja e OSHC-ve me pjesëmarrjen në vendimmarrje në nivelin e qeverisë qendrore (%)



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt.
Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
N=49 n=42

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi ZHKP P11 I1: Perceptimi i shoqërisë civile dhe fushëveprimi i përfshirjes në politikëbërje



3.3. Rezultatet përmbledhëse: Zhvillimi dhe Koordinimi i Politikave

Raportet për zbatimin e Planit Vjetor të Punës së Qeverisë (PVPQ) nuk u botuan rregullisht në internet gjatë kësaj periudhe të monitorimit. Analiza e përmbajtjes së raportit të PVPQ-së që ishte në dispozicion sugjeron që ato janë shkruar në një mënyrë të kuptueshme në një farë mase, por më shumë mbështetet në arritjet e Qeverisë dhe nuk janë shumë të lidhura me Planin Vjetor të Qeverisë. Raporti i PVPQ-së përmban informacione sasiore dhe cilësore, duke iu referuar arritjeve të Qeverisë, por nuk përfshin gjerësisht detaje rreth objektivave, aktiviteteve, masave dhe rezultateve konkrete, ndër të tjera.

Gjithashtu, vetëm 12.11% e OSHC-ve në Kosovë, që u përgjigjën në anketë, pajtohen që dokumentet zyrtare të planifikimit të Qeverisë janë të rëndësishme për zhvillimin aktual në fushat individuale të politikave. Po kështu, vetëm 4.87% janë dakord që Qeveria t'i raportojë rregullisht publikut mbi progresin e planit të punës. Nga ana tjetër, 34,17% e të anketuarve u përgjigjën se me të vërtetë strategjitë zyrtare përcaktojnë veprimet e qeverive ose ministrive në fusha të caktuara. Perceptimi i OSHC-ve tregon se vetëm 12.19% e të anketuarve pajtohen se procesi i vendimmarrjes është transparent.

Gjetjet e bazuara në prova të OSHC-ve referohen herë pas here në politikat zyrtare dhe dokumentet strategjike, dokumentet e politikave dhe vlerësimet e ndikimit të parashikuar edhe pse jo në secilën nga tri fushat e politikave të analizuar. Në të gjitha dokumentet e përmendura më lart, kishte 6 referenca të gjetjeve të bazuara në provat e siguruar nga OSHC-të, kryesisht në fushën e Zhvillimit Ekonomik.

Rezultatet e anketës së OSHC tregojnë se vetëm 6.81% bien dakord që institucionet përkatëse qeveritare konsultohen me OSHC-të në fazat e hershme të politikave dhe proceseve legjislativë para se të nxirret ndonjë projekt dokument, ndërsa gjysma e të anketuarve deklaruan "ndonjëherë". Përfaqësimi i grupeve të ndryshme të interesit në konsultimet publike nuk është siguruar pasi vetëm 6.81% e OSHC-ve deklarojnë se ato shpesh përfaqësohen. Për çështjen se sa institucionet publike (ministrinë) pranojnë komentet e OSHC-ve, 31.81% e OSHC-ve u përgjigjën me "shpesh" ose "gjithmonë" që gjatë procesit të konsultimit ministrinë përkatëse pranojnë komentet që vijnë nga organizata e tyre.

Sa i përket konsultimeve publike, dokumentet e analizuar në këtë monitorim ishin vetëm tri

për shkak të situatës politike të shkaktuar gjatë vitit 2019. Në deklarin në OSHC-të marrin parasysh se procedurat zyrtare të konsultimit krijojnë parakushte për përfshirjen efektive të publikut në procesin e politikëbërjes, 45.45% konsiderojnë se procedurat krijojnë përfshirje efektive të publikut. Por, ekziston një përqindje më e vogël kur bëhet fjalë për deklaratën nëse institucionet qeveritare vazhdimisht zbatojnë procedurat zyrtare të konsultimit kur zhvillojnë politika brenda fushës së tyre.

3.4. Rekomandimet për Zhvillim dhe Koordinim të Politikave

Evidentimi i rekomandimeve nga Monitorimi i RAP 2017/2108

Rekomandimi	Statusi	Komenti
1. Raportimi vjetor i PVPQ-së duhet të përmirësohet për të përfshirë rezultatet e dukshme të arritura në fusha të ndryshme të politikave në periudhën raportuese përfshirë informacionet përkatëse për dimensionet horizontale të politikave siç janë integrimin gjinor, mjedisin, zhvillimin e qëndrueshëm por pa u kufizuar vetëm në këto informacione.	I pazbatuar	Raporti vjetor i punës së qeverisë është publikuar në një dokument të vetëm për periudhën kohore shtator 2017 - korrik 2019. Përkatësisht raporti mbulon vetëm periudhën kohore që ish-Kryeministri Ramush Haradinaj ishte në detyrë dhe jo vitin 2017 si tërësi e as periudhën ndërmjet gushtit 2019 - janarit 2020 kur Qeveria Haradinaj ishte një Qeveri në detyrë pas dorëheqjes së tij. Sa i përket bazës ligjore, Rregullorja nr. 09/2011 për Punën e Qeverisë thotë se raporti i punës duhet të publikohet para 1 marsit. Kjo gjithashtu reflektohet në treguesin e ndërlidhur me këtë, i cili në krahasim me PAR Monitor e kaluar, rezultati ka rënë në mënyrë drastike.
2. Qeveria duhet të publikojë raporte në formatin e të dhënave të hapura për të lejuar përdorimin e mëtejshëm nga të gjitha palët e interesuara;	I zbatuar pjesërisht	Qeveria gjatë vitit 2019 dhe 2020 filloi publikimin e raporteve në formatin e të dhënave të hapura, ku mund të gjenden 205 grupe të dhënash. Akoma, institucionet publike duhet të vazhdojnë të vënë në dispozicion për publikun të dhënat pasi jo të gjithë e përdorin këtë format duke e bërë të pamundur përdorimin nga palët e interesuara.
3. Qeveria duhet të fillojë të publikojë rregullisht pikat e rendit të ditës dhe procesverbalet e takimeve për secilën mbledhje. Ndërsa preferohet të publikohet një agjendë para mbledhjes individuale, procesverbali, si dhe komunikatat për media duhet të publikohen me kohë, më së voni një javë pas takimit;	I pazbatuar	Qeveria nuk vazhdon të mos publikojë rendin e ditës dhe as procesverbalet e mbledhjeve. Pikat e rendit të ditës përmenden me raste në komunikatat për media të cilat publikohen pas mbledhjes së qeverisë. Komunikata për media publikohen gjithmonë në kohën e duhur.
4. Komunikatat për media duhet të publikohen ose të u bashkëngjiten materialet e tjera, kështu që të gjitha informacionet nga mbledhja individuale të mund të gjendet dhe të qasën në një faqe të vetme të internetit;	I pazbatuar	Në faqen zyrtare të Zyrës së Kryeministrit, komunikatat për media nuk kanë të bashkëngjitura materiale përcjellëse. Dokumentet nga mbledhja e qeverisë mund të gjenden në një seksion tjetër të faqes.
5. Struktura dhe dukshmëria i informacionit mbi mbledhjet duhet të rishikohen për qasje më të lehtë. Edhe pse ky informacion është i disponueshëm përmes ballinës së faqes kryesore, dukshmëria duhet të përmirësohet.	I pazbatuar	Informacioni në lidhje me njoftimet për shtyp është në dispozicion vetëm në ballinën e faqes kryesore.

<p>6. Ministritë dhe institucionet e tjera publike që organizojnë konsultime publike (dhe debate publike), duhet të ndjekin afatet kohore dhe të jenë proaktive në shpalljen e njoftimeve të tyre. Kjo pasi që duhet pasur parasysh që duhet kohë për përgatitjet e shoqërisë civile dhe të palëve tjera të interesit. Të gjitha kanalet në dispozicion duhet të përdoren për të njoftuar për konsultimet - përfshirë faqet e internetit të organit përgjegjës, Platformën e Konsultimeve Publike dhe mediat sociale të të gjitha institucioneve të përfshira;</p>	<p>I zbatuar pjesërisht</p>	<p>Ekziston një numër i vogël i rasteve ku ministritë dhe institucionet tjera publike njoftojnë për konsultimet publike përmes faqeve të tyre në internet.</p>
<p>7. Në këtë drejtim, mbajtja dhe përditësimi i regjistrave të organizatave të shoqërisë civile dhe individëve të cilët më parë kanë marrë pjesë në konsultime dhe debate publike duhet të praktikohet, duke siguruar që organizatat dhe individëve tashmë të angazhuar dhe të interesuar të ftohen.</p>	<p>I zbatuar pjesërisht</p>	<p>Përditësimi i të dhënave të organizatave të shoqërisë civile dhe individëve është i pranishëm, megjithatë një numër institucioneve publike nuk sigurojnë vazhdimësinë e ftimit të OSHC-ve, individëve, etj., tashmë të angazhuara ose të interesuar.</p>
<p>8. Gjatë organizimit të konsultimeve, kontributet dhe komentet nga shoqëria civile dhe publiku duhet të kërkohen sa më shpejt të jetë e mundur në proces, dhe mundësisht në fazën e formulimit të politikës;</p>	<p>I zbatuar pjesërisht</p>	<p>Këtu është parë një trend pozitiv, megjithëse institucionet publike duhet të sigurojnë vazhdimësinë e kësaj praktike të mirë dhe institucioneve që nuk e aplikojnë këtë, duhet ta përvetësojnë këtë praktikë.</p>
<p>9. Për më tepër, institucionet publike duhet pa përjashtim të informojnë pjesëmarrësit për procedurën e konsultimit, qoftë ai debat publik për projekt dokumente apo konsultime të zhvilluara më parë. Më fjalë tjera, pavarësisht nga llojet e raporteve të konsultimit (online, fizikisht), raportet e konsultimit duhet të publikohen në secilin rast, duke adresuar secilin koment dhe duke dhënë shpjegime për pranimin ose refuzimin e tyre. Në këtë mënyrë i gjithë procesi është lehtësisht i gjurmueshëm, transparent dhe i qartë nga fillimi deri në fund;</p>	<p>I zbatuar pjesërisht</p>	<p>Ndonëse ka pasur përmirësime, institucionet duhet të vazhdojnë të bëjnë përpjekje të vazhdueshme në publikimin e raporteve të konsultimit dhe përdorin të gjitha kanalet në mënyrë që të sigurohet informimi i pjesëmarrësimitmbi procedurat e konsultimit si dhe të adresojnë komentet e marra.</p>
<p>10. Konsultimi shtesë duhet të konsiderohet në secilin rast kur procesi i konsultimit mbetet i pazgjidhur, i kontestuar, në çështje veçanërisht të rëndësishme për shoqërinë civile dhe publikun. Një praktikë e tillë mund të rrisë besimin në proces dhe cilësinë e zgjidhjeve të miratuara përfundimisht;</p>	<p>I zbatuar pjesërisht</p>	<p>Ky rekomandim konsiderohet i zbatuar pjesërisht pasi që një praktikë e tillë duhet të ndodhë në të gjitha institucioneve publike dhe për të gjitha rastet kur nevojitet konsultim shtesë.</p>
<p>11. Baza e të dhënave në internet e legjislacionit (Gazeta Zyrtare) duhet të promovohet përmes faqeve të internetit të organeve të administratës qeveritare dhe individuale, mundësisht përmes ballinave që lehtësisht vizitohen. Ndonëse e qasshme dhe pa pagesë në faqen e internetit të Gazetës Zyrtare, ndërgjegjësimi për këtë bazë të dhënash duhet të përmirësohet për të arritur që ata që janë të interesuar ta shfletojnë sa më shumë.</p>	<p>I zbatuar pjesërisht</p>	<p>Një numër i organeve të administratës qeveritare dhe individuale kanë një link në faqen e tyre të internetit që shpie në Gazetën Zyrtare, por kjo nuk vlen për çdo faqe në internet të institucioneve publike.</p>

3.5. Rekomandimet e Monitorimit të RAP 2019/2020:

Raportimi vjetor mbi Planin e Punës së Qeverisë duhet të hartohet dhe publikohet në përputhje me kornizën ligjore. Struktura duhet të përmirësohet për të përfshirë rezultate të dukshme të arritura në fusha të ndryshme të politikave në periudhën e raportimit, duke përfshirë informacionin përkatës mbi dimensionet horizontale të politikës, siç janë por pa u kufizuar në integrimin gjinor, mjedisin, zhvillimin e qëndrueshëm.

- 1) Qeveria (të gjitha institucionet publike) duhet të vazhdojnë të publikojnë raporte në formatin e të dhënave të hapura për të lejuar përdorimin e mëtejshëm nga të gjitha palët e interesuara.
- 2) Qeveria duhet të fillojë të publikojë rregullisht pikat e rendit të ditës para mbledhjes individuale;
- 3) Komunikatave për media duhet të u bashkëngjiten materialet e tjera (nëse ka), kështu që të gjitha informacionet të mund të gjenden dhe të qasen në një vend.
- 4) Struktura dhe paraqitja e informacionit për mbledhjet duhet të ndryshohet për qasje më të lehtë. Megjithëse ky informacion është në dispozicion përmes ballinës së faqes kryesore, dukshmëria duhet të përmirësohet.
- 5) Ministritë dhe institucionet e tjera publike duhet të vazhdojnë të organizojnë konsultime publike (dhe debate publike), duhet të ndjekin afatet kohore dhe reagimin në njoftimin e tyre. Kjo do të thotë se duhet të kushtohet mjaft kohë për përgatitjet e shoqërisë civile dhe palëve tjera të interesit, dhe të gjitha kanalet në dispozicion duhet të përdoren për të njoftuar për konsultimet - duke përfshirë faqet e internetit të organit përgjegjës, Platformën e Konsultimeve Publike dhe mediat sociale të të gjitha institucioneve të përfshira;
- 6) Mbajtja dhe përditësimi i regjistrave të organizatave të shoqërisë civile dhe individëve të cilët më parë kanë marrë pjesë në konsultime dhe debate publike duhet të praktikohet në mes të të gjitha institucioneve, duke siguruar vazhdimësinë e ftimit të organizatave dhe individëve tashmë të angazhuar dhe të interesuar;
- 7) Gjatë organizimit të konsultimeve, kontributet dhe komentet nga shoqëria civile dhe publiku duhet të inkuadrohen sa më shpejt të jetë e mundur në proces, dhe mundësisht në fazën e formulimit të politikës, nga të gjitha institucionet publike;
- 8) Për më tepër, autoritetet pa përjashtim duhet të informojnë pjesëmarrësit për procedurat e konsultimit, qofshin ato debate publike për draft dokumente apo konsultime të zhvilluara më parë. Me fjalë të tjera, pavarësisht nga llojet e konsultimit (online, ballë për ballë) raportet e konsultimit duhet të publikohen në secilin rast, duke adresuar secilin koment, dhe duke dhënë shpjegime për pranimin ose refuzimin e tij;
- 9) Konsultimi shtesë duhet të konsiderohet në secilin rast kur procesi i konsultimit mbetet i pazgjidhur, i kontestuar, për çështje veçanërisht të rëndësishme për shoqërinë civile dhe publikun;
- 10) Baza e të dhënave në internet e legjisllacionit (Gazeta Zyrtare) duhet të promovohet përmes faqeve të internetit të organeve të administratës qeveritare dhe individuale, mundësisht përmes ballinave kryesore.

The background features a large, abstract geometric shape in the upper right corner, composed of a light blue triangle and a darker blue triangle. A thick orange border follows the diagonal edge of the darker blue triangle. The rest of the background is white.

4. SHËRBIMI PUBLIK DHE MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

4.1. Treguesit e WeBER të përdorur në Shërbimin Civil dhe Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe vlerat e vendit për Kosovën

P2_I1: Disponueshmëria publike e të dhënave dhe raporteve zyrtare në lidhje me shërbimin civil dhe punonjësit në administratën shtetërore qendrore					
0	1	2	3	4	5
P2_I2: Kryerja e detyrave nga nëpunësit civilë jashtë sistemit të bazuar në meritat e shërbimit civil					
0	1	2	3	4	5
P3_I1: Sinqeriteti, transparenca dhe paanësia e rekrutimit në shërbimin civil					
0	1	2	3	4	5
P4_I1: Ndikimi direkt ose indirekt politik në pozitat e larta drejtuese në shërbimin publik					
0	1	2	3	4	5
P5_I1: Transparenca, qartësia dhe disponueshmëria publike e informacionit mbi sistemin e shpërblimit të shërbimit civil					
0	1	2	3	4	5
P7_I1: Efektiviteti i masave për promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në shërbimin civil					
0	1	2	3	4	5

4.2. Gjendja aktuale në Shërbimin Civil dhe Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Korniza ligjor për rregullimin e shërbimit publik dhe menaxhimin e burimeve njerëzore nisi hapat e saj fillestar me miratimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe Ligjit për Pagat në shkurt të vitit 2019. Fatkeqësisht, të dyja këto ligje u pezulluan nga Gjykata Kushtetuese pasi Institucioni i Avokatit të Popullit i kundërshtoi ato. Gjykata Kushtetuese në qershor të vitit 2020 vendosi që Ligji për Pagat ishte antikushtetues, ndërsa Ligji për Zyrtarët Publikë kishte nevojë për ndryshime legislative. E gjithë kjo situatë u shoqërua nga bashkimi i Ministrisë së Administratës Publike me Ministrinë e Punëve të Brendshme duke shkaktuar vonesë në zhvillimin e kapaciteteve për të përmirësuar sistemin e ri të nëpunësve civilë të përcaktuar me Ligjin për Zyrtarët Publikë.³³

Strategjia e Modernizimit të Administratës Publike 2015-2020 (SMAP) që u miratua së bashku me një Plan Veprimi, caktoi përmirësimin e shërbimit civil si objektivin e parë strategjik. Përmes kësaj strategjie, Ministria e Administratës Publike (tani e bashkuar me Ministrinë e Punëve të Brendshme) ka rritur kompetencat për sistemin e shërbimit civil. Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil (DASHC), në kuadër të MAP është organi kryesor administrativ përgjegjës për koordinimin e zbatimit të politikave të shërbimit civil. Njësitë për planifikim strategjik dhe menaxhim të burimeve njerëzore, DASHC dhe MBNJ, nuk kanë kapacitete zbatuese dhe Sistemi Informativ i MBNJ (SIMBNJ) nuk është zhvilluar plotësisht³⁴. Monitorimi i sistemit të shërbimit civil kryhet nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (KPM), që gjithashtu nuk ka kapacitet³⁵. Për më tepër, ky këshill, gjatë gjithë vitit 2019, ka qenë pothuajse jofunksional për shkak të mos emërimit të anëtarëve nga Kuvendi i Kosovës. Në këtë mënyrë, ka rezultuar në zvogëlimin e të drejtave të palëve për mjete juridike efektive, dhe orientimin e palëve për të ushtruar mjetet e tyre mbrojtëse përmes gjykatës.

Procesi i plotësimit të kornizës ligjore duke plotësuar dhe ndryshuar legjislacionin për shërbimin civil (nëpunës civil), administratën publike dhe pagat është akoma në vazhdim. Kryesisht, ky proces rrjedh si një domosdoshmëri për të adresuar pengesat e gjetura gjatë zbatimit. Këto

33 Komisioni Evropian (2020), "Raporti për Kosovën 2020", Komunikimi mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së për vitin 2020

34 GLPS (2018), "Raporti i Monitorimit të RAP 2017-18". Informacioni është ende relevant për periudhën e raportimit 2019/20

35 Ibid.

pengesa janë identifikuar dhe paraqitur nga vlerësimet e jashtme, dhe për shkak se një kornizë e konsoliduar ligjore e PAR kërkohet nga kriteret e MSA-së në fushën e administratës publike (neni 120 i MSA-së).

Shtirja horizontale e shërbimit civil përcaktohet në Ligjin për Shërbimin Civil (LSHC)³⁶ dhe përfshin pothuajse të gjitha institucionet që kanë funksione të autoritetit publik. Sidoqoftë, ka ende institucione dhe agjenci të pavarura të mbetura jashtë sistemit të shërbimit civil³⁷. Nga ana tjetër, shtirja vertikale është e qartë për sa i përket menaxhmentit të lartë, ndërsa një mungesë qartësie është vërejtur në disa funksione të mbështetjes jo-administrative. Pozitat e larta përbëhen nga Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, Sekretarët e Ministrive dhe Kryeshefat Ekzekutivë dhe pozitat ekzekutive ekuivalente, agjencitë e pavarura dhe rregullatore³⁸. Procedurat e hollësishme për emërimin në pozita të larta drejtuese përcaktohen nga Rregullorja Nr. 17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil në Kosovë. Kjo rregullore hyri në fuqi në vitin 2018, duke zëvendësuar Rregulloren nr. 06/2010. Ndonëse procedurat për emërimin e nëpunësve të lartë civilë u përmirësuan, gjithashtu me këtë rregullore, ndikimi politik në emërimet e tilla mbetet ende një shqetësim serioz, së bashku me nën-përfaqësimin e grave në këto pozita.³⁹

Fushëveprimi horizontal dhe vertikal i LSHC është i qartë edhe pse fushëveprimi horizontal është i mangët për shkak të përjashtimit arbitrar të nëpunësve të Doganave të Kosovës, Policisë së Kosovës dhe Inspektoratit Policor nga ky ligj nga Kuvendi i Kosovës. Si pasojë, nëpunësit e këtyre institucioneve nuk janë regjistruar si nëpunës civilë.

Rekrutimi i nëpunësve civilë sipas LSHC-së duhet të bëhet në bazë të meritës. Pozitat në kategoritë administrative, profesionale dhe të nivelit të lartë drejtues janë të hapura për të gjithë kandidatët pa përjashtim, ndërsa pozitat në kategorinë e menaxhmentit mund të jenë të hapura për kandidatë të jashtëm nëse nuk ka kandidatë të brendshëm të kualifikuar dhe meritorë⁴⁰.

Procedurat e hollësishme për emërimin në pozita të larta drejtuese përcaktohen nga Rregullorja Nr. 17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në Shërbimin Civil në Kosovë. Kjo rregullore hyri në fuqi në vitin 2018, duke zëvendësuar Rregulloren nr. 06/2010.

Siç u përmend më lart, deri më sot, nuk ka asnjë legjislacion që siguron rregulla të përbashkëta për nëpunësit publikë që nuk i nënshtrohen LSHC-së, d.m.th. autoritetet publike (për shembull, zyrtarët policor, zyrtarët doganore, zyrtarët korrektues), ofrimin e shërbimeve publike (shëndetësia, arsimi dhe shërbimet sociale) ose në funksione mbështetëse. Si rezultat, as legjislacioni specifik dhe as Ligji i Punës nuk zbatohen në praktikë.

Ligji i ri për Zyrtarët Publik (LZP)⁴¹ synon të luftojë pikërisht këtë çështje. Më saktësisht, ligji i ri synon të "krijojë një regjim homogjen për nëpunësit civilë të angazhuar në ushtrimin e autoritetit publik të parashikuar nga ligji dhe të cilët kanë përgjegjësinë për të mbrojtur interesin e përgjithshëm të shtetit, dhe ku paanësia e nëpunësve civilë është e nevojshme për të mbrojtur më mirë të drejtat individuale dhe për të legjitimuar pritjet e qytetarëve dhe bizneseve"⁴². Për më tepër, ligji synon, ndër të tjera, të vendosë rregulla minimale punësimi për punonjësit e shërbimit publik, punonjësit e kabinetit dhe personelin ndihmës. Aktualisht nuk ka rregulla ligjore që përcaktojnë marrëdhëniet e tyre të punës dhe dispozitat e Ligjit të Punës kanë qenë joadekuate. LZP gjithashtu synon të rregullojë lëvizjen brenda "kategorisë funksionale" për kategorinë e menaxhmentit të ulët dhe të mesëm përmes procedurave transparente, konkurruese dhe të

36 Ligji për Shërbimin Civil është referuar në këtë kapitull sepse kjo periudhë raportuese përfshin edhe vitin 2019, vit në të cilin Ligji për Shërbimin Civil ishte ende në fuqi. Ky ligj është ende relevant në lidhje me nenet që mund të ndryshojnë në Ligjin për Zyrtarët Publikë për shkak të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

37 Raporti i Monitorimit të SIGMA-s për Kosovën 2017.

38 Rregullorja nr. 17/2018 për Procedurat për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta Drejtuese në SH të RKS, neni 2. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18301>

39 Komisioni Evropian (2020), "Raporti për Kosovën 2020", Komunikimi mbi Politikën e Zgjerimit të BE-së për vitin 2020

40 LSHC, neni 18

41 Disa nene të këtij ligji për zyrtarët publikë do t'i nënshtrohen ndryshimeve për shkak të gjetjeve të Gjykatës Kushtetuese se të njëjtat nene nuk janë në përputhje me Kushtetutën. Prandaj, Kuvendi i Kosovës duhet të bëjë ndryshimet e nevojshme.

42 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=25839>

bazuara në merita. Ky ligj pritet të rrisë pritjet e zhvillimit të karrierës për nëpunësit civilë dhe të përmirësojë cilësinë e vetë administratës. Aktualisht, bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil, Kosova ka një sistem të decentralizuar të rekrutimit sipas të cilit secili institucion është përgjegjës për procedurat e rekrutimit. Ligji i ri përcakton mundësinë për "rekrutime në grup dhe të centralizuara" për administratën shtetërore të nëpunësve civilë, i cili përfshin një gamë më të gjerë të pozitave në shërbimin civil dhe e bën më të lehtë menaxhimin e përditshëm.

Megjithatë, ky ligj hyri në fuqi në 12 shtator 2019, por ai u kundërshtua nga Institucioni i Avokatit të Popullit në Gjykatën Kushtetuese në nëntor të të njëjtë vit.

Procesi i klasifikimit të vendeve të punës, nga ana tjetër, është në një fazë të avancuar dhe deri në mars të vitit 2017, rreth 80% e pozitave të shërbimit civil janë klasifikuar sipas katalogut⁴³. Sistemi i pagave siç përcaktohet në Ligjin Nr. 03/L-147, i cili edhe pse zyrtarisht është në fuqi, nuk është zbatuar ende. Për më tepër, nuk ka arritur të adresojë çështjen e pagave në të gjithë sektorin publik, dhe si i tillë, sistemi i pagesave që ekziston aktualisht është rregulluar kryesisht bazuar në aktet nënligjore. Si rezultat, janë identifikuar ndryshime të mëdha në pagat mesatare për të njëjtat pozita, veçanërisht ndërmjet ministrive dhe agjencive dhe institucioneve të pavarura. Për këtë arsye, sistemi nuk ofron të njëjtën pagë për të njëjtën punë, edhe pse është vendosur klasifikimi standard për nëpunësit civilë.

Për më tepër, nuk ka asnjë bazë ligjore për rregullimin e pagës bazë për kategoritë e tjera të përfituesve të pagës, jashtë përcaktimit të nëpunësit civil. Paga bazë në këto raste rregullohet kryesisht nga akte organizative dhe funksionale ose në shumicën e rasteve me akte nënligjore dhe në mungesë të tyre rregullohet nga Udhëzimi Administrativ i UNMIK-ut i vitit 2000, i cili tashmë është i vjetruar dhe joadekuat.⁴⁴ Baza ligjore në lidhje me shtesat në pagën bazë gjithashtu mungon. Projektligji i ri për pagat synon të sigurojë një qasje më homogjene ndaj çështjes së pagave dhe shtesave në të gjithë sektorin publik. Duke vepruar kështu, ai synon të rregullojë sistemin e pagave për të gjithë sektorin publik, si dhe të vendos rregullat e përcaktimit të pagës minimale për punonjësit e ndërmarrjeve publike në Kosovë. Sidoqoftë, Institucioni i Avokatit të Popullit e kundërshtoi këtë ligj në Gjykatën Kushtetuese disa ditë pas hyrjes së tij në fuqi në dhjetor të vitit 2019.

4.3. Çfarë monitoron WeBER dhe si?

Monitorimi i WeBER në kuadër të fushës së SHPMBNJ-së përshin pesë Parime të SIGMA-s dhe lidhet ekskluzivisht me administratën qendrore (qendra e institucioneve qeveritare, ministrinë, organet vartëse dhe organizatat e veçanta). Me fjalë të tjera, monitorimi përfshin shërbimin civil të qeverisë qendrore, siç përcaktohet nga legjislacioni përkatës (kryesisht Ligji për Shërbimin Civil). Parimet e zgjedhura janë ato që përqendrohen në cilësinë dhe zbatimin praktik të kornizave dhe politikave ligjore të shërbimit civil, në masat që lidhen me rekrutimin e bazuar në merita, përdorimin e angazhimeve të përkohshme, transparencën e sistemit të shpërblimit, integritetin dhe anti-korrupsionin në shërbimin civil. Qasja WeBER u bazua në elemente në të cilët SIGMA nuk përqendrohet fuqimisht në monitorimin e saj, por që janë domethënës për shoqërinë civile nga perspektiva e transparencës së sistemit të shërbimit civil dhe hapjes së qeverisë, ose disponueshmërisë publike të të dhënave për zbatimin e politika e shërbimit civil.

Parimet e mëposhtme të SIGMA-s u zgjedhën për monitorim, në përputhje me kriteret e zgjedhjes së WeBER:

Parimi 2: Politikat dhe kornizat ligjore për një shërbim publik profesional dhe koherent përcaktohen dhe zbatohen në praktikë; struktura institucionale mundëson praktika të qëndrueshme dhe efektive të menaxhimit të burimeve njerëzore në tërë shërbimin publik.

43 Raporti i Monitorimit të SIGMA-s për Kosovën 2017. Në dispozicion në: <http://www.sigmaweb.org/publications/Analysis-of-the-professionalisation-of-the-senior-civil-service-and-the-way-forward-for-the-Western-Balkans-SIGMA-Paper-55-May-2018.pdf>

44 Po aty

- Parimi 3:** Rekrutimi i nëpunësve publikë bazohet në merita dhe trajtim të barabartë në të gjitha fazat e tij; kriteret për uljen në detyrë dhe shkarkimin e nëpunësve publikë janë të qarta.
- Parimi 4:** Ndikimi direkt ose indirekt politik në pozitat e larta drejtuese në shërbimin publik
- Parimi 5:** Sistemi i shpërblimit të nëpunësve publikë bazohet në klasifikimin e vendeve të punës; është i drejtë dhe transparent.
- Parimi 7:** Masat për promovimin e integritetit, parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e disiplinës në shërbimin publik janë në dispozicion.

Monitorimi i këtyre parimeve kombinon gjetjet e vlerësimit të SIGMA-s brenda nën-treguesve specifik. Megjithatë, duke pasur parasysh që nuk ka vlerësim të SIGMA-s për vitin 2020, hulumtuesit e WeBER-it kryen llogaritjen e tyre të nën-treguesve të SIGMA-s në këtë cikël të PAR Monitor, në bazë të metodologjisë së SIGMA-s. SIGMA/OECD nuk mund të mbahet përgjegjës për rezultatin e llogaritjes së tillë, por vetëm autorët e këtij raporti.

Përveç kësaj, monitorimi bazohet në rishikimin profesional nga WeBER të legjislacionit, dokumenteve dhe faqeve të internetit, duke përfshirë mbledhjen dhe analizën e të dhënave administrative qeveritare, raporteve dhe dokumenteve të tjera të kërkuara në internet ose të kërkuara përmes kërkesave për të drejtën e informimit. Për të krijuar një qasje më të ekuilibruar cilësore dhe sasiore, hulumtimi përfshiu matjen e perceptimeve të nëpunësve civilë, OSHC-ve dhe publikut të gjerë duke përdorur anketa të perceptimit. Së fundi, mbledhja e të dhënave përfshiu intervista gjysmë të strukturuar ballë për ballë dhe grupe fokusi me palë të rëndësishme të interesit si p.sh. nëpunës të lartë civilë, ish-nëpunës të lartë civilë dhe ish-kandidatë për punë në shërbimin civil, si dhe përfaqësues të institucioneve qeveritare përgjegjës për politikën e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Anketat e nëpunësve civilë dhe OSHC-ve në gjashtë administratat e Ballkanit Perëndimor u zbatuan duke përdorur një mjet të anketimit në internet, ndërmjet gjysmës së dytë të qershorit dhe fillimit të gushtit 2020.⁴⁵ Anketat e nëpunësve civilë u shpërndanë në shumicën e administratave përmes një pike të vetme kontakti me origjinë nga institucionet kombëtare përgjegjëse për sistemin e përgjithshëm të shërbimit civil.⁴⁶ Anketa e OSHC-ve u shpërnda përmes rrjeteve ekzistuese dhe platformave të organizatave të shoqërisë civile me baza të dhënash të mëdha kontakti, por edhe përmes pikave të kontaktit të centralizuara si zyrat qeveritare të ngarkuara për bashkëpunimin me shoqërinë civile.⁴⁷ Për të siguruar që anketa e OSHC-ve kishte në shënjestër sa më shumë organizata sa i përket llojit të tyre, shpërndarjes gjeografike dhe zonave të veprimtarisë, dhe në këtë mënyrë të kontribuojë në përfaqësimin sa më shumë të jetë e mundur, u bë një shtim shtesë ku ishte e nevojshme. Së fundi, anketa e perceptimit të publikut përfshiu intervistimin personal të ndihmuar nga kompjuteri të publikut të gjerë (të moshës 18 vjeç e lart) të rajonit të Ballkanit Perëndimor, gjatë periudhës 5 maj - 30 maj 2020.⁴⁸ Në të tri anketat, WeBER aplikoi pyetësorë unik në tërë rajonin dhe i shpërndau në gjuhët lokale, duke siguruar një qasje të barabartë në zhvillimin e anketës.

WeBER përdor gjashtë tregues për të matur pesë parimet e përmendura më lart. Në treguesin e parë, WeBER monitoron disponueshmërinë publike të të dhënave zyrtare dhe raporteve në lidhje me shërbimin civil dhe punonjësit në administratën shtetërore qendrore. Në treguesin e dytë, monitorimi përfshin shkallën në të cilën procedurat e angazhimit të përkohshëm të zbatuara gjerësisht minojnë regjimin e bazuar në merita. Sinqeriteti, transparenca dhe paanësia e rekrutimit

45 Anketat u administruan përmes një pyetësori anonim online. Metoda e mbledhjes së të dhënave përfshinte VINK (vetë-intervistim i ndihmuar nga kompjuteri). Në Kosovë, anketa e nëpunësve civilë dhe anketa e OSHC-ve u zhvilluan në periudhën nga 24 qershor deri më 4 gusht 2020.

46 Për Kosovën, mostra e anketës ishte N=221. Baza për pyetjet brenda Parimit 2 ishte n=189 të anketuar, Parimi 3 kishte n=221 të anketuar, Parimi 5 kishte n=169 të anketuar dhe Parimi 7 kishte n=197 të anketuar.

47 Për Kosovën, mostra e anketës ishte N=49. Baza për pyetjet brenda zonës së SHP&MBNJ ishte n=41 të anketuar.

48 Perceptimet janë hulumtuar duke përdorur një anketim që synon publikun (të moshës 18 vjeç e lart) e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Anketa e perceptimit të publikut përdori një mostër të probabilitetit në shumë faza dhe është administruar duke kombinuar intervistimin në internet dhe telefon të ndihmuar nga kompjuteri (CAWI dhe CATI), duke përdorur një pyetësor të standardizuar përmes anketave të omnibusit në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni Veriore, Mali i Zi, dhe Serbi nga 5 maji - 30 maj 2020.

në shërbimin civil, si një aspekt veçanërisht kritik i MBNJ në administratën publike për shkak të karakterit të tij me të cilin përballet publiku, shqyrtohet brenda treguesit të tretë. Treguesi i katërt përqendrohet në parandalimin e ndikimit politik direkt dhe indirekt në pozitat e larta drejtuese në shërbimin publik, ndërsa treguesi i pestë analizon nëse informacioni mbi shpërblimin e shërbimit civil është transparent, i qartë dhe në dispozicion të publikut. Së fundi, në treguesin e gjashtë, WeBER shqyrton promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në shërbimin civil.

4.4. Rezultatet e monitorimit të WeBER

Parimi 2: Politikat dhe korniza ligjore për një shërbim publik profesional dhe koherent përcaktohen dhe zbatohen në praktikë; struktura institucionale mundëson praktika të qëndrueshme dhe efektive të menaxhimit të burimeve njerëzore në të gjithë shërbimin publik;

Treguesi i WeBER SHPMBNJ P2_I1: Disponueshmëria publike me të dhënat zyrtare dhe raportet në lidhje me shërbimin civil dhe të punësuarit në administratën qendrore të shtetit

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Qeveria mban të dhëna të besueshme që kanë të bëjnë me shërbimin publik	0/4	2/4
Qeveria publikon rregullisht të dhënat themelore zyrtare që kanë të bëjnë me shërbimin publik	0/4	0/4
Të dhënat zyrtare të publikuara përfshijnë të dhëna për punonjësit e tjerë përveç nëpunësve civilë me orar të plotë në administratën qendrore të shtetit	0/4	0/4
Të dhënat zyrtare të publikuara për shërbimin publik veçohen në bazë të strukturës gjinore dhe asaj etnike	0/2	1/2
Të dhënat zyrtare të publikuara janë në dispozicion në formatin(et) e të dhënave të hapura	0/1	0/1
Qeveria raporton në mënyrë gjithëpërfshirëse mbi politikën e shërbimit publik	0/4	4/4
Qeveria raporton rregullisht mbi politikën e shërbimit publik	0/2	2/2
Raportet mbi shërbimin publik përfshijnë informacion të bazuar në lidhje me cilësinë dhe/ose rezultatet e punës së shërbimit publik	0/2	1/2
Informatat për shërbimin civil promovohen aktivisht në publik	0/2	0/2
Rezultati i përgjithshëm	0/25	10/25
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5)	0	2

Rezultatet sugjerojnë se Kosova pikë më të ulëta në këtë tregues nga 10 prej 25, në 0 prej 25 në elementin e parë të WeBER në lidhje me besueshmërinë e të dhënave që kanë të bëjnë me shërbimin publik. Të dhënat për shërbimin civil raportohen si pjesë e Raporteve Vjetore për Gjendjen e Shërbimit Civil në Kosovë. Ndryshe nga Monitorimi i RAP i viteve 2017-18, raportet e monitorimit këtë herë janë marrë përmes të drejtës së informimit të dërguar nga organizata jonë. Që nga bashkimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Administratës Publike, faja e internetit ishte shumë jofunksionale, deri më sot (16 korrik 20). Raportet e vitit 2017 dhe 2018 na u dërguan nga zyrtarë brenda Ministrisë së Administratës Publike. Raporti i vitit 2019 sipas zyrtarëve është përgatitur, por nuk mund të shpërndahet tek palët e treta pasi që nuk është i votuar nga qeveria. Kjo nuk është e përcaktuar me ligj, por është një praktikë e kësaj ministrie. Si pasojë, kjo praktikë e ka dëmtuar transparencën e administratës publike dhe duhet të modifikohet.

Sa i përket të dhënave, që kanë të bëjnë me opinionin publik, duhet të theksohet se baza e të dhënave ekziston (SIMBNJ) por nuk është në dispozicion për publikun. Shpërndarja e SIMBNJ bëhet në të gjitha institucionet që kanë qasje në rrjetin qeveritar. Institucionet janë duke punuar në një bazë të dhënash shtesë që do të shërbejë për publikun. Analiza e raporteve të vitit 2017

dhe 2018 tregon se ekziston një praktikë e raportimit të të dhënave për numrin e punonjësve rregullisht në një nivel të përgjithshëm sipas kategorisë funksionale. Të dhënat në raport nuk raportohen sipas institucionit (për këtë shkak nuk u shpërblyen me asnjë pikë). Të dhënat ndahen bazuar në gradën e punëdhënësve, nivelin (qendror ose komunal), gjininë, përkatësinë etnike dhe arsimin. Ndryshe nga Monitorimi i RAP 2017-18, raportet për këtë kohë të monitorimit ndahen në nivelit të funksioneve (gradës) që mbajnë punëdhënësit.

Të dhënat për rekrutimin e nëpunësve të rinj civilë bazuar në kategoritë e të punësuarve përfshihen vetëm nga nëpunësit me orar të plotë dhe emërimet me kohë të caktuar. Vlen të përmendet se në raporte kritikohen shumë procedurat e rekrutimit duke argumentuar se në procedura injorohet faktori i arsimit dhe përvojës.


Për sa i përket raportimit mbi politikën e shërbimit civil, raportet e vitit 2017 dhe 2018 përfshijnë planifikimin dhe rekrutimin, zhvillimin e karrierës, trajnimet, masat disiplinore dhe vlerësimet.

Raportet në përgjithësi ofrojnë informacion të përgjithshëm mbi cilësinë dhe rezultatet e shërbimit publik, por ato nuk janë të orientuara kah përmbajtjet të mbushura me dëshmi dhe burime të pavarura. Të dhënat vjetore nuk vihen në dispozicion në format të hapur dhe nuk promovohen në mënyrë aktive për publikun përmes mediave sociale ose njoftimeve për shtyp.

Për shkak të mungesës së faqes së internetit, raportet duhej të kërkoheshin përmes të drejtës së informimit, gjë që merrte kohë të konsiderueshme. Raporti i vitit 2019 nuk u dërgua pasi që nuk ishte i aprovuar nga qeveria edhe pse nuk ka një ligj të tillë. Kjo praktikë ka dëmtuar transparencën e administratës publike.

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi i WeBER SHPMBNJ P2_I1: Disponueshmëria publike me të dhënat zyrtare dhe raportet në lidhje me shërbimin civil dhe punonjësit në administratën qendrore të shtetit



Treguesi i WeBER SHPMBNJ P2_I2: Kryerja e detyrave karakteristike për shërbimin civil jashtë regjimit të bazuar në meritat e shërbimit civil

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Numri i angazhimeve të përkohshme për kryerjen e detyrave karakteristike të shërbimit civil në administratën qendrore të shtetit është i kufizuar me ligj	0/4	0/4
Ekzistojnë kritere specifike të përcaktuara për përzgjedhjen e individëve për angazhime të përkohshme në administratën shtetërore	0/4	0/4

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Procedura e punësimit për individët e angazhuar me kontrata të përkohshme është e hapur dhe transparente	4/4	4/4
Kohëzgjatja e kontratave të angazhimit të përkohshëm është e kufizuar	4/4	4/4
Nëpunësit civilë e perceptojnë që angazhimet e përkohshme në administratë janë një përjashtim	1/2	0/2
Nëpunësit civilë e perceptojnë se kryerja e detyrave karakteristike të shërbimit civil nga individët e punësuar në baza të përkohshme është një përjashtim	0/2	0/2
Nëpunësit civilë e perceptojnë që emërimet në baza të përkohshme në administratë bazohen në merita	0/2	0/2
Nëpunësit civilë e perceptojnë se rregullat zyrtare për emërimet në baza të përkohshme zbatohen në praktikë	1/2	1/2
Nëpunësit civilë e perceptojnë që individët e punësuar në baza të përkohshme vazhdojnë të bëhen nëpunës civilë pas përfundimit të kontratave të tyre	0/2	0/2
Nëpunësit civilë e perceptojnë që kontratat për angazhime të përkohshme zgjaten për më shumë se një vit	0/2	0/2
Rezultati i përgjithshëm	10/25	9/28
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5)	2	1

Korniza ligjore nuk e specifikon një limit sa i përket numrit të angazhimeve të përkohshme; ndërsa për kriteret specifike për përzgjedhjen e individëve nuk ka ndonjë saktësim në ligj në lidhje me angazhimet e përkohshme të ekspertëve në administratë. Megjithëse ligji nuk e kufizon numrin e angazhimeve të përkohshme dhe nuk përcakton kriteret specifike, ai kufizon emërimet me afat të caktuar deri në 6 muaj sipas kontratave të quajtura marrëveshje për shërbime të veçanta (MSHV- ose të njohura si kontratë mbi vepër). Sidoqoftë, në praktikë, këto dispozita nuk janë respektuar gjithmonë në institucionet publike. Me Ligjin e ri për Zyrtarët Publikë, marrëveshjet e veçanta të shërbimit janë të vlefshme deri në afatin e përcaktuar në kontrata. Pas kësaj periudhe, marrëveshja për shërbime të veçanta lidhet në përputhje me legjislacionin përkatës të prokurimit publik. Nga ana tjetër, procedurat e punësimit për individët e angazhuar me kontrata të përkohshme kanë mbetur të njëjta, duke ndjekur të njëjtat praktika nëpër institucionet e marra si mostër të transparencës dhe hapjes si procedura të rregullta të punësimit në shërbimet civile. Si i tillë, informacioni në lidhje me shpalljen e konkursit, kërkesat/kompetencat, përshkrimi i vendit të punës, shpërblimi, procedurat e përzgjedhjes, afati i dorëzimit dhe informacioni i qartë që duhet të dorëzohet janë në dispozicion në shpalljen e konkursit publik në të gjitha institucionet e marra si model. Sidoqoftë, emërimet me afat të caktuar rregullohen me ligj dhe kufizohen në 6 muaj sipas kontratave mbi vepër, ndërsa pozitat jo-të karrierës të nëpunësve civilë që konsiderohen gjithashtu me kohë të caktuar, mund të kenë një kohëzgjatje deri në 2 vite. Kur njerëzit punësohen në baza të përkohshme, nga radhët e nëpunësve civilë 13.75% mendojnë se "shpesh" ose "gjithmonë" përzgjedhja bazohet në kualifikime dhe aftësi, duke treguar një rënie nga 21.4% të monitorimit të fundit. 65% mendojnë se ata përzgjedhje "rrallë" ose "asnjëherë nuk kanë ndodhur" të jenë bazuar në kualifikim ose aftësi. Nëpunësit civilë ndahen ndërmjet atyre që "shpesh"/"gjithmonë" me 37% dhe "asnjëherë"/"rrallë" me 36,5% sikur rregullat zyrtare për punësimin e njerëzve në baza të përkohshme të zbatoheshin në praktikë. Monitorimi i fundit tregoi se 41.7% mendonin për rastin "shpesh" dhe "gjithmonë", duke treguar një rënie të lehtë. Anketa e këtij viti e monitorimit të nëpunësve civilë mbi deklaratën se "punësimi i individëve në baza të përkohshme është një përjashtim në institucionin tim nga 19.2% monitorimi i fundit shënoi një rritje në 30.15% të nëpunësve që "pajtoheshin" ose "pajtoheshin plotësisht" ndërsa 44.44% nuk ishin pajtoheshin dhe nuk pajtoheshin aspak.


Figura. Niveli i pajtueshmërisë së nëpunësve civilë me deklaratën:



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuara në numrin e plotë më të afërt.
 Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
 Baza për anketën mbi SHC N=221 n=189


Për sa i përket asaj nëse individët të cilët janë punësuar në baza të përkohshme kryejnë detyra të cilat normalisht duhet të kryhen nga nëpunësit civilë, 23.8% përgjigjen “asnjëherë” ose “rrallë”, dhe 53.4% mendojnë të kundërtën. Më shumë se gjysma – 59.7% e nëpunësve civilë mendojnë se kontratat e angazhimeve të përkohshme zgjaten për më shumë se një vit, dhe vetëm për 15.87% “rrallë” dhe “asnjëherë” duket se ndodh kështu. Individët e punësuar në baza të përkohshme vazhdojnë të bëhen nëpunës civilë pas përfundimit të kontratës së tyre 34.9% mendojnë se ndodh “gjithmonë” dhe “shpesh” ndërsa 27.51% “rrallë” dhe “asnjëherë”.

Figura. Perceptimi i nëpunësve civilë mbi shpeshtësinë e praktikave të mëposhtme të vërejtura në institucionin ku ata punojnë (%)




Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuara në numrin e plotë më të afërt.
 Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
 Baza për anketën mbi SHC N=221 n=189

Figura. Perceptimi i nëpunësve civilë përkitazi me deklaratat vijuese:



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt.
Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
Baza për anketën mbi SHC N=221 n=189




Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt.
Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
Baza për anketën mbi SHC N=221 n=189

Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik që do të shfuqizonte Ligjin për Shërbimin Civil, është shpallur antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese në disa nene të caktuara për agjenci dhe institucione të pavarura pas dy masave për pezullim të këtij ligji. Këto nene që Gjykata Kushtetuese i gjeti si jo kushtetuese, do t'i dërgohen Kuvendit të Kosovës, i cili është institucioni kompetent në lidhje me rregullimin e tyre.

Në fillim të ciklit të monitorimit në janar të vitit 2020, Gjykata Kushtetuese nuk vendosi për kushtetutshmërinë mbi Ligjin për Zyrtarët Publikë, prandaj monitorimi u bazua në Ligjin për Shërbimin Civil, gjithashtu shpalljet e rekrutimeve që janë analizuar në procesin e monitorimit mbajnë datat e vitit 2019 dhe janë bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil. Ligji për Shërbimin Civil nuk shfuqizohet për shkak të ndryshimeve që institucionet kompetente duhet t'u nënshtrohen për të përmbushur kërkesat në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi i WeBER SHPMBNJ P2_I2: Disponueshmëria publike me të dhënat dhe raportet zyrtare në lidhje me shërbimin civil dhe punonjësit në administratën qendrore të shtetit



Parimi 3: Rekrutimi i nëpunësve publikë bazohet në merita dhe trajtim të barabartë në të gjitha fazat e tij; kriteret për uljen në detyrë dhe shkëputjen e marrëdhënies së punës të nëpunësve publikë janë të qarta;

Treguesi i WeBER SHPMBNJ P3 I1: Sinqeriteti, transparenca dhe drejtësia e rekrutimit në shërbimin civil

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Informatat në lidhje me konkurset publike vihen gjerësisht në dispozicion të publikut	2/4	2/4
Njoftimet për konkurset publike shkruhen me gjuhë të thjeshtë, të qartë dhe të kuptueshme.	2/4	2/4
Gjatë procedurës së konkursit publik, kandidatët e interesuar mund të kërkojnë dhe marrin sqarime, të cilat vihen në dispozicion të publikut	2/4	2/4
Nuk ka pengesa të paarsyeshme për kandidatët e jashtëm, që t'i bëjnë konkurset publike më lehtë të arritshme për kandidatët e brendshëm.	2/2	2/2
Procedura e aplikimit imponon barrë minimale administrative dhe të dokumenteve për kandidatët.	0/4	0/4
Kandidatët lejohen dhe ftohen të plotësojnë dokumentacionin që mungon brenda një afati të arsyeshëm.	0/4	0/4
Vendimet dhe arsyetimet e paneleve të përzgjedhjes vihen në dispozicion të publikut, me respektin e duhur për mbrojtjen e informacionit personal	2/4	2/4
Informacioni në lidhje me njoftimet e anuluar vihet në dispozicion të publikut, me arsyetimi i dhënë.	2/4	2/4
Nëpunësit civilë perceptojnë rekrutimin në shërbimin civil si të bazuar në merita	0/4	0/2
Nëpunësit civilë perceptojnë procedurën e rekrutimit që siguron mundësi të barabartë	1/4	1/2
Publiku percepton rekrutimit e bërë nëpërmjet procesit të konkursit publik si të bazuar në merita	1/4	0/2
Rezultati i përgjithshëm	14/36	13/36
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5)	2	2


Rekrutimi në Shërbimin Civil rregullohet me Rregulloren 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Teksti i njoftimit të konkursit të hapur, përmbajtja e shpalljes, vendimet, dhe formulari i aplikimeve dhe disponueshmëria publike e njoftimit dhe e vendimeve rregullohen në përputhje me Rregulloren 02/2010 në fuqi. Rregullorja përcakton që institucioni përkatës duhet të sigurojë që të gjitha shpalljet e rekrutimit në çdo formë publikimi të jenë të lehta për t'iu qasur gjatë kohëzgjatjes së shpalljes. Shpalljet e rekrutimit publikohen në shtypin ditor dhe në mediat elektronike brenda 5 ditëve të punës. Shpalljet e rekrutimit duhet të publikohen në portalin qeveritar dhe në portalin e institucionit përkatës. Në atë masë, sa të gjitha institucionet e marra si model i publikojnë shpalljet e konkurseve publike në faqet e tyre përkatëse në internet. Pesë institucionet e marra si model i publikojnë konkuset e tyre publike në faqet e tyre të internetit, dhe në disa raste, si në shembullin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Zyrës së Kryeministrit, njoftimet publikohen edhe në gazetatat ditore. Ky është një ndryshim nga Monitori i RAP 2017-18. Në ciklin e fundit të monitorimit, të gjitha institucionet e marra si model i publikuan thirrjet e tyre të rekrutimit, në faqet e internetit dhe në gazeta. Sidoqoftë, duhet të theksohet se me ligj kërkohet vetëm publikimi në faqet përkatëse të internetit. Asnjë njoftim i konkursit publik nuk u gjet në portalin qeveritar, që përbën shkelje të Rregullores në fjalë, njësoj si në Monitorimin e fundit të RAP. Gjetjet tona tregojnë gjithashtu se sqarimet për njoftimin janë të mundshme dhe ofrohen në praktikë, por përgjigjet nuk vihen në dispozicion të publikut në një vend të caktuar qartë në internet.

Përmbajtja e njoftimit të konkursit publik, është kryesisht e njëtrajtshme brenda institucioneve të marra si model dhe respekton nenin 16 të Rregullores. Në të gjitha institucionet e marra si model, teksti i konkurseve publike hartohet në gjuhë të thjeshtë dhe të qartë në aspektin se përmban të gjitha informacionet relevante. Aty përfshihet përshkrimi i shkurtër i vendit të punës, një listë e detyrave dhe e përgjegjësisë, kualifikimet profesionale të kërkuara për pozitën dhe dokumentin(et) që duhet t'i bashkëngjiten aplikimit. Kështu ka ndodhur edhe në Monitorimin e fundit të RAP.

Për më tepër, gjetjet tona tregojnë se shpallja e konkursit publik nuk përmban asgjë nga ato që metodologjia i konsideron si pengesa të paarsyeshme për kandidatët e jashtëm. Procesi i aplikimit është i organizuar në tri faza, me të gjitha dokumentet që do të sigurohen dhe dorëzohen nga kandidati paraprakisht në të gjitha institucionet e marra si model, në këtë fazë të parë. Dy fazat e tjera janë testet dhe intervistat dhe nuk kërkojnë dokumente shtesë. Rregullorja 02/2010 përcakton që kandidatët për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme: 1) formularin e aplikimit, 2) kopjet e diplomave të fituara në institucionet arsimore të bashkangjitura në aplikacion, 3) kopjet e dëshmive të punësimit (për kandidatët që nuk janë pjesë e Shërbimit Civil) ose kopjet e të dhënave të punësimit nga regjistri i shërbimit civil, 4) kopjet e dy raporteve të fundit rresht për vlerësimin e performancës (për nëpunësit civilë dhe personelin ekzistues të punësuar në institucione). Në të gjitha institucionet e marra si model, përveç Ministrisë së Drejtësisë, përmenden faza të tjera të ekzaminimit. Tekstet e institucioneve të marra si model, tregojnë se vetëm kandidatët e përzgjedhur në listë të ngushtë do të kontaktohen nga institucioni për të vazhduar në fazën tjetër. Rregullorja 02/2010 nuk parashikon një afat kohor brenda të cilit kandidatëve u lejohet t'i plotësojnë dokumentet që mungojnë. Njësoj si në Monitorin e RAP 2017-18. Pas përfundimit të suksesshëm të procedurës së aplikimit, vendimet e përzgjedhjes janë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të institucioneve përkatëse në të gjitha institucionet e marra si model, por ofrohet vetëm informacion i pjesshëm. Nëse anulohet një njoftim për konkurs të hapur, hulumtimi tregon se një vendim i tillë bëhet publik në të gjitha institucionet. Sidoqoftë, arsyetimi i dhënë nuk është gjithmonë i duhuri.

Përkundër faktit që institucionet në përgjithësi u përmbahen procedurave të rekrutimit, rezultatet e anketës të nëpunësve civilë shfaqin një nivel të konsiderueshëm skepticizmi sa i përket efektivitetit të procedurave të tilla në aspektin e përmbajtjes së këtyre procedurave. Vetëm 22.17% e nëpunësve civilë "pajtohen plotësisht" dhe "pajtohen" që punonjësit e administratës rekrutohen në bazë të kualifikimeve dhe të aftësive. Përqindja e Monitorimit të fundit të RAP-it ishte 24.1%. 14.9% e anketës së nëpunësve civilë pajtohen se për të marrë një vend pune në shërbimin civil në institucionin tim duhet të keni lidhje, është interesante se kjo përqindje në monitorimin e fundit ishte 17%.

Figura. Perceptimi i nëpunësve civilë në lidhje me emërimin e kolegëve të tyre është të paktën se ata/ato pjesërisht emërohen falë mbështetjes politike



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
Base for CS survey N=221 n=171

Rezultatet e anketës në pyetjen sa i përket procedurës së rekrutimit për nëpunësit civilë në institucionin tim, të gjithë kandidatët trajtohen në mënyrë të barabartë (pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, ose një tipar tjetër personal që mund të jetë bazë për diskriminim të padrejtë) 30.76% pajtohen ose pajtohen plotësisht. Ndërsa më shumë se gjysma 53,38% nuk pajtohen ose nuk pajtohen aspak. 38% e qytetarëve ndajnë mendimin se nëpunësit publikë rekrutohen përmes konkurseve publike bazuar në merita (d.m.th., kandidatëve më të mirë u mundësohet të marrin vendet e punës). Kjo është një rritje e lehtë nga monitorimi i fundit, ku kjo përqindje ishte 24.4%.

Figura. Ju lutemi tregoni shkallën në të cilën pajtoheni ose nuk pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: Nëpunësit publikë rekrutohen përmes konkurseve publike bazuar në merita (d.m.th. kandidatëve më të mirë u mundësohet t'i marrin vendet e punës).

Ju lutemi tregoni shkallën në të cilën pajtoheni ose nuk pajtoheni me deklaratën e mëposhtme: Nëpunësit publikë rekrutohen përmes konkurseve publike bazuar në merita (d.m.th. kandidatëve më të mirë u mundësohet t'i marrin vendet e punës)






Figura. Niveli i pajtueshmërisë së nëpunësve civilë me deklaratat e mëposhtme, pasqyron përvojën e tyre në institucionin ku ata punojnë



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuara në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100% Baza për aketën mbi SHC N=221 n=189

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi P3_I1: Sinqeriteti, transparenca dhe drejtësia e rekrutimit në shërbimin civil



Parimi 4: Ndikimi politik i drejtpërdrejtë ose i tërthortë në pozitat e larta drejtuese në shërbimin publik parandalohet


Treguesi i WeBER SHPMBNJ P4_I1: Mbrotjtja efektive e pozitës së nëpunësve të lartë civilë nga ndërhyrjet e padëshiruara politike

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Ligji përshkruan procedura konkurruese, të bazuara në merita, për zgjedhjen e drejtuesve të lartë në shërbimin civil.	2/2	1/2
Ligji përshkruan kritere objektive për shkëputjen e punësimit të nëpunësve të lartë civilë.	0/2	0/2
Rekrutimi i bazuar në merita i nëpunësve të lartë civilë zbatohet në mënyrë efektive në praktikë.	0/4	0/4

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Ushtruesit e detyrës të pozitës së drejtuesve të lartë, mund të përcaktohen me ligj, dhe emërohen vetëm nga radhët e shërbimit civil për një periudhë maksimale të kufizuar me Ligj.	2/4	2/4
Raporti i kandidatëve të kualifikuar për vendet e lira të nivelit të lartë.	0/4	0/4
Nëpunësit civilë konsiderojnë se procedurat për emërimin e nëpunësve të lartë civil sigurojnë që kandidatët më të mirë të marrin vendet e punës.	0/2	0/2
Është perceptim i OSHC-ve se procedurat për emërimin e nëpunësve të lartë civil sigurojnë që kandidatët më të mirë i marrin vendet e punës	0/2	0/2
Është perceptim i nëpunësve civilë se nëpunësit e lartë civilë emërohen bazuar në mbështetjen politike	0/2	0/2
Ekzistenca e procedurave të verifikimit ose këshillimit për emërimet e nëpunësve të lartë civilë jashtë fushës së legjislacionit të shërbimit civil.	2/2	2/2
Nëpunësit civilë konsiderojnë se nëpunësit e lartë civilë nuk do të zbatojnë dhe mund të refuzojnë në mënyrë efektive urdhrat e paligjshëm të eprorëve politikë.	0/2	0/2
Nëpunësit civilë konsiderojnë se pozitat e larta të shërbimit civil nuk u nënshtrohen marrëveshjeve politike dhe "ndarjeve të posteve" ndërmjet partive politike në pushtet.	0/2	0/2
Nëpunësit civilë e perceptojnë se nëpunësit e lartë civilë nuk shkarkohen nga detyra për motive politike	0/2	0/2
Nëpunësit civilë konsiderojnë se kriteret për shkarkimin e nëpunësve të lartë publikë të zbatohen siç duhet në praktikë	0/2	0/2
OSHC-të konsiderojnë që nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues të profesionalizohen në praktikë.	0/2	0/2
Nëpunësit civilë e perceptojnë se nëpunësit e lartë civilë nuk marrin pjesë në fushatat elektorale të partive politike	0/2	0/2
Pjesa e emërimeve pa procedurë konkurruese (duke përfshirë ushtruesit e detyrës jashtë fushëveprimit të shërbimit civil) nga numri i përgjithshëm i emërimeve në pozitat e drejtuesve të lartë në shërbimin civil.	0/4	4/4
Rezultati i përgjithshëm	6/40	9/40
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5)	0	1

Sipas hulumtimit të monitorimit të WeBER mbi përshkrimin e ligjit, procedurat e bazuara në meritë për përzgjedhjen e drejtuesve të lartë në shërbimin civil tregojnë se ka një rezultat më të mirë se monitorimi i mëparshëm dhe një rezultat pozitiv sa i përket përshtatshmërisë së kornizës legjislative për rekrutimet e bazuara në merita, këtë vit rezultati është 14 krahasuar me 10 që ka qenë më parë nga 15. Objektiviteti i kriterëve për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të nëpunësve të lartë civilë në kornizën legjislative shënoi një rezultat negativ prej 0 nga 4, ndërsa për zbatimin efektiv në praktikë të meritës të procedurave të rekrutimit për nëpunësit civilë tregojnë një progres të kufizuar me vetëm 2.5 nga 9, duke treguar ende një progres krahasuar me vlerësimin 0 të mëparshëm. Trend i ngjashëm është shënuar edhe në anketat me nëpunësit civilë ku 19.2% e nëpunësve civilë të anketuar ose "pajtoheshin" (14%) ose "pajtoheshin plotësisht" (5.2%) me deklaratën se "Procedurat për emërimin e nëpunësve të lartë civilë sigurojnë që kandidatët më të mirë i marrin vendet e punës në institucionin tim" krahasuar me 15.8% që ka qenë më parë.


Figura. Niveli i pajtueshmërisë së nëpunësve civilë dhe OSHC-ve për deklaratën vijuese: "Procedurat për emërimin e nëpunësve të lartë civilë sigurojnë që kandidatët më të mirë i marrin vendet e punës" (%)



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
Baza për anketën mbi SHC. N=49 n=32. Baza për anketën mbi SHC. N=221 n=171

Në të kundërt, ndërmjet OSHC-ve, e njëjta deklaratë shënon vetëm 2.5% pajtueshmëri dhe pajtueshmëri të plotë, ndërsa monitorimi i mëparshëm rezultoi me 12.2% zhvendosje të perceptimit në aspektin negativ. Rregullorja Nr. 17/2018 për Procedurat e Emërimit në Pozita të Larta të Drejtuese në Shërbimin Civil të Kosovës e rregullon procedurën për përzgjedhjen e ushtruesve të detyrës së drejtuesve të nivelit të lartë. Sipas kësaj Rregulloreje, ushtruesit e detyrës së drejtuesve të nivelit të lartë përzgjidhen pa ndonjë proces konkurrimi, për një kohëzgjatje maksimale prej tre (3) muajsh. Titullarët e institucioneve duhet të emërojnë si ushtrues detyre të ndonjë pozite të lartë drejtuese, vartësin e parë më të ulët, apo kur ka disa vartës të rangut të njëjtë, atëherë zyrtarin i cili zakonisht zëvendëson zyrtarin në pozitë të lartë drejtues gjatë mungesave të shkurtra (neni 17.2). Kjo sugjeron që pozitat si ushtrues detyre sipas rregullores duhet të plotësohen nga brenda shërbimit civil. Se nëse nëpunësit civilë të lartë drejtues profesionalizohen në praktikë, vetëm 2.5% e OSHC-ve u përgjigjën "pajtohen" ose "pajtohen plotësisht" me deklaratën.

Figura. Niveli i pajtueshmërisë së OSHC-ve me deklaratën e mëposhtme: Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues janë profesionistë në praktikë (%)



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
N=49 n=40

Në radhët e nëpunësve civilë 11.6% u përgjigjën ose "rrallë" ose "asnjëherë ose gati asnjëherë" në deklaratën "Nëpunësit e lartë civilë të paktën pjesërisht emërohen falë mbështetjes politike". 13.3% e nëpunësve civilë të anketuar u përgjigjën ose "nuk pajtohem" ose "nuk pajtohem plotësisht" me deklaratën "Pozitat e larta të shërbimit civil janë subjekt i marrëveshjeve politike

dhe “ndarjeve të posteve” ndërmjet partive politike në pushtet”

Tabela. Niveli i pajtueshmërisë së nëpunësve civilë me deklaratën e mëposhtme:

Deklarata	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	As nuk pajtohem e as pajtohem	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	Nuk e di
Pozitat e larta të shërbimit civil janë subjekt i marrëveshjeve politike dhe “ndarjeve të posteve” ndërmjet partive politike në pushtet.	5	8	15	36	22	13
	Asnjëherë ose gati asnjëherë	Rrallë	Nganjëherë	Shpesh	Gjithmonë ose gati gjithmonë	Nuk e di
Nëpunësit e lartë civilë të paktën pjesërisht emërohen falë mbështetjes politike ...	5	6	12	42	27	7


Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuara në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se shkojnë deri në 100%

Baza për anketën mbi SHC N=221 n=171

15.1% e nëpunësve civilë të anketuar iu përgjigjën me “asnjëherë ose gati asnjëherë” deklaratës “Në institucionin tim, nëpunësit e lartë civilë marrin pjesë në fushata elektorale të partive politike gjatë zgjedhjeve”.

Figura. Niveli i pajtueshmërisë së nëpunësve civilë me deklaratën e mëposhtme: “Në institucionin tim, nëpunësit e lartë civilë marrin pjesë në fushata elektorale të partive politike gjatë zgjedhjeve...”


Në institucionin tim, nëpunësit e lartë civilë marrin pjesë në fushata elektorale të partive politike gjatë zgjedhjeve...



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuara në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të arrijnë deri në 100%
Baza për anketën mbi SHC N=221 n=171


18% e nëpunësve civilë të anketuar u përgjigjën ose “nuk pajtohem” ose “nuk pajtohem aspak” me deklaratën “Në institucionin tim, nëpunësit e lartë civilë do të zbatonin veprime të paligjshme nëse eprorët politikë do t’ua kërkonin ta bënin këtë”. 26.8% e nëpunësve civilë të anketuar janë përgjigjur ose “pajtohem” ose “pajtohem plotësisht” me deklaratën “Nëpunësit e lartë civilë mund të refuzojnë një urdhër të paligjshëm nga një ministër ose një epror tjetër politik, pa rrezikuar pozitën e tyre” duke treguar një perceptim gati statik krahasuar me 27.2% nga monitorimi i fundit. 17.5% e nëpunësve civilë të anketuar u përgjigjën ose “rrallë” ose “asnjëherë ose gati asnjëherë” në deklaratën “Në institucionin tim nëpunësit e lartë civilë shkarkohen për motive politike”.

Figura. Niveli i pajtueshmërisë së nëpunësve civilë me deklaratat e mëposhtme (%)




Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100% Baza për anketën mbi SHC N=221 n=171

Figura. Sa shpesh nëpunësit civilë i ndjekin këto praktika në institucionin ku ata punojnë



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100% Baza për anketën mbi SHC N=221 n=171

Figura. Niveli i pajtueshmërisë së OSHC-ve dhe nëpunësve civilë për efektivitetin e integritetit dhe anti-korrupsionin në arritjen e qëllimit të tyre (në institucionin ku ata punojnë aktualisht)




Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100% Baza për anketën mbi SHC. N=49 n=40. Baza për anketën mbi SHC N=221 n=164

Procedurat e verifikimit ose këshillimit për emërimet e nëpunësve të lartë civilë jashtë fushës së legjislacionit të shërbimit civil përfshijnë rregullimin e marrëdhënieve të punës së nëpunësve të lartë civilë sipas dy rregulloreve të ndryshme (Rregullorja Nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese dhe Rregullorja Nr. 17/2018 Procedurat e Emërimit në Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil). Kryeministri emëron anëtarët e Këshillit për Pozita të Nivelit të Lartë Drejtues. Ky organ, i themeluar vetëm sipas legjislacionit sekondar, është përgjegjës për rekrutimin e nëpunësve të lartë civilë. Ai gjithashtu rregullon vlerësimin e tyre të performancës, lëvizshmërinë, procedurat disiplinore dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës (KPM) luan rol mbikëqyrës në sistemin e shërbimit civil. Secili proces i përzgjedhjes drejtohet nga një Komision i Vlerësimit të Kritereve (KVK) i krijuar ad hoc, i emëruar nga Ministri i Administratës Publike. Çdo KVK përbëhet nga tre sekretarë të përgjithshëm dhe dy ekspertë të jashtëm, njëri nga academia dhe tjetri nga shoqëria civile. Prezantimi i ekspertëve të jashtëm është një teknikë e mirë për parandalimin e ndikimit të panevojshëm. Bazuar në nenin 15, paragrafin 6 të Rregullores për Procedurat e Emërimit në Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duhet të emërohet kandidati i ranguar më së larti. Nëse jo, duhet të jepet një arsye nëse emërohet kandidati i dytë ose i tretë i ranguar më së larti.

Megjithatë, një numër i ulët i nëpunësve civilë, vetëm 4% u përgjigjën "gjithmonë ose gati gjithmonë" në deklaratën "Rregullat dhe kriteret zyrtare për shkarkimin e nëpunësve të lartë civilë zbatohen siç duhet në praktikë"

Duke analizuar pjesën e emërimeve pa procedura konkurruese nga numri i përgjithshëm i emërimeve në pozita të larta drejtuese civile, ekipit hulumtues nuk iu dha përgjigja nga institucioni kompetent.


Figura. Perceptimi i OSHC-ve dhe i nëpunësve civilë mbi paanësinë e integritetit dhe masat anti-korrupsion.



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt.
Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të arrijnë deri në 100%
Baza për anketën mbi SHC. N=49 n=40. Baza për anketën mbi SHC N=221 n=164

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi P4_I1: Mbrojtja efektive e pozitës së nëpunësve të lartë civilë nga ndërhyrjet e padëshiruara politike



Parimi 5: Sistemi i shpërblimit të nëpunësve publikë bazohet në klasifikimin e vendit të punës; është i drejtë dhe transparent

Treguesi i WeBER SHPMBNJ P5_I1: Transparenca, qartësia dhe disponueshmëria publike e informacionit mbi sistemin e shpërblimit të shërbimit civil

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Sistemi i shpërblimit në shërbimin civil është i strukturuar thjeshtë.	0/4	0/4
Sistemi i pagave/shpërblimeve në shërbimin civil parasheh opsione të kufizuara dhe të përcaktuara qartë për shtesat në paga si shtesë të pagës bazë.	0/4	0/4
Informacioni mbi sistemin e shpërblimit në shërbimin civil është në dispozicion në internet.	4/4	0/6
Shpjegimet ose prezantimet e përshtatshme për qytetarët të informacioni për shpërblimet janë në dispozicion në internet.	4/4	0/2
Shtesat diskrecionare janë të kufizuara nga legjislacioni dhe nuk mund të përbëjnë një pjesë të madhe të pagës/shpërblimit të një nëpunësi civil.	1/2	0/4
Nëpunësit civilë konsiderojnë që shtesat diskrecionare të përdoren për qëllimet e tyre të paramenduara të stimulimit dhe shpërblimit të performancës, sesa për favorizim politik ose personal.	0/2	0/2
Rezultati i përgjithshëm	0/22	0/22
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5)	0	0

Ligji për pagat e nëpunësve civilë që aktualisht është në fuqi zyrtarisht nuk po zbatohet. Si rezultat, pagat e nëpunësve civilë aktualisht po rregullohen përmes 58 dokumenteve ligjore nga institucionet e veçanta. Shumica e tyre janë vendime të veçanta ose udhëzime administrative (intervistë me Drejtorin e Departamentit Ligjor në Ministrinë e Administratës Publike). Prandaj, sistemi i pagave mbetet i njëjtë me vitet e kaluara. Sa i përket ligjit të ri i cili qe planifikuar të hynte në fuqi, ai u miratua nga Kuvendi në mars të vitit 2019, por fillimisht nuk hyri në fuqi për shkak të dy masave të përkohshme të Gjykatës Kushtetuese pas ankesës së paraqitur nga Avokati i Popullit. Më 30 qershor 2020, Gjykata Kushtetuese e shpalli përfundimisht këtë ligj si antikushtetues. Gjykata vendosi se ky ligj si tërësi nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pasi që shkel parimet e ndarjes së pushteteve dhe të sundimit të ligjit. Një

nga konstatimet e Aktgjykimit ishte se ky ligj nuk kishte harmonizuar pagat në nivelin e të gjithë sektorëve (gjë që u ankua nga ankesat si shkelje e dispozitave të barazisë). Përveç kësaj, në ligj bëheshin përjashtime arbitrare dhe të pajustificuara nga disa institucione, duke përjashtuar nga fusha e tij e rregullimit Forcën e Sigurisë së Kosovës, Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës, Agjencinë e Privatizimit të Kosovës dhe Bankën Qendrore të Kosovës. Sa i përket Kuvendit, Gjykata e gjeti problematike që ligji i dha Kuvendit disa kompetenca vetërregulluese (përfshirë të drejtën e përcaktimit të shtesave për stafin e tij dhe deputetët), pasi që kjo, përsëri, do të nënkuptonte se ligji kishte dështuar në arritjen e qëllimit kryesor të tij, domethënë harmonizimi i pagave në të gjithë sektorin publik.

Sa i përket nën-treguesve të SIGMA-s që hulumtuesit e WeBER-it kryen llogaritjen e tyre bazuar në metodologjinë e SIGMA-s, ata erdhën në përfundimin se informatat mbi pagën e ofruar nuk janë në dispozicion në njoftimet e konkurseve të punës në portalin qeveritar, e as njoftimet e konkurseve të punës. Për më tepër, informatat mbi pagat e përgjithshme mesatare për kategori të ndryshme të nëpunësve civilë nuk janë në dispozicion dhe as informatat e përgjithshme mbi pagat. Sa i përket elementit tjetër që ka të bëjë me nën-treguesit e SIGMA-s mbi shtesat diskrecionare që kufizohen nga legjislacioni dhe nuk mund të përmbajnë një pjesë të madhe të pagës/shpërblimit të një nëpunësi civil, informatat nuk ishin në dispozicion për shkak të mungesës së përgjigjes nga ministria përkatëse. Përveç kësaj, nuk ka asnjë dokument në dispozicion që të ofrojë shpjegime të informatave në lidhje me sistemin e shpërblimit në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (sektori i Administratës Publike).

Anketa e shërbimit civil përcakton se 26% e të anketuarve pajtoheshin plotësisht dhe 13.6 pajtoheshin me deklaratën se bonuset ose rritjet në shkallën e pagave përdoren nga drejtuesit vetëm për të stimuluar ose shpërblyer performancën, ndërsa 13.4% zgjodhën "rrallë" dhe "asnjëherë" në deklaratën se lidhjet politike dhe personale i ndihmojnë punonjësit të marrin shpërblime ose që t'u rritet shkalla e pagës.


Tabela. Niveli i pajtueshmërisë së nëpunësve civilë me deklaratat e mëposhtme:

Deklarata	Nuk pajtohem aspak	Nuk pajtohem	As nuk pajtohem e as pajtohem	Pajtohem	Pajtohem plotësisht	Nuk e di
Bonuset ose rritjet në shkallën e pagave përdoren nga drejtuesit vetëm për të stimuluar ose shpërblyer performancën.	25	31	17	14	4	9
	Asnjëherë ose gati asnjëherë	Rrallë	Nganjëherë	Shpesh	Gjithmonë ose gati gjithmonë	Nuk e di
Lidhjet politike dhe personale i ndihmojnë punonjësit të marrin shpërblime ose që t'u rritet shkalla e pagës	13	11	15	24	18	18

Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%

Baza për anketën mbi SHC N=221 n=169


Figura. Niveli i pajtueshmërisë së nëpunësve civilë me deklaratat e mëposhtme:



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuara në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%. Baza për anketën mbi SHC N=221 n=164

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi P5_I1: Transparenca, qartësia dhe disponueshmëria publike e informacionit mbi sistemin e shpërblimit të shërbimit civil



Parimi 7: Masat për promovimin e integritetit, parandalimin e korrupsionit dhe sigurimin e disiplinës në shërbimin publik

Treguesi i WeBER SHPBNJ P7_I1: Efektiviteti i masave për promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në shërbimin civil

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Integriteti dhe masat kundër korrupsionit për shërbimin civil zyrtarisht janë vendosur në administratën qendrore.	4/4	4/4
Integriteti dhe masat kundër korrupsionit për shërbimin civil zbatohen në administratën qendrore.	2/4	2/4
Nëpunësit civilë i konsiderojnë integritetin dhe masat kundër korrupsionit si efektive.	1/2	0/2


Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
OSHC-të i konsiderojnë integritetin dhe masat kundër korrupsionit si efektive.	0/2	0/2
Nëpunësit civilë konsiderojnë se integriteti dhe masat kundër korrupsionit janë të paanshme.	0/2	0/2
OSHC-të konsiderojnë se integriteti dhe masat kundër korrupsionit në administratën shtetërore janë të paanshme.	0/2	0/2
Nëpunësit civilë mendojnë se ata do të mbrohen si sinjalizues.	0/2	0/2
Rezultati i përgjithshëm	7/18	6/18
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5)	2	1

Bazuar në metodologjinë Sigma-s, Kosova arriti 5 nga 5 për plotninë e kornizës ligjore për integritetin e sektorit publik dhe 4 nga 4 për pasjen e një politike gjithëpërfshirëse të integritetit të sektorit publik dhe planit të veprimit, duke arritur 100% të objektivave, megjithatë faza e zbatimit ka shënuar vetëm 1 pikë nga 3 kur analizohet integriteti dhe masat kundër korrupsionit për shërbimet civile që po zbatohen në administratën qendrore. Nga anketa, 24% e nëpunësve civilë e perceptojnë se integriteti dhe masat kundër korrupsionit në institucionet e tyre janë të paanshme, ndërsa në radhët e OSHC-ve vetëm 2.5%. Monitorimi i mëparshëm kishte rezultuar i ngjashëm midis kategorive, nëpunësit civilë me 26.8% dhe OSHC-të me 0% pajtohen se integriteti dhe masat kundër korrupsionit janë të paanshme. Duke treguar një perceptim shumë skeptik në radhët e OSHC-ve.

Pavarësisht nëse ata i konsiderojnë integritetin dhe masat kundër korrupsionit si efektive, në mesin e nëpunësve civilë shifra është më e lartë krahasuar me OSHC-të për më shumë se një të tretën ose 33.3% krahasuar me 10% brenda OSHC-ve. Duke parë monitorimin e mëparshëm, në radhët e nëpunësve civilë 25.4% i konsideronin ato masa efektive dhe 9.8 të OSHC-ve e konsideronin kështu, duke mos shfaqur ndonjë trend mbi këtë çështje.

Sa i përket sigurisë, nëse nëpunësit civilë do të mbroheshin si sinjalizues gjatë këtij viti monitorimi shënon një regres me 13.3% nga 18.4%.

Figura. Treguesi P7_I1: Efektiviteti i masave për promovimin e integritetit dhe parandalimin e korrupsionit në shërbimin civil



4.5. Rezultatet përmbledhëse: Shërbimi Civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Nën fushën e SHPMBNJ-së, WeBER e monitoron a është informacioni në dispozicion të publikut, transparencën e procedurave dhe gjithashtu hulumton perceptimet e nëpunësve civilë dhe OSHC-ve në lidhje me profesionalizmin dhe integritetin e shërbimit publik dhe karakterin meritator të rekrutimit.

Për këtë periudhë të monitorimit, hulumtimi tregon se ka rënie të disponueshmërisë publike me të dhënat zyrtare dhe raportet lidhur me shërbimin civil dhe punonjësit në administratën qendrore të shtetit. Kufizimet nga COVID-19 dhe paqëndrueshmëria politike me ndërrimet e shpeshta të pushtetit politik, si dhe shkrirja e Ministrisë së Administratës Publike në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, janë ndër faktorët kryesorë që ndikuan në këtë ndryshim. Raportet vjetore për gjendjen e shërbimit civil në Kosovë të viteve 2017 dhe 2018 u bënë vetëm përmes të drejtës së informimit, ndërsa raporti i vitit 2019 nuk ishte në dispozicion të publikut. Të dhënat ndahen sipas gradës së punëdhënësve, nivelit (qendror ose komunal), gjinisë, përkatësisë etnike dhe arsimit. Ndryshe nga Monitori i RAP i vitit 2017-18, raportet për këtë periudhë të monitorimit ndahen sipas nivelit të funksioneve (gradës) që mbajnë punëdhënësit. Raportet në përgjithësi ofrojnë informacion të përgjithshëm mbi cilësinë dhe rezultatet e shërbimit publik, por ato nuk kanë përmbajtje të plotësuara me dëshmi dhe burime të pavarura. Të dhënat vjetore nuk vihen në dispozicion në format të hapur dhe nuk promovohen në mënyrë aktive para publikut përmes mediave sociale ose njoftimeve për shtyp.

Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë, që do të shfuqizonte Ligjin për Shërbimin Civil, është shpallur antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese në disa nene të caktuara për agjenci dhe institucione të pavarura pas dy masave për pezullim të këtij ligji. Këto nene të cilat Gjykata Kushtetuese i konsideroi jo kushtetuese, do t'i dërgohen Kuvendit të Kosovës, i cili është institucioni kompetent në lidhje me rregullimin e tyre.

Në fillim të ciklit të monitorimit në janar të vitit 2020, Gjykata Kushtetuese nuk vendosi për kushtetutshmërinë e Ligjit për Zyrarët Publikë, prandaj monitorimi u bazua në Ligjin për Shërbimin Civil, gjithashtu thirrjet e rekrutimeve që janë analizuar në procesin e monitorimit mbajnë datat e vitit 2019 dhe bazohen në Ligjin për Shërbimin Civil. Ligji për Shërbimin Civil nuk është shfuqizuar për shkak të ndryshimeve që duhet t'u nënshtrohen institucionet kompetente për të përmbushur kërkesat në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese.

Lidhur me pranimet në shërbimin civil, rekrutimi në shërbimin civil rregullohet me Rregulloren 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Teksti i njoftimit të konkursit të hapur, përmbajtja e shpalljes, vendimet dhe forma e aplikacioneve dhe disponueshmëria publike e njoftimit dhe e vendimeve rregullohen në përputhje me Rregulloren 02/2010 në fuqi. Në Rregullore përcaktohet se institucioni përkatës duhet të sigurojë që të gjitha shpalljet e rekrutimit në çdo formë të publikimit të jenë të lehta për qasje gjatë kohëzgjatjes së shpalljes. Shpalljet e rekrutimit duhet të publikohen në shtypin ditor dhe mediat elektronike brenda 5 ditëve të punës. Shpalljet e rekrutimit duhet të publikohen në portalin qeveritar dhe në portalin e institucionit përkatës. Në atë masë, të gjitha institucionet e marra si model e publikojnë shpalljen e konkursit publik në faqen e tyre përkatëse të internetit. Përkundër faktit që institucionet në përgjithësi i respektojnë procedurat e rekrutimit, rezultatet e anketës së nëpunësve civilë shfaqin një nivel të konsiderueshëm skepticizmi sa i përket efektivitetit të procedurave të tilla lidhur me përmbajtjen e këtyre procedurave. Vetëm 22.17% e nëpunësve civilë "pajtohen plotësisht" dhe "pajtohen" që punonjësit e administratës rekrutohen në bazë të kualifikimeve dhe aftësive. Përqindja e Monitorimit të fundit të RAP ishte 24.1%. 14.9% e nëpunësve civilë të anketuar pajtohen se për të marrë një vend pune në shërbimin civil në institucionin tim duhet të keni lidhje, është interesante se kjo përqindje në monitorimin e fundit ishte 17%.

Për më tepër, gjetjet tona tregojnë se shpallja e konkursit publik nuk përmban asgjë nga ato që metodologjia i konsideron si pengesa të paarsyeshme për kandidatët e jashtëm. Proces i aplikimit është i organizuar në tre faza, me të gjitha dokumentet që do të merren dhe dorëzohen nga kandidati fillimisht në të gjitha institucionet e marra si model, në këtë fazë të parë. Dy fazat e

tjera janë testet dhe intervistat dhe aty nuk kërkohen dokumente shtesë.

Sipas hulumtimit të monitorimit të WeBER mbi përshkrimin e Ligjit, procedurat e bazuara në meritë për përzgjedhjen e drejtuesve të lartë në shërbimin civil tregojnë se ka rezultate më të mirë se monitorimi i mëparshëm dhe se një rezultat pozitiv sa i përket përshtatshmërisë së kornizës legjislative për rekrutimet e bazuara në merita, këtë vit rezultati është 14 krahasuar me 10 as ishte më parë nga 15.

Ligji për pagat e nëpunësve civilë që aktualisht është në fuqi zyrtarisht nuk po zbatohet. Si rezultat, pagat e nëpunësve civilë aktualisht po rregullohen përmes 58 dokumenteve ligjore nga institucionet e veçanta. Shumica e tyre janë vendime të veçanta ose udhëzime administrative (intervistë me Drejtorin e Departamentit Ligjor në Ministrinë e Administratës Publike). Prandaj, sistemi i pagave mbetet i njëjtë me vitet e kaluara. Sa i përket ligjit të ri i cili qe planifikuar të hynte në fuqi, ai u miratua nga Kuvendi në mars të vitit 2019, por fillimisht nuk hyri në fuqi për shkak të dy masave të përkohshme të Gjykatës Kushtetuese pas ankesës së paraqitur nga Avokati i Popullit. Më 30 qershor 2020, Gjykata Kushtetuese e shpalli përfundimisht këtë ligj si antikushtetues. Gjykata vendosi se ky ligj si tërësi nuk është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, pasi që shkel parimet e ndarjes së pushteteve dhe të sundimit të ligjit. Informatat mbi pagën e ofruar nuk janë në dispozicion në njoftimet e konkurseve të punës në portalin qeveritar, e as njoftimet e konkurseve të punës. Për më tepër, informatat mbi pagat e përgjithshme mesatare për kategori të ndryshme të nëpunësve civilë nuk janë në dispozicion dhe as informatat e përgjithshme mbi pagat. Sa i përket elementit tjetër që ka të bëjë me nëntreguesit e SIGMA-s mbi shtesat diskrecionare që kufizohen nga legjislacioni dhe nuk mund të përmbajnë një pjesë të madhe të pagës/shpërblimit të një nëpunësi civil, informatat nuk ishin në dispozicion për shkak të mungesës së përgjigjes nga ministria përkatëse. Përveç kësaj, nuk ka asnjë dokument në dispozicion që të ofrojë shpjegime të informatave në lidhje me sistemin e shpërblimit në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme (sektori i Administratës Publike).

4.6. Evidentimi i rekomandimeve nga Monitori i RAP 2017/2018

Rekomandimi	Statusi	Komenti
SIMBNJ duhet të zbatohet në të gjitha institucionet publike dhe të gjitha të dhënat duhet të ngarkohen rregullisht. Qeveria duhet të sigurojë mekanizma për t'i detyruar këto institucione të kontribuojnë në mënyrë aktive në mbledhjen e të dhënave në sistemin e shërbimit civil.	Pjesërisht	Shumica e të dhënave janë përditësuar dhe vendosur në SIMBNJ, edhe pse 2020 si viti i pandemisë e ka bërë të pamundur finalizimin e këtij procesi. Për më tepër, sipas Ligjit për Zyrarët Publikë kërkohet të përcaktohet statusi i zyrtarëve publikë, që do të thotë numri i saktë i nëpunësve civilë. Pas përcaktimit të statusit të zyrtarëve publikë, numri i nëpunësve civilë do të definohet saktësisht, dhe kjo do t'i mundësojë sistemit që të finalizojë mbledhjen e të dhënave themelore të nëpunësve civilë.
Të dhënat mbi Raportet Vjetore të Shërbimit Civil përveç nivelit të përgjithshëm, duhet të raportohen në nivelin komunal, sipas institucionit, ose të paktën sipas llojit të institucionit. Të dhënat e ndara sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe nivelit të arsimit duhet të bëhen gjithashtu në përputhje me nivelin e funksioneve ose llojeve të institucioneve.	I përfunduar	Ky rekomandim është zbatuar, të dhënat janë në dispozicion në raportin përfundimtar për gjendjen e shërbimit civil 2020. që nuk është miratuar ende nga Parlamenti, i cili pas miratimit do të publikohet.
Raporti Vjetor i Shërbimit Civil duhet të përmbajë të dhëna për të gjitha format e angazhimeve të përkohshme në shërbimin civil. Të dhënat duhet të ndjekin strukturën aktuale të të dhënave për nëpunësit civilë, me rubrika shtesë për llojin dhe kohëzgjatjen e kontratës së përkohshme. Kjo do të bëjë të mundur që të kuptohet më mirë gjendja ekzistuese në shërbimin civil.	I përfunduar	Ky rekomandim është zbatuar, të dhënat janë në dispozicion në raportin përfundimtar për gjendjen e shërbimit civil 2020. i cili nuk është miratuar ende nga Kuvendi, që pas miratimit do të publikohet.
Të dhënat statistikore për shërbimin civil duhet të jenë në dispozicion të publikut, përfshirë në formatet e të dhënave të hapura (duke përjashtuar të dhënat ose pjesët që përmbajnë informata personale). Kjo mund të bëhet ose përmes funksionalizimit të SIMBNJ ose përmes faqes në internet të MAP si dhe Portalit të të Dhënave të Hapura. Të dhënat duhet të jenë në dispozicion për shkarkim dhe ato duhet të jenë të lexueshme nga makina.	I përfunduar	Ky rekomandim është zbatuar, të dhënat e përditësuara janë vendosur në Portalin e të Dhënave të Hapura www.opendata.rks-gov.net

Rekomandimi	Statusi	Komenti
Qeveria duhet të miratojë një Rregullore të veçantë për SIMBNJ. Rregullorja duhet të përshkruajë shprehimisht shpeshhtësinë dhe metodat e përditësimit të Regjistrisë, menaxhimit e tij, monitorimin si dhe sanksionet për organet që nuk janë në përputhje me LSHC dhe Rregulloren. Për më tepër, Rregullorja duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë autoritetin e caktuar (DASHC) përgjegjës për sigurimin e saktësisë dhe përditësimit të rregullt të SIMBNJ. Ky organ do të ketë një rol në monitorimin dhe marrjen e masave ndaj institucioneve të cilat nuk i respektojnë kërkesat ligjore.	I pazbatuar	Çdo lloj sanksioni duhet të vendoset nga ligji, e jo nga një akt tjetër që ka më pak fuqi sesa ligji.
SIMBNJ duhet të përgatisë dhe publikojë raporte gjithëpërfshirëse vjetore mbi zbatimin e ligjeve dhe politikave që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve njerëzore në shërbimin civil. Përveç elementeve sasiore, raportet duhet të përmbajnë komponentë të orientuar drejt rezultateve që do të adresojnë cilësinë e punës së shërbimit civil dhe vlerësimin nëse ai është bërë më shumë ose më pak i profesionalizuar, i depolitizuar, si dhe nëse kapacitetet janë përmirësuar apo jo.	I pazbatuar	Monitori i RAP 2019/2020 Raporti jo gjithëpërfshirës vjetor mbi zbatimin e ligjit dhe politikave që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve njerëzore në shërbimin civil është zbatuar.
Qeveria dhe MAP-i duhet të promovojnë në mënyrë aktive raportet mbi SHC përmes atyre mjeteve më të popullarizuara në të gjithë vendin, të tilla si faqet e internetit, mediat sociale, njoftimet për shtyp ose deklaratat për media.	Pjesërisht	Raporti mbi shërbimin civil është në dispozicion vetëm në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
Organet e administratës shtetërore duhet të shpallin vendet e lira të punës përmes kanaleve të mediave sociale. Institucionet që shpallin vendet e lira të punës duhet të ofrojnë mundësi abonimi dhe motorë kërkimi të avancuar në faqet e tyre përkatëse të internetit, për filtrim të shpalljeve të konkurseve.	I zbatuar	Është obligative të shpallen vendet e lira të punës në gazetën ditore dhe në faqet e internetit të cilat më pas publikohen në faqe të tjera private (p.sh. shpallje në disa faqe të caktuara në internet)
Organet e administratës shtetërore duhet të investojnë në përpjekjet për t'i bërë shpalljet e konkurseve publike më të kuptueshme për kandidatët e jashtëm.	Pjesërisht	Në ciklin e monitorimit është përshkruar një përpjekje për të përgatitur më pak shpallje burokratike për konkurse.

4.7. Rekomandimet e Monitorit të RAP 2019/2020

Raportet gjithëpërfshirëse mbi gjendjen e punës në shërbimin civil do të shërbenin për planifikim, hartim dhe zbatim më të mirë të politikave të MBNJ-së.

- a. SIMBNJ duhet të përgatisë dhe publikojë raporte gjithëpërfshirëse vjetore për zbatimin e ligjeve dhe politikave që kanë të bëjnë me menaxhimin e burimeve njerëzore në shërbimin civil. Përveç elementet sasiore, raportet duhet të përmbajnë komponentë të orientuar drejt rezultateve që do të adresonin cilësinë e punës së shërbimit civil dhe vlerësojnë nëse është bërë më shumë ose më pak i profesionalizuar, i depolitizuar, si dhe nëse kapacitetet janë përmirësuar apo jo.

Rekrutimi në shërbimin civil nuk siguron që kandidatët më të mirë të punësohen. Për të përmirësuar transparencën, sinqeritetin dhe ndershmërinë në rekrutim, dhe kështu të veprojnë në përputhje me parimin që bazohet në merita, praktikata duhet të përmirësohen duke filluar nga reklamimi i konkursit e deri te vendimi për rezultatin e procesit të përzgjedhjes.

- b. Organet e administratës shtetërore duhet të shpallin vendet e lira të punës përmes kanaleve të mediave sociale. Institucionet që reklamojnë vendet e lira të punës duhet të prezantojnë opsionet e abonimit dhe motorët e avancuar të kërkimit në faqet e tyre përkatëse të internetit, për filtrim të shpalljeve të konkursit. Zbatimi i këtyre metodave do të siguronte një arritje më të gjerë deri tek kandidatët e mundshëm dhe rrisin shanset për një proces të suksesshëm të rekrutimit. Organet e administratës shtetërore duhet të investojnë në përpjekjet për të bërë shpalljet për konkurse publike më të kuptueshme për kandidatët e jashtëm. Ata duhet ta përkthejnë gjuhën e shpalljeve në një gjuhë edhe më të thjeshtë dhe të qartë, të përfshijnë elemente vizuale të tillë si informacione grafike ose video që shpjegojnë hapat në procesin e rekrutimit, si dhe të publikojnë një broshurë të pyetjeve dhe më të shpeshta (FAQ) duke sqaruar pyetjet më sfiduese bazuar në praktikata e mëparshme. Kjo fletë duhet të përditësohet rregullisht pasi që kandidatët dërgojnë kërkesa të reja për sqarim, në mënyrë që të gjithë të interesuarit të informohen me kohë. E gjithë kjo do të stimulonte kandidatët e jashtëm që të aplikojnë si dhe të sigurojnë që ata e kuptojnë përshkrimin e punës dhe të gjitha kërkesat për aplikim. Në planin afatgjatë, kjo do të siguronte një proces rekrutimi më të suksesshëm.
- c. Faza e dorëzimit të dokumentit duhet të imponojë barrë minimale administrative dhe të dokumenteve për kandidatët. Duhet të organizohet të paktën në dy faza, vetëm me dokumente themelore (të tilla si letra përcjellëse, CV, letërnjoftimi dhe certifikata e lindjes), që kërkohen në shkallën e parë. Kandidatët duhet të lejohen që ta plotësojnë dokumentacionin që mungon të paktën brenda 5 ditëve të punës.

Rekomandohet që Qeveria të përgatisë një raport me të dhëna përkatëse për mënyrën e llojit, kriteret dhe kohëzgjatjen e angazhimeve të përkohshme të individëve me marrëveshje të posaçme të shërbimit, të cilat që nga hyrja në fuqi e Ligjit për Nëpunësit Publikë mund të angazhohen vetëm në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe rregullat e nxjerra nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik për këtë qëllim.

Procedurat e rekrutimit për zyrtarët e lartë publik duhet të mbështeten dhe monitorohen nga organizata të specializuara. Rekomandimet e tyre duhet të zbatohen në këtë proces. Ndryshimi dhe shkëputja e marrëdhënies së punës duhet të bëhet vetëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në ligj dhe çdo vendim duhet të jetë në përputhje me kornizën ligjore.

Duhet të kompletohet riorganizimi dhe sistematizimi i brendshëm i nëpunësve civilë në përputhje me legjislacionin për zyrtarët publikë. Rregulloret për organizimin e brendshëm duhet të përmbajnë gjithashtu pjesën e sistematizimit të punës duke përfshirë secilën klasë dhe secilin grup specializimi.

5. LLOGARIDHËNIA



5.1. Treguesit e WeBER të përdorur në llogaridhënie dhe vlerat për Kosovën

LLG P2 I1: Perceptimi i shoqërisë civile për cilësinë e legjislacionit dhe praktikës së qasjes në informacionin publik					
0	1	2	3	4	5
LLG P2 I1: Informimi proaktiv i publikut nga institucionet publike					
0	1	2	3	4	5

5.2. Gjendja aktuale në Llogaridhënie

E drejta e qasjes në dokumente publike garantohej nga neni 41 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës⁴⁹, ku thuhet se çdo person ka të drejtën e qasjes në dokumente publike. Ligji bazë në fuqi që e rregullon të drejtën e qasjes në dokumente publike është Ligji Nr. 06/L-081 për Qasjen në Dokumentet Publike (LQDP) që ka hyrë në fuqi në vitin 2019 duke shfuqizuar ligjin e mëparshëm.⁵⁰ Ligji për Qasjen në Dokumente Publike zbatohet për çdo dokument publik përveç informacionit të klasifikuar. Një dokument publik sipas LQDP është “çdo akt, fakt apo informatë në formë elektronike apo me zë, formë të shtypur, në incizime vizuale apo audiovizuale të prodhuara apo mbajtura nga institucioni publik”. Ky ligj i ri përcakton si parime themelore të së drejtës së qasjes në dokumente publike: 1. publikimin proaktiv dhe 2. hapjen e të dhënave. Publikimi proaktiv ose publikimi me iniciativë të institucioneve publike i obligon ata që të publikojnë në mënyrë aktive çdo dokument publik në faqet zyrtare të institucioneve publike. Për më tepër, paragrafi 2 i nenit 5 përmban atë që duhet të kenë faqet e internetit të institucioneve, por pa u kufizuar në këtë. Lidhur me publikimin e të dhënave të hapura, LQDP i obligon institucionet publike që të mundësojnë hapjen e të dhënave në një portal qendror duke mundësuar, ndër të tjera, krahasimin dhe ndërveprimin ndërmjet tyre në mënyrë që të përmirësohet qeverisja dhe përfshirja e qytetarëve në të. Edhe pse Kosova ka një portal të centralizuar për publikimin e të dhënave të hapura⁵¹, e njëjta do të duhet të vazhdojë pasurimin nga të gjitha institucionet publike. Lidhur me të dhënat e hapura, Komisioni Evropian në raportin e tij për Kosovën të vitit 2020⁵² konsideronte se: “Kosova po përmirësohet me rritjen e disponueshmërisë së të dhënave publike në platformën e të dhënave të hapura të qeverisë. Deri në fund të vitit 2019, 195 grupe të të dhënave janë publikuar në Portalin e të Dhënave të Hapura”. Në nenin 9 të LQDP theksohet se institucionet publike caktojnë zyrtarin përgjegjës, i cili do të shërbejë, përveç tjerash, edhe si zyrtar ndërlidhës për publikim të të dhënave të hapura.

Ligji i ri për qasjen në dokumentet publike, sikurse ai i vjetri, parasheh që çdo person ka të drejtë të kërkojë qasje në dokumente publike dhe ato mund të paraqiten në çdo mënyrë që lejon institucionin të identifikojë dokumentin e kërkuar publik. Nëse kërkesa është verbale, zyrtari përgjegjës duhet ta hartojë atë kërkesë me shkrim.⁵³ Aplikanti, sipas LQDP, mund të mbetet anonim kundrejt palëve të treta. Afatet për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike mbeten të njëjta sikurse në ligjin e vjetër. Ligji parasheh që institucionet duhet, brenda 7 ditëve nga momenti i regjistrimit të kërkesës, të nxjerrin një vendim për miratimin, refuzimin ose miratimin pjesërisht të kërkesës. Një risi e ligjit të ri është afati 48 orësh. Ky afat është për kërkesat për dokumente publike të cilat janë të nevojshme për të mbrojtur jetën ose lirinë e një personi.⁵⁴ Sipas nenit 12 të këtij Ligji, institucioni mund ta zgjasë afatin për marrjen e një vendimi për qasje në dokumentet publike deri në 15 ditë, por duhet ta njoftojë subjektin lidhur me progresin ose arsyet e vonës jo më vonë se 8 ditë nga marrja e kërkesës.

Ligji i ri ka specifikuar kategorikisht arsyet mbi të cilat kufizohet e drejta e qasjes në dokumente publike dhe rastet në të cilat gjithmonë duhet të lejohet qasja. Kufizimi i kësaj të drejte dhe arsyet

49 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 41, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

50 Ligji për Qasje në Dokumentet Publike, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=20505>

51 <https://opendata.rks-gov.net/>

52 Raporti për Kosovën, 2020, në dispozicion në: <https://www.mei-ks.net/sq/raporti-i-progresit-585>

53 LQDP, neni 10

54 LQDP, neni 12

e lejueshme të qasje janë në përputhje me parimin e proporcionalitetit në Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.⁵⁵ Risi e ligjit të ri është përfshirja e provës së dëmit dhe interesi publik në vlerësimin e institucionit nëse mund të sigurojë qasje në një dokument publik. Pavarësisht nga arsyet e përcaktuara për refuzimin e qasjes në dokumente publike, institucioni është i obliguar të tregojë nëse e posedon dokumentin publik dhe i njëjti nuk mund të refuzojë qasjen pa bërë provën e dëmit dhe interesin publik. Ky test tregon nëse dëmi i shkaktuar nga interesi i mbrojtur është më i rëndësishëm sesa interesi publik për qasje në dokumentin e kërkuar. Në rastet kur gjithmonë duhet të lejohet, rastet përcaktohen në mënyrë eksplicite, kur qasja në dokumente publike është gjithmonë e garantuar: "3. Qasja në dokumente publike gjithnjë lejohet, nëse: 3.1. dokumenti publik i kërkuar ka të bëjë me shpenzimet e parasë publike; 3.2. dokumenti publik lidhet me zbatimin e funksioneve publike ose marrëdhëniet e punësimit të zyrtarëve publik, përveç në rastet kur ka të dhëna personale të mbrojtura apo kur saktësohet ndryshe në ligjet përkatëse; 3.3. dokumenti publik i kërkuar ka të bëjë me mjedisin, mbeturinat, substanca të rrezikshme ose informata të raporteve të sigurisë në mjedis, ashtu si janë të parapara me ligjin përkatës për mbrojtjen e mjedisit".⁵⁶ Duke ndikuar në parimin e transparencës dhe llogaridhënies, ky nen i jep hapësirë çdo qytetari të informohet se ku po shpenzohen paratë e tij dhe se mund të mbahet përgjegjës për zbatimin e funksioneve publike, marrëdhëniet e punës të krijuara nga institucionet dhe harmonizohet me Konventën e Aarhus në lidhje me çështjet mjedisore.

Sa i përket koston financiare, dokumentet mund të sigurohen falas, me disa përjashtime⁵⁷. Sidoqoftë, në ligj thuhet se pagesa nuk vlen në lidhje me kërkesat për të dhëna personale. Sipas OSHC-ve⁵⁸, shumica e dokumenteve të kërkuara dhe të marra janë në formë elektronike.

Ligji për Qasjen në Dokumente Publike i obligon të gjitha institucionet publike që të caktojnë njësinë ose zyrtarin i cili është përgjegjës për qasjen në dokumentet publike. Ai/ajo është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e raporteve vjetore që duhet të dërgohen deri më 31 janar në institucionin përgjegjës. Sipas ligjit të vjetër, Zyra e Kryeministrit (ZKM) ishte përgjegjëse për hartimin e një raporti gjithëpërfshirës mbi trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, megjithëse ZKM nuk ishte autoriteti për ta zbatuar këtë të drejtë, për shembull në rastet kur kërkesat për qasje në dokumente publike janë refuzuar pa bazë ligjore. Gjithashtu, ZKM-ja nuk kishte kompetencë për të vendosur sanksione ndaj institucioneve publike të cilat nuk arritën të vepronin në përputhje me ligjin në fjalë. Me Ligjin e ri, Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është shndërruar në Agjenci për Informim dhe Privatësi, duke zgjeruar kështu fushëveprimin e saj në fushën e të drejtës për qasje në dokumentet publike. Përveç detyrave dhe përgjegjësisve në fushën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Agjencia monitoron dhe raporton në Kuvendin e Republikës së Kosovës, për respektimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike nga institucionet publike. Agjencia gjithashtu do të shërbejë si shkallë e dytë me pushtet ekzekutiv në vendosjen e masave ndëshkuese në rastet e moszbatimit të ligjit për qasjen në dokumente publike. Lidhur me gjobat, Ligji i ri për Qasjen në Dokumente Publike është zgjeruar për dallim nga ai vjetri, duke i lejuar Agjencisë vendosjen e gjobave. Për më tepër, Agjencia, përpara se të vendosë një gjobë, i ofron institucionit publik një periudhë prej 7 ditësh për të korrigjuar shkeljen e kryer, në mënyrë që gjoba të mos shqiptohet. Sipas ligjit të ri për qasjen në dokumente publike, sanksionohet vetëm institucioni publik kundër të cilit është bërë një ankesë se ka penguar realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike.

Agjencia është gjithashtu përgjegjëse për hartimin e raportit gjithëpërfshirës, i cili hartohet bazuar në raportet vjetore që vijnë nga institucionet publike për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike. Raporti i Agjencisë për vitin 2020⁵⁹ tregon se ka pasur 1401 kërkesa drejtuar institucioneve, ku nga këto kërkesa, 1401 u është lejuar qasja, 88 u është refuzuar qasja, 28 u është dhënë qasja e pjeshme dhe 70 prej tyre janë rishikuar. Raporti tregon se 61 institucione

55 Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7615>

56 Ligji 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, neni 17, par.3. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2724>

57 1. Konsultimi i dokumenteve publike në mjediset e institucioneve publike jepet falas, por nuk përjashton tarifën që mund të vendosen për shërbimet përkatëse që kryhen nga bibliotekat, arkivat dhe muzetë. 2. Kostot për një kopje të një dokumenti publik mund t'i ngarkohen kërkuarit, që do të jetë e arsyeshme dhe nuk e tejkalon koston reale për prodhimin dhe dhënien e një kopje.

58 Grupi i Fokusit me OSHC-të - 22 tetor 2020

59 Ky raport është marrë përmes të drejtës së informimit.

raportuan në Agjenci ndërsa 92 nuk raportuan. Gjithashtu, 10 nga institucionet që raportuan deklaruan se nuk kishin marrë ndonjë kërkesë për qasje në dokumente publike.

Agjencia për Informim dhe Privatësi gjithashtu duhet t'i raportojë Kuvendit të Kosovës për zbatimin e ligjeve që janë brenda fushëveprimit së saj. Në krye të kësaj Agjencie është Komisioneri, i cili emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, si organ i pavarur. Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionerit rregullohen me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale⁶⁰ që hyri në fuqi në shkurt të vitit 2019. Megjithëse Agjencia për Informim dhe Privatësi u krijua në vitin 2019, përpjekjet për të zgjedhur Komisionerin kanë dështuar secilën herë. Në vitin 2019, shpërndarja e Kuvendit e bëri të pamundur zgjedhjen e Komisionerit. Pas dy proceseve të dështuara në vitin 2019, në vitin 2020 e njëjta gjë u përsërit. Pas emrave të dërguar nga Komisioni për Siguri dhe Mbrojtje, Kuvendi i Kosovës nuk arriti të zgjedhë një Komisioner për Informim dhe Privatësi.

Sipas Vlerësimit Global për të Drejtën e Informimit, Kosova renditet e 30-ta për dallim nga monitorimi i mëparshëm ku Kosova ishte në vendin e 25-të sa i përket sigurimit të qasjes në dokumente publike.⁶¹ Ndërsa raporti për Kosovën (Raporti i Progresit) i Komisionit Evropian për vitin 2020 në lidhje me qasjen në dokumente publike, përmend hyrjen në fuqi të ligjit të ri për qasje në dokumente publike dhe thekson se zbatimi i vazhdueshëm i këtij ligji të ri për qasjen në dokumente publike duhet vazhdimisht ta përmirësojë aftësinë e publikut për të kërkuar llogari nga qeveria. Gjithashtu, ky raport përmend finalizimin e procesit të emërimit të Komisionerit të Agjencisë Për Informim dhe Privatësi si qenësor për funksionalitetin e plotë të Agjencisë.

Çfarë monitoron WeBER dhe si?

Parimi i SIGMA-i që mbulon të drejtën për të qasje në informatat publike është parimi i vetëm që monitorohet aktualisht në fushën e Llogaridhënies

Parimi 2: E drejta për qasje në informata publike është miratuar në legjislacion dhe zbatohet vazhdimisht në praktikë.

Ky parim ka rëndësi të madhe nga perspektiva e rritjes së transparencës së administratës dhe mbajtja e saj përgjegjëse nga shoqëria civile dhe qytetarët, por edhe nga këndvështrimi i ruajtjes së të drejtës për të ditur nga publiku i gjerë si parakusht për administrim më të mirë. Qasja e WeBER ndaj parimit nuk merr në konsideratë vlerësimin e zgjidhjeve rregullatore të mishëruara në aktet e qasjes së lirë në informata, por mbështetet në praktikën e sigurimit të informatave reaktive dhe proaktive nga organet e administratës. Nga njëra anë, qasja konsideron përvojën e shoqërisë civile me zbatimin e legjislacionit për qasjen në informatat publike, dhe nga ana tjetër, ajo bazohet në analiza të drejtpërdrejta të faqeve të internetit të organeve të administratës.

Monitorimi kryhet duke përdorur dy tregues të WeBER, i pari përqendrohet tërësisht në perceptimin e shoqërisë civile për fushëveprimin e të drejtës për qasje në informatat publike dhe nëse zbatimi i mundëson shoqërisë civile që ta ushtrojë këtë të drejtë në një mënyrë kuptimplote. Për të hulumtuar perceptimet, u krye një studim i organizatave të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor, duke përdorur një platformë të anketimit në internet, në periudhën prej 23 qershor - 4 gusht 2020. Pyetësi i njëtrajtshëm me 28 pyetje u përdor në të gjithë Ballkanin Perëndimor duke siguruar qasje të barabartë në zbatimin e anketës. U shpërnda në gjuhët lokale përmes rrjeteve ekzistuese dhe platformave të organizatave të shoqërisë civile me baza të dhënash të mëdha kontakti, por edhe përmes pikave të kontaktit të centralizuara siç janë zyrat qeveritare të ngarkuara me bashkëpunimin me shoqërinë civile. Për të siguruar që anketa shënjestronte sa më shumë organizata që të ishte e mundur, sa i përket llojit të tyre, shpërndarjes gjeografike dhe zonave të veprimtarisë, dhe kështu të kontribuonte në përfaqësimin sa më shumë që të ishte e mundur, u bë një nxitje shtesë atje ku ishte e nevojshme për të rritur përgjigjen e përgjithshme. Në fund, u organizua një grup fokusi me OSHC-të për t'i plotësuar gjetjet e anketës me të

60 Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18616>

61 Rangimi në të Drejtën Globale në Informata. Në dispozicion në: <https://www.rti-rating.org/country-data/>

dhëna cilësore. Sidoqoftë, rezultatet e grupeve të fokusit nuk përdoren për caktimin e pikëve për treguesin.

Treguesi i dytë ka si fokus informimin publik proaktiv nga organet e administratës, veçanërisht duke monitoruar gjithëpërfshirjen, kohën dhe qartësinë e informatave të shpërndarë përmes faqeve zyrtare në internet. Gjithsej, 18 informata janë përzgjedhur dhe vlerësuar kundrejt dy grupeve të kriterëve: 1) kriteret themelore, duke parë tërësinë, dhe nëse informatat janë të përditësuara, dhe 2) kriteret e avancuara, duke parë qasshmërinë dhe mirëpritjen e informatave nga qytetarët. Një kërkim i informatave kryhet përmes faqeve zyrtare në internet nga mostra prej shtatë organeve të administratës të përbëra nga tri ministri të linjës - një ministri e madhe, një e mesme dhe një e vogël sa i përket fushës tematike, një ministri me një funksion të përgjithshëm të planifikimit dhe koordinimit, një zyra qeveritare me funksion të qendrës së qeverisë, një organ vartës i një ministri/ ministrie dhe një zyre qeveritare e ngarkuar për ofrimin e shërbimeve.

5.3. Rezultatet e monitorimit të WeBER

Parimi 2: E drejta për qasje në informatat publike është miratuar në legjislacionin dhe zbatohet vazhdimisht në praktikë


Treguesi i WeBER LLG P2 I1: Perceptimi i shoqërisë civile për cilësinë e legjislacionit dhe praktikës së qasjes në informatat publike

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
OSHC-të konsiderojnë se informacioni i regjistruar dhe i dokumentuar nga autoritetet publike është i mjaftueshëm për zbatimin e duhur të së drejtës për qasje në informacionin publik	0/4	0/4
OSHC-të konsiderojnë që përjashtimet nga supozimi i karakterit publik të informacionit të përcaktohen në mënyrë adekuate	1/2	1/2
OSHC-të konsiderojnë që përjashtimet nga supozimi i karakterit publik të informacionit të zbatohen në mënyrë adekuate	0/2	0/4
OSHC-të konfirmojnë që informacioni është dhënë në formatin e kërkuar	1/2	1/2
OSHC-të konfirmojnë që informacioni është dhënë brenda afateve të përcaktuara	1/2	1/2
OSHC-të konfirmojnë që informacioni ofrohet falas	2/2	2/2
OSHC-të konfirmojnë që personi që kërkon qasje nuk është i obliguar të ofrojë arsye për kërkesat për informacion publik	1/2	0/2
OSHC-të konfirmojnë që në praktikë lëshohen pjesë të pa klasifikuara të materialeve që përndryshe janë të klasifikuara;	0/4	0/4
OSHC-të konsiderojnë që informacioni i kërkuar lëshohet pa pjesët që përmbajnë të dhëna personale	0/2	0/2
OSHC-të konsiderojnë se kur lëshohen vetëm pjesë të materialeve të klasifikuara, kjo nuk është bërë për të mashtruar personin kërkues me vetëm pjesë të vogla të informacionit	0/2	0/2
OSHC-të konsiderojnë që organi i caktuar mbikëqyrës*, përmes praktikës së tij, ka vendosur standarde mjaft të larta të së drejtës për qasje në informacionin publik	4/4	4/4
OSHC-të konsiderojnë që masat e nxjerra nga autoriteti mbikëqyrës për autoritetet publike janë efektive	1/2	1/2
OSHC-të konsiderojnë se pushteti i autoritetit mbikëqyrës për të vendosur sanksione çon në pasoja mjaft të rënda për personat përgjegjës në autoritetin jo kompetent	0/2	0/2
Rezultati i përgjithshëm	11/34	10/34
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5) ⁶²	1	1

62 Konvertimi i pikëve: 0-10 pikë = 0; 11-19 pikë = 1; 20-28 pikë = 2; 29-37 pikë = 3; 38-46 pikë = 4; 47-56 pikë = 5

I gjithi ky tregues bazohet në anketën me OSHC-të lidhur me perceptimin e tyre e që kryhet gjerësisht në mesin e shoqërisë civile në secilin vend, duke pasur parasysh që organizatat e shoqërisë civile kanë përvojë të madhe në zbatimin e legjislacionit për të drejtën e informimit dhe që në punën e tyre ato mbështeten në të. Meqenëse është pothuajse i pamundur të arrihet përfaqësimi i mostrës, hulumtuesit siguruan shpërndarje të gjerë në sektorë dhe lloje të ndryshme të organizatave, në të gjithë vendin. Anketa e zhvilluar tregon se vetëm 9% e OSHC-ve pajtohen që autoritetet publike, gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre, regjistrojnë informata të mjaftueshme për t'i mundësuar publikut përmbushjen e së drejtës për qasje të lirë në informatat me rëndësi publike, që tregon një regres krahasuar me monitorimin e mëparshëm të RAP (21%).


Figura. Perceptimi i OSHC-ve në lidhje me shkallën në të cilën institucioni publik regjistron informacion të mjaftueshëm për t'i mundësuar publikut përmbushjen e së drejtës për qasje të lirë në informatat me rëndësi publike



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt.
Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
N=49 n=41

Sa i përket asaj nëse në legjislacion përshkruhen përjashtime adekuate nga karakteri publik i informacionit të përgatitur nga autoritetet publike, 51% pajtohen krahasuar me 30% nga Monitori i RAP 2017/2018. Përveç kësaj, Monitorimi i RAP 2017/2018 tregoi se vetëm 4.5% e OSHC-ve u pajtuan që ato përjashtime të zbatohen në mënyrë adekuate në praktikë. Ndonëse ende mjaft i ulët, në anketën e këtij viti, megjithatë, ky perceptim mbi zbatimin e përjashtimeve u rrit në 9% të atyre që pajtohen.

Figura. Përvoja e OSHC-ve me ushtrimin e së drejtës për qasje të lirë në informata (%)



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt.
Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
N=49 n=41

Rezultatet e anketës së këtij viti tregojnë një qëndrim pak më të mirë se më parë, 47% të të anketuarve pretendojnë se informacioni i dhënë është “shpesh” ose “gjithmonë” në formatin e kërkuar. Për më tepër, 44% e OSHC-ve të anketuara pohuan se informacioni ofrohet brenda afateve të përcaktuara - përsëri pak më shumë se në të kaluarën (42.9%). Përveç kësaj, shumica e madhe prej 87.5% deklaruan që informacioni i kërkuar ofrohet pa pagesë, duke treguar edhe një herë një qëndrim më të mirë krahasuar me Monitorimin e RAP 2017/2018 (71%). Për më tepër, 37.5% e të anketuarve pohojnë se “rrallë” ose “asnjëherë” u është kërkuar t’i japin arsyet për dërgimin e kërkesave, duke shënuar një trend paksa pozitiv kundrejt monitorimit të mëparshëm (25%).

Tabela. Perceptimi i OSHC-ve në lidhje me aspekte të caktuara të kërkesave për të drejtën e informimit (%)


Kur organizata ime kërkon qasje të lirë në informata...	Asnjëherë	Rrallë	Nganjëherë	Shpesh	Gjithmonë	Nuk e di
... informacioni i dhënë është në formatin e kërkuar.	6	13	31	34	13	3
... informacioni jepet brenda afateve të përcaktuara.	6	28	16	34	9	6
... informacioni jepet pa pagesë.	0	0	3	9	78	9
... personit që kërkon qasje i kërkohet të paraqesë arsyet për një kërkesë të tillë.	16	22	16	25	16	6

Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%

N=49 n=32

Kur kërkojnë qasje në informata që përmbajnë materiale të klasifikuara, 12.5% e të anketuarve besojnë se pjesë të pa klasifikuara të këtyre materialeve u lëshuan, por prapëseprapë gati një e treta u përgjigjën me “nuk e di” (31.2%) edhe pse kjo është pjesa dukshëm më e ulët e përgjigjeve neutrale krahasuar me Monitorimin e mëparshëm të RAP, ku 57% zgjodhën përgjigjen “nuk e di”, dhe vetëm 7% u pajtuan. Përveç kësaj, 28% pohuan se kur kërkojnë informacione që mund të përmbajnë materiale të të dhënave personale, “shpesh” ose “gjithmonë” lëshohen pjesë që nuk përmbajnë të dhëna personale të këtyre materialeve (10 pikë përqindje rritje në pajtueshmëri nga Monitorimi i RAP 2017/2018), megjithatë një e katërta e tyre (25%) ende “nuk e dinë”. Gjithsej 12.5% e të anketuarve nuk mendojnë se pjesë të materialit të kërkuar janë lëshuar në një mënyrë për të mashtruar personin kërkues vetëm me informacion të pjesshëm (përgjigjet “asnjëherë” ose “rrallë”), e cila është gati e njëjtë me atë të Monitorimit të RAP 2017/2018 (14%).


Figura. Perceptimi i OSHC-ve mbi shpeshhtësinë që ndodh secila nga këto të mëposhtmet kur organizata e tyre kërkon qasje të lirë në informata



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt.
Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
N=49 n=32

Megjithatë, përkundër rënies, kur e shikojmë ciklin e mëparshëm të monitorimit, ekziston ende një numër i lartë i OSHC-ve, gati një e treta, që nuk janë në gjendje të japin një përgjigje (31% e përgjigjeve “nuk e di”). Në fund, gati dy të tretat e OSHC-ve të anketuara “pajtohen” ose “pajtohen plotësisht” (62.5%) që Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përmes praktikës së saj, vendos standarde mjaft të larta të së drejtës për qasje në informatat publike. Për më tepër, 44% e OSHC-ve deklarojnë se masat e buta të nxjerra nga Agjencia Kombëtare për autoritetet publike janë efektive në mbrojtjen e qasjes në informata. Akoma, vetëm 25% e OSHC-ve “pajtohen” ose “pajtohen plotësisht” se sanksionet e përshkruara për shkeljen e të drejtës për qasje të lirë në informata çojnë në pasoja mjaft të rënda në praktikë.

Figura. Niveli i pajtueshmërisë së OSHC-ve me deklaratat e mëposhtme:



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt.
Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100%
N=49 n=32

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi LLG P2 I1: Perceptimi i shoqërisë civile për cilësinë e legjislacionit dhe praktikës së qasjes në informatat publike



Parimi 2: E drejta për qasje në informacionin publik është miratuar në legjislacion dhe zbatohet vazhdimisht në praktikë

Vlerësimi i monitorimit të qasjes në informacionin publik ka treguar që autoritetet publike, të gjitha institucioneve të marra si model, në mënyrë të konsiderueshme u mungon një qasje proaktive kur bëhet fjalë për informimin e publikut. Informacioni mbi fushëveprimin e punës nuk është i rregullt në të gjitha institucionet e marra si model. Shtatë institucionet që u analizuan në këtë indikator ishin: 1. Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike (MEPTINIS), 2. Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit (MIA), 3. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS), Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT), Zyra e Kryeministrit (ZKM), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK). Nga shtatë institucionet, katër i kishin publikuar informacionet në faqen e internetit gjatë periudhës së monitorimit, nga të cilët tri prej tyre i kishin përditësuar dhe në përputhje me Rregulloren Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Edhe pse lehtësisht të qasshme, kur janë në dispozicion, këto informata zakonisht nuk paraqiten në mënyrë të përshtatur për qytetarët, pasi institucionet kryesisht e kopjojnë përshkrimin nga akti juridik, por ATK dhe AKK janë përjashtim edhe një herë, kësaj here në lidhje me informacionin e plotë dhe të përditësuar mbi linjat e llogaridhënies. Institucionet e tjera të marra si mostër nuk e japin një informacion të tillë. Nga ana tjetër, secili institucion publikon informacion të plotë, të përditësuar dhe lehtësisht të qasshëm përkthazi me dokumentet e politikave dhe aktet ligjore. Në mënyrë të ngjashme, gati të gjitha institucionet e marra si model, përveç MIA dhe MKRS, publikojnë dokument politikash, studime dhe analiza të rëndësishme për politikën nën kompetencat e tyre. Sidoqoftë, asnjë nga këto informacione dhe në të gjitha institucionet e marra si mostër nuk paraqitet në mënyrë të përshtatshme për qytetarët. Ndërkohë, vetëm tri nga shtatë institucionet e marra si model publikuan raporte vjetore të plota, të përditësuara, lehtësisht të qasshme dhe të përshtatshme për qytetarët. Të katër institucionet pa raporte vjetore në dispozicion në faqen e internetit janë të gjitha ministri. Vlen të përmendet se publikimi i informacionit buxhetor (planet dhe raportet financiare) mungon pothuajse në të gjitha institucionet. Rasti i vetëm dhe pozitiv në lidhje me këtë është ATK, planet financiare dhe raportet e të cilës janë lehtësisht të qasshme dhe të paraqitura në mënyrë të përshtatshme për qytetarët. Për më tepër, të gjitha institucionet e marra si mostër ofrojnë informacione të plota, të qasshme dhe të përshtatshme për qytetarët, nga të cilat vetëm informacionet e kontaktit të MEPTINIS dhe MIA nuk janë përditësuar. Sa i përket organogramëve organizativ, katër nga numri i përgjithshëm i institucioneve të marra si mostër japin informacion të plotë në faqen e tyre të internetit dhe në format të shkarkueshëm. Megjithatë, vetëm dy prej tyre, përkatësisht MKRS

dhe ATK, janë në përputhje me aktet më të fundit mbi strukturën e brendshme dhe pozitat e punës. Kur është në dispozicion, qoftë kur është i plotë dhe jo i plotë, informacioni mbi strukturën organizative është zakonisht i qasshëm dhe i përshtatshëm për qytetarët. Pesë institucione të marra si mostër japin informacion mbi bashkëpunimin me shoqërinë civile. Ato e bëjnë këtë duke përfshirë lidhjen që drejton përdoruesin në Platformën e centralizuar për Konsultimet Publike në faqen kryesore të internetit të tyre. Dy institucionet e tjera janë ATK (agjenci ekzekutive nën Ministrinë e Financave) dhe AKK (agjenci vartëse nën ish Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor) të cilat nuk sponsorizojnë akte ligjore. Megjithatë informacioni mbi bashkëpunimin me shoqërinë civile është lehtësisht i qasshëm, megjithatë të gjithëve u mungon komponenti i 'të qenit i përshtatshëm për qytetarë', përveç ZKM-së. Në fund, megjithatë ka shembuj të mirë brenda institucioneve të marra si mostër që ndjekin politikë të hapur të të dhënave, siç është rasti me MEPTINIS, MIA, MFT dhe ZKM, ata nuk janë mjaftueshëm proaktiv në ofrimin e të dhënave në mënyrë aktive në format të hapur. Duhet të theksohet shumë, se gjatë periudhës së monitorimit, Qeveria e Kosovës po pësonte ndryshime të mëdha strukturore. Qëllimi i një ristrukturimi të tillë ishte të ulej numri i ministrive nga 21 në vetëm 15. Kjo do të thotë që shumë ish-ministri do të bashkoheshin në të reja dhe ish-ministritë do të konsolidoheshin. Për këtë qëllim, duhet të theksohet siç duhet se arsyeja pse disa informacione që maten nga ky tregues nuk janë në dispozicion në faqet e internetit të institucioneve të marra si mostër mund të ketë qenë kryesisht, por jo krejtësisht, për këtë arsye.


Treguesi i WeBER LLG P2 I2: Informimi proaktiv i publikut nga institucionet publike

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar për fushëveprimin	0/4	4/4
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë informacione lehtësisht të qasshme dhe të përshtatur për qytetarët për fushëveprimin e punës	0/2	1/4
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar mbi përgjegjësinë (ndaj kujt janë përgjegjës)	0/4	0/4
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar mbi dokumentet përkatëse të politikave dhe aktet ligjore	4/4	4/4
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë informacione të qasshme për qytetarët mbi dokumentet përkatëse të politikave dhe aktet ligjore	0/2	0/2
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar mbi dokumentet e politikave, studimet dhe analizat që lidhen me politikat nën kompetencën e tyre	2/4	2/4
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë informacion të qasshëm dhe të përshtatur për qytetarët mbi dokumentet e politikave, studimet dhe analizat që lidhen me politikat nën kompetencën e tyre	0/2	0/2
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë raporte vjetore të plota dhe të përditësuar	0/2	0/4
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë raporte vjetore të qasshme dhe të përshtatur për qytetarët	0/2	0/2
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar mbi buxhetin e institucionit	0/4	0/4
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë informacion të qasshëm dhe të përshtatur për qytetarët për buxhetin e institucionit	0/2	0/2
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar të kontaktit (përfshirë adresat e postës elektronike)	2/4	2/4

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë informacion të kontaktit të qasshëm dhe të përshtatur për qytetarët (përfshirë adresat e postës elektronike)	2/2	2/2
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë organigramë të plotë dhe të përditësuar organizativ që përfshijnë tërë strukturën organizative	0/4	2/4
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë organigramë organizativ të qasshëm dhe të përshtatur për qytetarët, që përfshijnë tërë strukturën organizative	2/2	1/2
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë informacion të plotë dhe të përditësuar për pikat e kontaktit për bashkëpunim me shoqërinë civile dhe palë të tjera të jashtme, përfshirë proceset e konsultimit publik	2/4	0/4
Faqet e internetit të institucioneve publike përmbajnë informacion të qasshëm dhe të përshtatur për qytetarët për mënyrat se si ata bashkëpunojnë me shoqërinë civile dhe palë të tjera të jashtme, përfshirë proceset e konsultimit publik	1/2	0/2
Institucionet publike ndjekin në mënyrë aktive politikën e të dhënave të hapura	0/4	0/4
Rezultati i përgjithshëm	15/56	18/56
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5) ⁶³	1	1

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi LLG P2 I2: Informimi proaktiv i publikut nga autoritetet publike



63 Shndërrimi i pikëve: 0-10 pikë = 0; 11-19 pikë = 1; 20-28 pikë = 2; 29-37 pikë = 3; 38-46 pikë = 4; 47-56 pikë = 5

5.4. Rezultatet përmbledhëse: Llogaridhënia

Anketa e kryer e OSHC-ve tregon se vetëm 9% e OSHC-ve pajtohen që autoritetet publike, gjatë ushtrimit të aktiviteteve të tyre, regjistrojnë informata të mjaftueshme për t'i mundësuar publikut përmbushjen të drejtën për qasje të lirë në informatat me rëndësi publike, që tregojnë një regres krahasuar me Monitorimin e mëparshëm të RAP (21%). Sa i përket asaj nëse në legjislacion përshkruhen përjashtime adekuate nga karakteri publik i informacionit të përgatitur nga institucionet publike, 51% pajtohen krahasuar me 30% e organizatave nga Monitorimi i RAP 2017/2018. Për më tepër, 44% e OSHC të anketuara pohuan se informacioni ofrohet brenda afateve të përcaktuara - përsëri pak më shumë se më parë (42.9%). Përveç kësaj, një shumicë e madhe prej 87.5% deklaruan që informacioni i kërkuar ofrohet pa pagesë, duke treguar edhe një herë një rezultat më të mirë krahasuar me Monitorimin e RAP 2017/2018 (71%). Për më tepër, 37.5% e të anketuarve pohojnë se "rrallë" ose "asnjëherë" u është kërkuar t'i japin arsyet për dërgimin e kërkesave, duke shënuar një trend paksa pozitiv kundrejt monitorimit të mëparshëm (25%). Përveç kësaj, 28% pohuan se kur kërkojnë informacione që mund të përmbajnë materiale të të dhënave personale, "shpesh" ose "gjithmonë" lëshohen pjesë që nuk përmbajnë të dhëna personale të këtyre materialeve.

Gati dy të tretat e OSHC-ve të anketuara "pajtohen" ose "pajtohen plotësisht" (62.5%) që Agjencia kompetente, përmes praktikës së saj, vendos standarde mjaft të larta të së drejtës për qasje në informatat publike. Për më tepër, 44% e OSHC-ve deklarojnë se masat e nxjerra nga Agjencia për institucionet publike janë efektive në mbrojtjen e qasjes në informata. Këtu, vlen të përmendet se Agjencia për Informim dhe Privatësi ende nuk ka një Komisioner.

Vlerësimi i monitorimit të qasjes në informacionin publik ka treguar që autoritetet publike, të gjitha institucioneve të marra si mostër, në mënyrë të konsiderueshme u mungon një qasje proaktive kur bëhet fjalë për informimin e publikut. Informacioni mbi fushëveprimin e punës nuk është i rregullt në të gjitha institucionet e marra si mostër. Nga shtatë institucionet, katër i kishin publikuar informacionet në faqen e internetit gjatë periudhës së monitorimit, nga të cilët tri prej tyre i kishin përditësuar dhe në përputhje me Rregulloren Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Edhe pse lehtësisht të qasshme, kur janë në dispozicion, këto informata zakonisht nuk paraqiten në mënyrë të përshtatur për qytetarët, pasi institucionet kryesisht e kopjojnë përshkrimin nga akti juridik. Ndërkohë, vetëm tri nga shtatë institucionet e marra si mostër publikuan raporte vjetore të plota, të përditësuara, lehtësisht të qasshme dhe të përshtatshme për qytetarët. Të katër institucionet pa raporte vjetore në dispozicion në faqen e internetit janë të gjitha ministri. Vlen të përmendet se publikimi i informacionit buxhetor (planet dhe raportet financiare) pothuajse mungon në të gjitha institucionet. Rasti i vetëm dhe pozitiv në lidhje me këtë është ATK, planet financiare dhe raportet e të cilës janë lehtësisht të qasshme dhe të paraqitura në mënyrë të përshtatur për qytetarët. Për më tepër, të gjitha institucionet e marra si mostër ofrojnë informacione të plota të kontaktit, të qasshme dhe të përshtatur për qytetarët, nga të cilat vetëm informacionet e kontaktit të dy ministrive nuk janë përditësuar. Sa i përket organigramëve organizativ, katër nga numri i përgjithshëm i institucioneve të marra si mostër japin informacion të plotë në faqen e tyre të internetit dhe në format të shkarkueshëm. Pesë institucione të marra si mostër japin informacion mbi bashkëpunimin me shoqërinë civile. Ato e bëjnë këtë duke përfshirë lidhjen që drejton përdoruesin në Platformën e centralizuar për Konsultimet Publike në faqen kryesore të internetit të tyre. Dy institucionet e tjera janë ATK (agjenci vartëse nën Ministrinë e Financave) dhe AKK (agjenci vartëse nën ish-Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor), dhe zakonisht ato nuk sponsorizojnë akte ligjore. Megjithatë informacioni mbi bashkëpunimin me shoqërinë civile është lehtësisht i qasshëm, megjithatë të gjithëve u mungon komponenti i 'të qenit i përshtatshëm për qytetarë', përveç ZKM-së. Në fund, megjithatë ka shembuj të mirë brenda institucioneve të marra si mostër që ndjekin politikë të hapur të të dhënave, siç është rasti me ME, MIM, MFT dhe ZKM, ata nuk janë mjaftueshëm proaktiv në ofrimin e të dhënave në mënyrë aktive në format të hapur.

5.5. Rekomandimet për Llogaridhënie

Evidentimi i rekomandimeve nga Monitorimi i RAP 2017/2108

Rekomandimi	Statusi	Komenti
<p>Institucionet publike duhet ta informojnë publikun duke përdorur gjuhë të thjeshtë, të orientuar drejt qytetarëve në faqet e tyre të internetit, duke u përqendruar në lehtësimin e qasjes dhe përvojën më të mirë të përdoruesit. Posaçërisht:</p> <p>a. Kur publikohen dokumente (politika dhe dokumente ligjore, raporte, etj.), përmbajtja dhe qëllimi i tyre duhet të prezantohen/shpjegohen shkurtimisht pa terminologji burokratike, duke u përqendruar në aspektet më të rëndësishme dhe si ndikojnë ato në jetën e përditshme të qytetarëve, shoqatave, bizneseve, grupet e pakicave, ose në grupet e tjera në shoqëri;</p> <p>b. Kur jepen informacione mbi qëllimin organizativ dhe fushën e përshkrimit, ku përshkruhen fushat e politikave dhe shërbimet e ofruara, ose informacione të ngjashme administrative (qoftë në Broshurat e Informacionit ose përndryshe në internet), kopjimi i tekstit nga aktet ligjore duhet të shmanget në mënyrë rigoroze, në vend të kësaj ato duhet të përshtaten për një qytetar zakonshëm;</p>	Pjesërisht i zbatuar	Institucionet publike duhet të vazhdojnë informimin e publikut duke përdorur një gjuhë të përshtatshme për qytetarët gjatë publikimit të dokumenteve dhe sigurimit të informacionit mbi qëllimin e organizatës ku përshkruhen fushat e politikave dhe shërbimet e ofruara.
<p>Institucionet publike në nivel të administratës qendrore duhet të publikojnë në mënyrë proaktive raportet e tyre vjetore të punës në internet. Opsioni themelor do të ishte publikimi i pjesëve përkatëse nga Raporti i Planit Vjetor të Punës së Qeverisë, për ta plotësuar atë me informacion cilësor dhe sasior, si dhe treguesit e performancës për rezultatet konkrete të arritura nga organizata në periudhën një vjeçare;</p>	Pjesërisht i zbatuar	Fatkeqësisht, jo të gjitha institucionet qendrore publike i publikojnë raportet e tyre vjetore të punës në internet. Gjithashtu, gjatë periudhës sonë të monitorimit, qeveria dështoi t'i publikonte raportet vjetore të punës në kohën e duhur ose bazuar në rregullore. Për periudhën 2017 - 2019 ata publikuan një raport kumulativ me arritjet, që nuk kanë reflektuar performancën e tyre ose ta plotësonin atë me informacion cilësor dhe sasior.

Rekomandimi	Statusi	Komenti
Institucionet publike duhet të fillojnë të përgatisin dhe publikojnë versionin të përshtatur për qytetarët të buxheteve të tyre vjetore (planet financiare). Praktikën ekzistuese në vend për buxhetin vjetor të shtetit dhe për disa vetëqeverisje lokale mund të përdoren si pikënisje për zhvillimin e tyre. Pasi të zhvillohen dhe publikohen, buxhetet për qytetarët duhet të shënohen qartë dhe të shihen nga faqja kryesore e internetit;	I pazbatuar	Faqet e internetit të institucioneve publike të marra si mostër nuk përmbajnë buxhetet vjetore (planet financiare)
Institucionet publike duhet të fillojnë të publikojnë të paktën një set të të dhënave që kanë të bëjnë me fushë veprimtarinë e tyre të punës në përputhje me standardet e të dhënave të hapura, mundësisht si në faqet e tyre të internetit, ashtu edhe në portalin kombëtar të të dhënave të hapura;	Pjesërisht i zbatuar	Institucionet publike e publikojnë grupin e tyre të të dhënave në formatin e të dhënave të hapura vetëm në portalin kombëtar të të dhënave.
Informacioni mbi bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe palët e jashtme të interesit në përgjithësi, duhet të shfaqet qartë, mundësisht përmes një seksioni lehtësisht të qasshëm në faqen e internetit, ku detajohet se çfarë përfshin bashkëpunimi me OSHC-të, kanalet e komunikimit, personat e kontaktit/përgjegjës dhe informacione të tjera të rëndësishme.	Pjesërisht i zbatuar	Shumë pak institucione publike kanë një seksion të veçantë me detaje për bashkëpunimin me OSHC-të.
Në mënyrë të ngjashme, për konsultime publike dhe debate publike mbi dokumentet e politikave dhe legjislativën, duhet të jetë në dispozicion një seksion i veçantë i faqes në internet. Ai ose mund të kombinohet me atë nga rekomandimi nr. 5 ose të dizajnohet veçmas. Sidoqoftë, proceset e konsoliduara dhe të vazhdueshme të konsultimit duhet të identifikohen dhe të kërkohen lehtësisht, përfshirë personat përgjegjës të kontaktit, thirrjet për të marrë pjesë, programet, dokumentet e nevojshme dhe informatat mbi rezultatin;	Pjesërisht i zbatuar	Edhe pse, kjo praktikë është e vendosur, e njëjta praktikë duhet vendosur përmes të gjitha proceseve të konsultimit.

Rekomandimi	Statusi	Komenti
Ndonëse është krijuar një portal i vetëm për konsultime online dhe po përdoret kryesisht nga institucionet, angazhimi i shoqërisë civile është ende i pakënaqshëm. Prandaj, portali duhet të promovohet në faqet kryesore të internetit të të gjitha institucioneve në mënyrë që të ridrejtojë vizitorët, si dhe të promovohet dhe të rritet ndërgjegjësimi gjithashtu përmes mjeteve të mediave sociale të tilla si faqet e Facebook-ut, Twitter-it dhe të ngjashme.	Pjesërisht i zbatuar	Portali nuk po arrin të promovohet në mediat sociale siç është Facebook, Twitter etj. Vlen të përmendet se portali i konsultimeve promovohet gati në secilën nga faqet e internetit të institucioneve publike.
Institucionet publike gjithmonë duhet të japin informacion në formatin(et) e kërkuar. Nëse ka ndonjë pengesë të arsyeshme ose arsyetim për këtë, kërkesit e informacionit/dokumentit duhet të informohen paraprakisht;	Pjesërisht i zbatuar	Fatkeqësisht, institucionet publike nuk dërgojnë në çdo rast informacionin në formatin e kërkuar nga parashtruesi i kërkesës.
Institucionet publike duhet të shmangin plotësisht dhënien e informacionit në dokumentet e skanuara. Kjo e kufizon përdorimin e mëtejshëm të të dhënave dhe kërkimin në rast të dokumenteve më të mëdha;	Pjesërisht i zbatuar	Bazuar në monitorimin tonë, institucionet publike në shumicën e rasteve kanë dërguar dokumente të skanuara.
Agjencia për Informim dhe Privatësi duhet të mbajë një regjistër të institucioneve publike që janë shumicën e kohës të paqasshme dhe ta bëjë atë publike. Ekspozimi i shembujve të këqinjë do të promovonte përgjegjësinë në një periudhë afatgjate.	I pazbatuar	Agjencia për Informim dhe Privatësi nuk ka një regjistër, ajo vetëm përpilon një raport me të dhënat që i dërgohen nga institucionet publike.
Ndryshimet e vazhdueshme në legjislacionin e qasjes në dokumente publike në Kosovë duhet të sigurojnë sanksione efektive për të gjitha institucionet që nuk e mëshirojnë këtë të drejtë në mënyrë që e drejta në informim dhe qasje në dokumente publike të mbrohet.	I zbatuar	Ligji i ri për Qasjen në Dokumentet Publike siguron sanksione efektive për të gjitha autoritetet që nuk veprojnë në përputhje me legjislacionin. Megjithatë fakti që Agjencia nuk e ka Komisionerin, e bën zbatimin e këtyre dispozitave të pamundur për momentin.

5.6. Rekomandimet e Monitorimit të RAP 2019/2020

- 1) 1. Institucionet publike duhet ta informojnë publikun duke përdorur gjuhë të thjeshtë, të orientuar drejt qytetarëve në faqet e tyre të internetit, duke u përqendruar në lehtësimin e qasjes dhe përvojën më të mirë të përdoruesit. Posaçërisht:
 - a. Kur publikohen dokumente (politika dhe dokumente ligjore, raporte, etj.), përmbajtja dhe qëllimi i tyre duhet të prezantohen/shpjegohen shkurtimisht pa terminologji burokratike, duke u përqendruar në aspektet më të rëndësishme dhe si ndikojnë ato në jetën e përditshme të qytetarëve, shoqatave, bizneseve, grupet e pakicave, etj..
 - b. Kur jepen informacione mbi qëllimin organizativ dhe fushën e përkrahimit, ku përkrahohen fushat e politikave dhe shërbimet e ofruara, ose informacione të ngjashme administrative (qoftë në Broshurat e Informacionit ose përndryshe në internet), kopjimi i tekstit nga aktet ligjore duhet të shmangët në mënyrë rigorozë, në vend të kësaj ato duhet të përshtaten për një qytetar zakonshëm;
- 3) Institucionet publike në nivel të administratës qendrore duhet të publikojnë në mënyrë proaktive raportet e tyre vjetore të punës në internet.
- 4) Institucionet publike duhet të fillojnë të përgatisin dhe publikojnë versionin të përshtatur për qytetarët të buxheteve të tyre vjetore.
- 5) Portali për konsultime publike duhet të promovohet në faqet kryesore të internetit të të gjitha institucioneve në mënyrë që të ridrejtojë vizitorët, si dhe të promovohet dhe të rritet ndërgjegjësimi gjithashtu përmes mjeteve të mediave sociale.
- 6) Institucionet publike gjithmonë duhet të japin informacion në formatin(et) e kërkuar dhe të shmangin plotësisht dhënien e informacionit në dokumentet e skanuara.
- 7) Të gjitha institucionet publike duhet t'i raportojnë Agjencisë për Informim dhe Privatësi mbi zbatimin e Ligjit për Qasjen Publike, siç kërkohet nga Ligji.
- 8) Agjencia për Informim dhe Privatësi, duhet të mbajë një regjistër të autoriteteve publike që shpesh nuk u përgjigjen kërkesave, dhe të shfaqin shembuj të rastit të keq dhe gjithashtu ta bëjë atë publike se cilat institucione nuk i raportojnë Agjencisë.
- 9) Në fund, Kuvendi i Kosovës (Komisioni për Siguri dhe Mbrojtje) duhet të vendosë përparësi dhe të zgjedhë Komisionerin e Agjencisë për Informim dhe Privatësi, i cili do t'i vitalizonte dispozitat e Ligjit për Qasjen në Dokumente Publike.

6. OFRIMI I SHËRBIMEVE

The background features a large, abstract geometric shape on the right side, resembling a stylized mountain or a large triangle. It is composed of a dark blue base, an orange border, and a white top section. The top right corner of the page is a solid blue triangle.

6.1. Treguesit e WeBER të përdorur në Ofrimin e Shërbimeve dhe vlerat e vendit për Kosovën

SPOSH _ P1_I1: Perceptimi publik i orientimit qytetar të administratës shtetërore					
0	1	2	3	4	5
OSH P3_I1: Perceptimi publik dhe disponueshmëria e informacionit mbi reagimet e qytetarëve në lidhje me cilësinë e shërbimeve administrative					
0	1	2	3	4	5
OSH P4_I1: Perceptimi i OSHC-ve për qasjen në shërbimet administrative					
0	1	2	3	4	5
OSH P4_I2: Perceptimi i OSHC-ve për qasjen në shërbimet administrative					
0	1	2	3	4	5

6.2. Gjendja aktuale në Ofrimin e Shërbimeve

Në Republikën e Kosovës ende nuk ka ndonjë strategji të vetme ose dokument programor që adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse politikën e ofrimit të shërbimeve. Korniza strategjike mbi aspektet specifike të ofrimit të shërbimeve bazohet kryesisht në tre dokumente strategjike të RAP, përkatësisht Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020 (SMAP), Strategjia e Rregullimit më të Mirë (SRRM) 2.0 2017-2021⁶⁴ dhe Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021⁶⁵.

SKZH është një strategji ombrellë dhe dy Strategjitë Qeveritare, përkatësisht SMAP dhe SRRM mbështesin objektivat e SKZH.

SMAP⁶⁶ ndër të tjera përfshin reformat në a) shërbimin civil; b) procedurat administrative dhe sigurimi i shërbimeve të administratës publike dhe c) organizimi dhe përgjegjësia qendrore dhe sa i përket ofrimit të shërbimeve, strategjia përfshin shtatë objektiva specifike. Objektivat ndër të tjera përqendrohen në "krijimin e një vizioni dhe politikash të qarta bazuar në analizën e thelluar në lidhje me modernizimin e shërbimeve publike përmes zbatimit të Ligjit të ri për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA)". Qëllimi është krijimi i mekanizmave që do të drejtojnë, planifikojnë, monitorojnë dhe vlerësojnë cilësinë e shërbimeve publike dhe do të ndihmojnë në zbatimin e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA)⁶⁷. Ndërsa, SRRM përqendrohet në minimizimin e barrës administrative, me fokus të veçantë në biznese, duke rritur konkurrencën ekonomike.

Strategjia (SMAP) u pasua nga Plani i Veprimit për SMAP 2015-2017 dhe përfshin 54 aktivitete, nga të cilat 16 janë përfunduar plotësisht, ndërsa 22 aktivitete të tjera ishin në proces të zbatimit. Aktivitetet e tjera nuk janë kryer dhe janë transferuar në Planin e Veprimit 2018-2020⁶⁸. Duhet të theksohet se objektivi specifik në lidhje me ofrimin e shërbimeve përmes qendrave për informim të qytetarëve pritej të zbatohet në vitin 2017. Sidoqoftë, ky objektivi është ri-planifikuar në Planin e Veprimit për 2018-2020 dhe pritej të zbatohet në tremujorin e fundit të vitit 2018⁶⁹. Në Planin e Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike 2018-2020⁷⁰, në sektorin e ofrimit të shërbimeve janë 5 objektiva dhe 22 aktivitete. Lidhur me zbatimin e

64 Në dispozicion në:

http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Better_Regulation_Strategy_2_0_for_Kosovo_-_ALBANIAN.pdf

65 Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021. Gjendet në:

http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/National_Development_Strategy_2016-2021_ENG.pdf

66 Në dispozicion në: <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia-per-Modernizimin-e-Administrates-Publike-Shtator-2015-2020.pdf>

67 Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020. Në dispozicion në:

<https://mpb.rks-gov.net/ap/page.aspx?id=1,127>

68 Instituti GAP (2017). Monitorimi i Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2017. Në dispozicion në:

http://www.institutigap.org/documents/61657_monitorimi_strategjise_2015-2017%20GAP.pdf

69 Draft Plani i Punës për Zbatimin e Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike 2018-2020

70 Plani i Veprimit për Zbatimin e Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike 2018-2020. Në dispozicion në:

<https://mpb.rks-gov.net/ap/page.aspx?id=1,127>

këtyre aktiviteteve, Departamenti i Administratës Publike, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është ende në proces të përgatitjes së raportit përfundimtar se sa aktivitete janë zbatuar, sa janë në proces dhe sa prej tyre nuk kanë arriti të zbatohen⁷¹.

Në këtë Monitorim të RAP, është ndërtuar një qendër për informim të qytetarëve në komunën e Prizrenit, e cila për sa i përket infrastrukturës i plotëson të gjitha kushtet, por nuk i kryen të gjitha veprimet siç kërkohet nga LPPA. Për këtë arsye, me mbështetjen e Komisionit Evropian në fund të vitit 2020, u ndërmor një iniciativë për të rishikuar 5 shërbime në të cilat ekziston ndërveprimi i të paktës dy institucioneve, ku qëllimi ishte të jepnin rekomandime thelbësisht të vlefshme për krijimin e një njësie, pikë kontakti siç kërkohet nga LPPA.

Për të kompletuar kornizën strategjike për fushën e ofrimit të shërbimeve, Qeveria kishte aprovuar Strategjinë për Rregullim më të Mirë 2017-2021 që synon të zvogëlojë barrën administrative dhe Strategjinë e E-Qeverisjes (SEQ) 2016-2020 e cila është hartuar, megjithatë, nuk arriti të miratohet brenda afatit kohor të propozuar. Prandaj, për këtë periudhë të Monitorimit të RAP ky veprim është i parëndësishëm.

Sipas Raportit SIGMA-s, SMAP dhe SEQ nuk ishin të sinkronizuara mirë. Strategjia e parë pranon krijimin e pikave me një ndalesë si bazë për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, ndërsa strategjia e dytë, me përjashtim të portalit shtetëror, nuk u referohet atyre fare. Një rezultat i dukshëm në zbatimin e Strategjisë për Rregullim më të Mirë në këtë monitorim të RAP është miratimi i koncept dokumentit për zvogëlimin e barrës administrative të miratuar nga Qeveria në mars të vitit 2020⁷².

Për sa i përket kornizës institucionale, Ministria e Administratës Publike (tani një departament brenda Ministrisë së Punëve të Brendshme⁷³) është përgjegjës për udhëheqjen e reformës në fushën e ofrimit të shërbimeve, megjithatë, nuk ka ndonjë strukturë përgjegjëse ose të paktën një nëpunës të vetëm civil që do të angazhohej rregullisht me politikën e ofrimit të shërbimeve publike administrative⁷⁴. Prandaj, ekziston një mungesë serioze e lidershit dhe strukturës institucionale. Përgjegjësia për koordinimin e reformës së ofrimit të shërbimeve elektronike i takon institucionit të saj vartës, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI). Sidoqoftë, koordinimi ndërmjet këtyre dy institucioneve (MPB dhe ASHI) vlerësohet të jetë shumë i dobët⁷⁵.

Në mënyrë të ngjashme siç thuhet në monitorimin e fundit të RAP të 2017/18, kapacitetet e nëpunësve civil në Departamentin e Administratës Publike janë të dobëta, kryesisht për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe shpërndarjes joadekuate të përgjegjësive. Nuk ka një ndarje të qartë të përgjegjësive për koordinimin e ofrimit të shërbimeve në një nga njësitë brenda departamentit, as nuk ka burime të mjaftueshme për të ndjekur zbatimin e agjendës së ofrimit të shërbimeve. Kjo ka rezultuar në mungesë të monitorimit adekuat mbi zbatimin e reformave në fushën e ofrimit të shërbimeve⁷⁶. Megjithatë Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) ka përgjegjësinë e politikave të shërbimeve publike administrative, aktualisht situata është e fragmentuar në aspektin e politikëbërjes sepse disa institucione janë përgjegjëse për segmente të caktuara të shërbimeve publike administrative. Kjo ndodh, për shembull, në vetë sistemin ministror të MPB-së, ku politikën e shërbimeve administrative merren praktikisht nga ISA (kundrejt Ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura). Nga ana tjetër, Zyra e Kryeministrit me uljen e barrës administrative dhe uljen e lejeve dhe licencave, ndërsa MTI merret me reformën e inspektiveve. E njëjta situatë ndodh në E-Qeverisjen ku të paktën tri institucione kanë përgjegjësi, ndërsa në praktikë ka ndodhur që disa

71 Intervistë me nëpunësin civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Informacioni u mor në 10 mars 2021;

72 Koncepti dokumenti për barrën administrative i nxjerrë nga Zyra e Kryeministrit. Në dispozicion në: https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/04/Koncept-Dokumenti-p%C3%ABr-Zvog%C3%ABlimin-e-Barr%C3%ABs-Administrative-Shqip_.pdf

73 Qeveria Kurti, e formuar në shkurt të vitit 2020, bashkoi Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

74 Rregullorja (QRK) - Nr.06 / 2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=28172>

75 Raporti i Monitorimit i SIGMA për Kosovën 2019. Në dispozicion në: <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2019-Kosovo.pdf>

76 Raporti i Monitorimit i SIGMA për Kosovën 2019. Në dispozicion në: <http://www.sigmaweb.org/publications/Monitoring-Report-2019-Kosovo.pdf>

përgjegjësi të dyfishohen ndërsa të tjerat të refuzohen⁷⁷.

Qytetarët nuk janë të kënaqur me Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative (LPPA), që hyri në fuqi në qershor të vitit 2017. Ligji i cili u konsiderua një zhvillim pozitiv në periudhën e fundit të monitorimit, pasi që ligjet e veçanta nuk janë të harmonizuara mirëpo procedurat e shërbimit në sportele mbeten të njëjta⁷⁸.

Sipas Raportit SIGMA 2019, digjitalizimi i shërbimeve konsiderohet të jetë në zhvillim, në mënyrë të ngjashme si në periudhën e fundit të monitorimit të 2017/18. Për shkak se ka një mungesë të një politike të qartë për digjitalizimin e shërbimeve administrative, vetëm pak agjenci kanë arritur të bëjnë që shërbimet e tyre të funksionojnë mirë në mënyrë digjitale. Vetëm agjencitë më të shkathëta, siç është Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), e kanë arritur këtë digjitalizim⁷⁹. Pengesat kryesore siç janë sigurimi i nënshkrimeve digjitale dhe pagesat online mbeten një pengesë për zhvillimin e mëtejshëm në këtë fushë⁸⁰. Kjo si pasojë e mos harmonizimit të legjislacionit me Rregulloren eIDAS të Bashkimit Evropian⁸¹.

Zhvillime pozitive janë vërejtur në platformën e ndërveprimit, përkatësisht në Portalin Qeveritar që gjatë periudhës raportuese ishte funksionale. Raporti Sigma-s thekson gjithashtu përparimet në fushën e rregullimit më të mirë, ku qëllimi i uljes së lejeve dhe licencave në lidhje me biznesin dhe qytetarët ka arritur një përqindje të konsiderueshme⁸².

Lidhur me përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, është bërë përparim i dukshëm në disa agjenci, përkatësisht në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK). Disa shërbime janë digjitalizuar si certifikatat tatimore, rimbursimet e taksave dhe mbushja formularëve tatimor. Një zhvillim tjetër është përshkruar në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit të Kosovës (ARBK) ku janë ndërmarrë hapa për të digjitalizuar plotësisht procesin e regjistrimit të biznesit⁸³. Sidoqoftë, kjo arritje është rezultat i vetë-iniciativës së agjencive, përkundër mungesës së udhëheqjes dhe koordinimit të nevojshëm nga institucionet qendrore për të mbështetur reformat e ofrimit të shërbimeve, gjë që nuk ka sjellë ndonjë përparim të rëndësishëm në mesin e institucioneve të tjera publike, siç tregohet në anketën e zhvilluar nga Ekipi Hulumtues i WeBER.

Çfarë monitoron WeBER dhe si?

Nën fushën e Ofrimit të Shërbimeve të RAP, monitorohen tri Parimet e SIGMA-s.

- Parimi 1:** Ekziston dhe zbatohet politika për administratën shtetërore të orientuar drejt qytetarëve;
- Parimi 3:** Ekzistojnë mekanizmat për të siguruar cilësinë e shërbimeve publike;
- Parimi 4:** Garantohet qasja në shërbimet publike.

Nga këndvështrimi i shoqërisë civile dhe publikut më të gjerë, këto parime kanë relevancë më të madhe sa i përket adresimit të aspekteve të jashtme të administratës që janë thelbësore për sigurimin e përditshëm të shërbimeve administrative dhe kontaktit me administratën. Në këtë kuptim, këto janë parimet më të rëndësishme për cilësinë e përditshmërisë të qytetarëve.

Qasja ndaj monitorimit të këtyre parimeve mbështetet, së pari, në perceptimin e publikut për politikën e ofrimit të shërbimeve, përfshirë mënyrën se sa pranuese është administrata që t'i ri-dizajnojë shërbimet administrative bazuar në reagimet e qytetarëve. Kjo plotësohet me

77 Për më shumë informacion: Raporti i Auditimit të Performancës. Në dispozicion në: <http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2020/05/Raporti-auditimit-investimet-IT-alb-1.pdf>

78 Raporti SIGMA-s për Kosovën 2019. Në dispozicion në: <http://www.sigmaxweb.org/publications/Monitoring-Report-2019-Kosovo.pdf>

79 Po aty.

80 Raporti SIGMA-s për Kosovën 2019. Në dispozicion në: <http://www.sigmaxweb.org/publications/Monitoring-Report-2019-Kosovo.pdf>

81 eIDAS (Identifikimi Elektronik dhe Shërbimet e Mirëbesimit për Transaksionet Elektronike në Tregun e Brendshëm), https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=uriserv%3AAOJL_2014.257.01.0073.01.EN


82 Po aty.

83 Po aty.

perceptimin e shoqërisë civile rreth aspekteve të dallueshme të ofrimit të shërbimeve. Për më tepër, qasja ndaj Parimeve të përzgjedhura shkon përtej perceptimit, duke hulumtuar aspekte të ekzistencës, disponueshmërisë në internet dhe qasjes së informacionit mbi shërbimet.

Janë përdorur katër tregues, dy të matur plotësisht nga të dhënat e perceptimit (perceptimi i publikut dhe shoqëria civile) dhe dy duke përdorur një kombinim të perceptimit dhe të dhënave në dispozicion të publikut. Anketa e perceptimit publik ka përdorur një mostër me tre faza të probabilitetit që shënjestron publikun. Anketa u përqendrua në ofrimin e shërbimeve të orientuara drejt qytetarëve në praktikë, duke mbuluar aspekte të ndryshme të vetëdijesimit, efikasitetit, digjitalizimit dhe mekanizmave të reagimit.⁸⁴ Meqenëse anketa e perceptimit publik u zbatua gjatë pandemisë COVID19, qytetarëve gjithashtu iu parashtuan pyetje shtesë se sa ishin të interesuar të hulumtonin më shumë rreth shpërthimit të shërbimeve elektronike dhe sa shpesh i kanë përdorur ato gjatë pandemisë. Të dhënat e perceptimit nga këto pyetje nuk u përdorën për matjen e vlerave të treguesve.

Figura. Perceptimi i OSHC-ve në lidhje me kanalet e zgjedhjes, kapacitetet e stafit në trajtimin dhe përshtatjen e shërbimeve me nevojat e grupeve të cenueshme (%)



Shënim: Rezultatet janë të rrumbullakësuara në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të duket se arrijnë deri në 100% N=49 n=40

Në matjen e qasshmërisë në shërbimet administrative për grupet e cenueshme, dhe në zonat e thella, u përdor një studim i shoqërisë civile dhe një grup fokusi me OSHC të zgjedhura⁸⁵, ky i fundit për plotësimin e të dhënave të studimit me gjetje cilësore. Ekzistenca e mekanizmave të komenteve/kontributeve u hulumtua duke kombinuar të dhënat e perceptimit të publikut dhe të dhënat online për mostrën e pesë shërbimeve.⁸⁶ Së fundi, faqet e internetit të ofruesve të të njëjtës mostër të shërbimeve u analizuan për të mbledhur informacione mbi qasshmërinë dhe çmimet e tyre.

84 Perceptimet janë hulumtuar duke përdorur një studim që shënjestron publikun (e moshës 18 vjeç e lart) të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Anketa e perceptimit të publikut ka përdorur një mostër të probabilitetit në shumë faza dhe u administrua duke e kombinuar intervistimin e ndihmuar nga kompjuteri në internet dhe intervistimin përmes telefonit (CAWI dhe CATI), duke përdorur një pyetësor të standardizuar përmes anketave të omnibusit në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni të Veriut, Mali i Zi, dhe Serbi gjatë periudhës 5 maj - 30 maj 2020. Për Kosovën, margjina e gabimit për mostrën e përgjithshme prej 1021 qytetarëve është $\pm 3.12\%$, me nivel të besueshmërisë 95%

85 Anketa e OSHC-ve ishte administruar përmes një pyetësori anonim online. Në Kosovë, anketa u zhvillua në periudhën prej 24 qershor deri me 4 gusht 2020. Metodologjia e mbledhjes së të dhënave përfshinte vetë-intervistimin e ndihmuar nga kompjuteri (CASI). Mostra e anketës ishte N=49.

86 1) Regjistrimi i pronës, 2) regjistrimi i kompanisë (biznesit), 3) regjistrimi i automjeteve, 4) lëshimi i dokumenteve personale: pasaportave dhe letërnjoftimeve, 5) deklarimi dhe pagesa për kompani të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH)

6.3. Rezultatet e Monitorimit të WeBER

Parimi 1: Politikat për administratën shtetërore të orientuar drejt qytetarëve janë të vendosura dhe zbatohen


Treguesi i WeBER OSH P1_I1: Perceptimi publik i orientimit qytetar të administratës shtetërore

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Qytetarët janë të vetëdijshëm për nismat ose projektet e thjeshtimit administrativ të qeverisë	2/2	1/2
Qytetarët konfirmojnë se iniciativat ose projektet e thjeshtimit administrativ të qeverisë kanë përmirësuar ofrimin e shërbimeve	4/4	4/4
Qytetarët konfirmojnë që marrja me administratën është bërë më e lehtë	4/4	4/4
Qytetarët konfirmojnë se koha e nevojshme për të marrë shërbime administrative është zvogëluar	4/4	4/4
Qytetarët konsiderojnë se administrata po shkon drejt qeverisjes digjitale	2/2	2/2
Qytetarët janë të vetëdijshëm për disponueshmërinë e shërbimeve elektronike	1/2	1/2
Qytetarët kanë njohuri për mënyrat se si të përdorin shërbimet elektronike	2/2	1/2
Qytetarët përdorin shërbimet elektronike	0/4	2/4
Qytetarët i konsiderojnë shërbimet elektronike si miqësore për përdoruesit	2/2	2/2
Qytetarët konfirmojnë se administrata kërkon reagime prej tyre se si shërbimet administrative mund të përmirësohen	2/2	1/2
Qytetarët konfirmojnë që administrata përdor reagimet e tyre se si mund të përmirësohen shërbimet administrative	4/4	4/4
Rezultati i përgjithshëm	27/30	25/30
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5)	4/5	4

Ky tregues përbëhet nga të dhënat nga sondazhi i perceptimit publik në Kosovë. Rezultatet e anketës tregojnë një perceptim përgjithësisht pozitiv të publikut ndaj shërbimeve administrative në Kosovë. Njësoj si Monitorimi i fundit i RAP, Kosova ka rezultate pozitive në këtë tregues (4/5).


Rezultatet e anketës tregojnë një perceptim publik përgjithësisht pozitiv ndaj shërbimeve administrative. Në dy vitet e kaluara, 70,13% e të anketuarve janë të vetëdijshëm për përpjekjet e qeverisë për thjeshtimin e administratës, dhe shumica dërrmuese nga ai grup (88.30%) konfirmon se përpjekje të tilla kanë përmirësuar ofrimin e shërbimeve administrative.

Në dy vitet e fundit ka pasur përpjekje ose iniciativa nga ana e qeverisë për të i thjeshtësuar procedurat administrative për qytetarët dhe bizneset




Si rezultat, 72.4% e të anketuarve pajtohen që marrëdhëniet me administratën janë bërë më të lehta, dhe 71.01% pajtohen që koha e nevojshme për të marrë shërbime administrative është zvogëluar.

Sipas përvijës sime, ballafaqimi me administratën është bërë më i lehtë në dy vitet e fundit




Në dy vitet e kaluara, koha e nevojshme për të marrë një shërbim administrativ është zvogëluar




Për më tepër, 74.05% e të anketuarve njohin përpjekjen e administratës për të lëvizur drejt qeverisë digjitale, por më pak, pak më shumë se gjysma (54.06%) janë të vetëdijshëm për disponueshmërinë e shërbimeve elektronike. Është interesant se 76.27% e atyre që janë të njohur me mënyrat se si të përdorin shërbimet elektronike, në fakt i përdorin ato.

Në përgjithësi, ju lutem tregoni se në çfarë mase ju pajtoheni ose nuk pajtoheni me deklaratën në vijim: Në dy vitet e fundit, Qeveria gjithnjë e më shumë ka lëvizur në drejtim të digjitalizimit në administratën e punës?




A e dini se shërbimet elektronike (apo administrative përmes internetit) ofrohen?



Nga ata që janë të vetëdijshëm për disponueshmërinë e shërbimeve elektronike, 86.75% i konsiderojnë ato miqësore për përdoruesit.


Sipas përvojës suaj, sa e lehtë ose sa i vështirë është përdorimi i shërbimeve elektronike në përgjithësi?




Në krahasim me rezultatet nga Monitorimi i RAP 2017/2018, ku u konkludua se administrata nuk ka një marrëdhënie të mirë bashkëpunimi me qytetarët për sa i përket gatishmërisë së saj për të pranuar sugjerimet e qytetarëve, këtë vit 60.53% e të anketuarve pajtohen që administrata

kërkon propozime dhe sugjerime se si të përmirësohen shërbimet. Ndërsa në Monitorimin e RAP 2017/18 vetëm 33.3% e të anketuarve ranë dakord që administrata kërkon propozime të tilla, nga të cilat 80.61% konfirmojnë që qeveria ka përdorur propozimet e tyre për të përmirësuar shërbimet.


Sa të informuar ose të pa-informuar jeni ju për mënyrat se si të përdoren shërbimet elektronike të administratës?




Në dy vitet e fundit, sa shpesh i keni përdorur shërbimet elektronike të administratës?



Në dy vitet e fundit, administrata ka kërkuar nga qytetarët propozime se si të i përmirësojnë shërbimet administrative?




Në dy vitet e fundit, qeveria ka përdorur propozime të tilla nga qytetarët, për të i përmirësuar shërbimet administrative



Në përgjithësi, rezultatet nga cikli i monitorimit 2019-2020 nuk tregojnë ndryshime të mëdha nga cikli 2017-2018. Dallimi i vetëm i qartë është në lidhje me perceptimet e qytetarëve për marrëdhëniet bashkëpunuese të administratave me ta. Në Monitorimin e RAP 2017-18, vetëm 33.2% e të anketuarve ranë dakord që administrata kërkon propozime se si të përmirësojë shërbimet e saj, ndërsa në Monitorimin e RAP 2019-20 kjo përqindje është rritur në 60.53%.

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi P1_I1: Perceptimi publik i orientimit qytetar të administratës shtetërore



Parimi 3: Mekanizmat për të siguruar cilësinë e shërbimeve publike janë në dispozicion


Treguesi i WeBER OSH P3_I1: Perceptimi publik dhe disponueshmëria e informacionit mbi reagimet e qytetarëve në lidhje me cilësinë e shërbimeve administrative

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Qytetarët konsiderojnë se kanë mundësinë të ofrojnë komente mbi cilësinë e shërbimeve administrative	2/2	1/2
Qytetarët i perceptojnë mekanizmat e reagimit si të lehtë për t'u përdorur	2/4	4/4

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Qytetarët e perceptojnë veten ose shoqërinë civile si të përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve administrative	2/4	2/4
Qytetarët perceptojnë se shërbimet administrative janë përmirësuar si rezultat i monitorimit dhe vlerësimit nga qytetarët	4/4	4/4
Informacioni bazë në lidhje me reagimet e qytetarëve për shërbimet administrative është i disponueshëm publikisht	2/4	2/4
Informacioni i avancuar në lidhje me reagimet e qytetarëve për shërbimet administrative është i disponueshëm për publikun	1/2	1/2
Rezultati i përgjithshëm	13/20	14/20
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5)	3	3


Rezultatet tona tregojnë se 67.29% e qytetarëve të anketuar të Kosovës pajtohen se kanë mundësi të japin mendimet e tyre mbi cilësinë e shërbimeve individuale të marra; në Monitorimin e RAP 2017-18, kjo përqindje ishte 37.6%. Nga të anketuarit që, në dy vitet e fundit, kanë dhënë mendimin e tyre mbi cilësinë e shërbimeve administrative, 50.69% e kanë të lehtë ose shumë të lehtë të përdorin kanalet e disponueshme reagimit.

Si një përdorues i shërbimeve administrative, e kam mundësinë për ta dhënë mendimin tim mbi cilësinë e shërbimeve individuale që i pranoj (marr)




55,38% e qytetarëve të anketuar të Kosovës pajtohen se në dy vitet e fundit, qytetarët ose shoqëria civile kanë qenë të përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve administrative. Kjo përqindje është mjaft e lartë krahasuar me rezultatet e ciklit të fundit të monitorimit në 2017-18, ku ky numër ishte 32.9%. Nga ata që besojnë se shoqëria civile ose qytetarët janë të përfshirë në proceset e monitorimit dhe vlerësimit, 82.72% pajtohen që qeveria ka përmirësuar shërbimet administrative si rezultat i një monitorimi të tillë.

Në dy vitet e fundit, si rezultat i një monitorimi të tillë nga qytetarët ose shoqëria civile, qeveria i ka përmirësuar shërbimet administrative




Në dy vitet e fundit, një iniciativë e tillë nga qeveria ka çuar në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve



Nga ana tjetër, analiza e faqes në internet, sugjeron që informacioni bazë dhe i avancuar mbi reagimet e qytetarëve për shërbimet administrative publikohet vetëm për shërbimet e ndërlidhura me TVSH-në të administratës tatimore dhe shërbimet kadastrale. Informacioni i publikuar për shërbimet e TVSH-së të administratës tatimore është i ndarë sipas rajoneve, moshës së individëve dhe madhësisë së bizneseve në fjalë, ndërsa për shërbimet kadastrale sipas rajoneve, gjinive dhe etnive të interesuara.

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi P3_I1: Perceptimi publik dhe disponueshmëria e informacionit mbi reagimet e qytetarëve në lidhje me cilësinë e shërbimeve administrative




Parimi 4: Qasja në shërbimet publike është siguruar

Treguesi i WeBER OSH P4_I1: Perceptimi i OSHC-ve për qasjen e shërbimeve administrative



Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
OSHC-të konfirmojnë mjaftueshmërinë e rrjetit territorial për qasje në shërbimet administrative	2/4	0/4
OSHC-të konfirmojnë që qendrat për informim të qytetarëve janë të arritshme për të gjithë	0/4	0/4
OSHC-të konsiderojnë që shërbimet administrative të ofrohen në një mënyrë që plotëson nevojat individuale të grupeve të cënueshme	0/4	0/4
OSHC-të konfirmojnë që ofruesit e shërbimeve administrative janë trajnuar se si të trajtojnë grupet në nevojë	0/2	0/2
OSHC-të konfirmojnë që administrata ofron kanale të ndryshme të zgjedhjes për marrjen e shërbimeve administrative	1/2	1/2
OSHC-të konfirmojnë që kanalet elektronike janë lehtësisht të qasshme për personat me aftësi të kufizuara	0/2	0/2
Rezultati i përgjithshëm	3/18	0/2
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5)	0	1/20

Rezultatet e anketës së OSHC-ve të Monitorimit të RAP 2019/2020 tregojnë se 37.5% e OSHC-ve zbulojnë se administrata publike siguroi kanale të ndryshme për marrjen e shërbimit administrativ, i cili është më i ulët se monitorimi i fundit ku ranë dakord më shumë se gjysma (55%).

Sipas përvojës suaj, sa është e lehtë apo e vështirë për të përdorur kanalet për qytetarët për ta dhënë mendimin e tyre në lidhje me cilësinë e shërbimeve administrative?




Në dy vitet e fundit, qytetarët apo shoqëria civile kanë qenë të përfshirë në monitorimin e shërbimeve administrative



Shënim: rezultatet janë të rumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt. Për shkak të rumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të arrijnë në 100%. N=49 n=40

Administrata publike ofron kanale të ndryshme të zgjedhjes
(personalisht, elektronike) për të marrë shërbime administrative



Shënim: rezultatet janë të rumbullakësuar në numrin e plotë më të afërt.
Për shkak të rrumbullakësimit, përqindjet jo gjithmonë mund të arrijnë në 100%.
N=49 n=40

Në deklaratën lidhur me atë nëse ofruesit e shërbimeve administrative janë shpërndarë në mënyrë adekuate në mënyrë të tillë që të gjithë qytetarët të kenë qasje të lehtë nëpër territoret e vendit, rezultatet e Monitorimit të RAP të këtij viti qëndrojnë më mirë se ai i mëparshmi, pasi më shumë se 30% janë pajtuar ose janë pajtuar plotësisht krahasuar me 22.5% në Monitorimin e RAP 2017/2018.

Një rënie në marrëveshje është e dukshme në deklaratën në lidhje me qendrat për informim të qytetarëve d.m.th. nëse ato janë lehtësisht të qasshme nga të gjithë qytetarët, duke arritur në vetëm 12.5% të të anketuarve, ndërsa më parë ishte 25%. Këtë herë, mosmarrëveshjet ndërmjet OSHC-ve mbi këtë çështje janë deri në 40%.

Kur bëhet fjalë nëse ofrimi i shërbimit administrativ është përshtatur me deklaratën e nevojave të grupeve në nevojë, rezultatet e anketës të OSHC-ve mbeten të njëjtat me ciklin e mëparshëm të monitorimit, me vetëm 10% që pajtohen dhe shumica e 65% besojnë të kundërtën (nuk pajtohem ose nuk pajtohem plotësisht). Në të njëjtën kohë, vetëm 5% e OSHC-ve pajtohen që, në përgjithësi, stafi që punon në ofrimin e shërbimeve administrative është trajnuar se si të trajtojë grupet në nevojë, dhe afër dy të tretat e të anketuarve (62.5%) shprehën mos-pajtueshmëri në përgjithësi.

Së fundi, rezultatet për deklaratën në lidhje me lehtësinë e qasjen në kanalet elektronike për shërbimet administrative për grupet në nevojë tregojnë se vetëm 10% e OSHC-ve pajtohen që këto kanale janë lehtësisht të qasshme, megjithëse më shumë se gjysma ose 55% nuk pajtohen ose nuk pajtohen plotësisht.

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi OSH P4_I1: Perceptimi i OSHC-ve për qasjen e shërbimeve administrative

Treguesi i WeBER OSH P4_I2: Disponueshmëria e informacionit në lidhje me ofrimin e shërbimeve administrative në faqet e internetit të ofruesve të shërbimeve

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Faqet e internetit të ofruesve të shërbimeve administrative përfshijnë informacionin e kontaktit për ofrimin e shërbimeve	2/4	2/4
Faqet e internetit të ofruesve të shërbimeve administrative përfshijnë informacionin bazë procedural se si të keni qasje në shërbimet administrative	2/4	2/4
Faqet e internetit të ofruesve të shërbimeve administrative përfshijnë udhëzime miqësore për qytetarët për qasjen në shërbimet administrative	1/2	1/2
Faqet e internetit të ofruesve të shërbimeve administrative përfshijnë informacion mbi të drejtat dhe detyrimet e përdoruesve	2/2	1/2
Institucionet individuale që ofrojnë shërbime administrative në nivelin qendror publikojnë informacione mbi çmimin e shërbimeve të ofruara	4/4	2/4
Informacioni mbi çmimet e shërbimeve administrative bën dallimin midis shërbimeve elektronike dhe shërbimeve personale	0/2	0/2
Informacioni mbi shërbimet administrative është në dispozicion në formate të hapura të të dhënave	0/2	0/2
Rezultati i përgjithshëm	11/20	8/20
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5)	2	1

Analiza tregon se informacioni i kontaktit për ofrimin e shërbimit është i disponueshëm në shumicën e shërbimeve model, përveç regjistrimit të automjetit dhe lëshimit të dokumenteve personale (letërnjoftimet dhe pasaportat). Të dyja këto shërbime ofrohen nga Agjencia për Regjistrim Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.

Përshkrimi i shërbimit dhe ku dhe si të merren këto shërbime janë gjithashtu të pranishëm për të gjitha shërbimet model, përveç regjistrimit të automjetit dhe lëshimit të letërnjoftimeve dhe pasaportave. Udhëzimet miqësore për qytetarët për qasje në shërbimet administrative, dhe informacioni mbi të drejtat dhe detyrimet e një përdoruesi janë në dispozicion në të gjitha shërbimet model, përsëri, përveç regjistrimit të automjetit dhe lëshimit të dokumenteve personale.


Informacioni mbi çmimet publikohet në internet për të gjitha shërbimet model; megjithatë, nuk ka informacion në dispozicion për ndryshimin e çmimeve nëse shërbimi ofrohet në internet. Duhet të theksohet se regjistrimi i automjeteve dhe lëshimi i shërbimeve të dokumenteve personale nuk kanë në dispozicion një sistem të shërbimit elektronik. Së fundmi, asnjë informacion në lidhje me shërbimet në shërbimet model nuk publikohet në formatet e të dhënave të hapura në faqet zyrtare të internetit, gjë që ndikon seriozisht në transparencën dhe mundësitë e qytetarëve për të pasur qasje në këto shërbime.

Regjistrimi i automjeteve dhe shërbimet e lëshimit të dokumenteve personale sigurohen nën autoritetin e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (me qeverinë Kurti 2020, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administratës Publike u bashkuan në një Ministri; prandaj, edhe faqet e tyre të internetit u bashkuan gjithashtu (<https://map.rks-gov.net/>). Sidoqoftë, pasi faqja në internet ishte në ndërtim e sipër në ciklin tonë të monitorimit, nuk ka informacion në dispozicion në lidhje me këto shërbime. Kur u kontaktuan nga ekipi ynë, zyrtarët nga ministria ofruan informacionin se faqja në internet është ende në ndërtim e sipër dhe se do të lëshohet në verën e vitit 2020 pa dhënë një datë të caktuar. Informacioni që gjurmohet në këtë

tregues për të dy shërbimet rrjedh nga faqja në internet e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike. Informacioni ishte pjesërisht i disponueshëm; megjithatë, që nga formimi i qeverisë Kurti më 03.06.2020, faqja në internet është plotësisht e pa-disponueshme dhe e paqasshme.

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi OSH P4_I2: Perceptimi i OSHC-ve për qasjen e shërbimeve administrative



6.4. Rezultatet përmbledhëse: Ofrimi i Shërbimeve

WeBER i afrohet ofrimit të shërbimeve nga këndvështrimi i orientimit ndaj qytetarëve, duke u përqendruar në perceptimet e publikut dhe shoqërisë civile në lidhje me disponueshmërinë dhe mundësinë e përdorimit të shërbimeve. Gjithashtu hulumton aspektet e disponueshmërisë dhe qasjes të informacionit mbi shërbimet. Rezultatet e këtij monitorimi të RAP, ngjashëm si monitorimi i fundit i RAP, tregojnë se qytetarët e Kosovës konsiderojnë se administrata ndjek një ofrim të shërbimeve të orientuara drejt përdoruesit dhe mbizotëron perceptimi paksa pozitiv mbi politikën e ofrimit të shërbimeve.

Rezultatet e anketës në përgjithësi tregojnë një perceptim publik përgjithësisht pozitiv ndaj shërbimeve administrative. Qytetarët janë të vetëdijshëm për përpjekjet e qeverisë për thjeshtimin dhe shumica e qytetarëve që u anketuan konfirmojnë se përpjekje të tilla thjeshtimi kanë përmirësuar ofrimin e shërbimeve administrative.

Është interesante se mbi gjysma e qytetarëve janë të vetëdijshëm për disponueshmërinë e shërbimeve elektronike, por një numër shumë i ulët i atyre qytetarëve i përdorin ato në të vërtetë.

Gjysma e qytetarëve të anketuar konfirmojnë se në dy vitet e fundit qytetarët ose shoqëria civile kanë qenë të përfshirë në monitorimin dhe vlerësimin e shërbimeve administrative.

Megjithatë, ekziston një mungesë e madhe e digjitalizimit të faqeve të internetit dhe shërbimeve online për regjistrimin e pronës, regjistrimin e biznesit, regjistrimin e automjeteve dhe lëshimin e dokumenteve personale (pasaportat dhe letërnjoftimet).

Shkrijja e Ministrisë së Administratës Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në Qeverinë e parë Kurti në mars të vitit 2020, ka çuar në një mosfunksionim të faqeve dhe shërbimeve për të dy ministritë përkatëse. Disponueshmëria e informacionit në shumicën e shërbimeve model që ofrohen nga këto ministri akoma mungon. Ndryshimet e shpeshta në qeveri dhe paqëndrueshmëria politike ndikuan në qëndrueshmërinë e ministrive të përmendura më lart.

6.5. Evidentimi i rekomandimeve nga Monitorimi i RAP 2017/2018

Rekomandimi	Statusi	Komenti
Ofruesit e shërbimeve duhet të angazhohen më shumë me qytetarët për të rritur ndërgjegjësimin e tyre. Kjo mund të arrihet duke përdorur mënyra miqësore për qytetarët për informimin e qytetarëve në internet. Disa nga mjetet që mund të përdoren përfshijnë përmbajtje mediale, udhëzime dhe broshura të ilustruara dhe lehtësisht të kuptueshme. Publikimi i këtyre informacioneve dhe dokumenteve të rëndësishme përveç që publikohen në faqen e internetit të ofruesve të shërbimeve duhet gjithashtu të promovohet përmes mediave sociale dhe kanaleve të tjera të komunikimit..	I iniciuar	Ekzistojnë disa iniciativa që informojnë në mënyrë proaktive qytetarët dhe bizneset se si të krijojnë një shërbim të caktuar. Megjithatë, ekziston ende një mungesë e qasjes sistematike që kjo veprimtari të zbatohet siç rekomandohet.
Praktikat më të mira në fushën e ofrimit të shërbimeve duhet të ndahen në mënyrë që institucionet të mësojnë dhe zbatojnë praktika të tilla. Për ta arritur këtë, komunikimi (shkëmbimi i informacionit) ndërmjet institucioneve duhet të lehtësohet dhe mënyrat për të shkëmbyer përvojat duhet të zhvillohen siç sugjerohet nga Raporti SIGMA-s. Kjo si rezultat do të rrisë koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet ofruesve të shërbimeve si dhe do të drejtojë progresin në reformat në mesin e institucioneve të tjera.	I pazbatuar	E njëjta qasje vazhdon ende. Megjithëse ka iniciativa të mira, por ato mbeten të izoluara në mungesë të një organi shtetëror i cili do të ishte përgjegjës për politikën e shërbimeve administrative dhe të koordinonte këto procese, por edhe për t'i ndarë këto praktika me institucionet e tjera.
Informacion bazë procedural për mënyrën e qasjes në shërbimet administrative (të tilla si përshkrimi i shërbimeve, vendndodhja fizike, udhëzimet se si të shfrytëzohen shërbimet në internet dhe format origjinale) duhet të sigurohen në faqet e internetit të të gjithë ofruesve të shërbimeve, siç është rasti me Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit të Kosovës dhe Administratën Tatimore	I zbatuar pjesërisht	Portali shtetëror i platformës elektronike përmban një listë të shërbimeve dhe një përshkrim të shkurtër të shërbimeve (të cilat janë kryesisht të vjetruara dhe jofunksionale) por jo elementi tjetër në këtë rekomandim. Portali e-Kosova si një platformë e re synon të përfshijë edhe këto elemente. Në nivelin lokal, portali elektronik Prishtina Online adreson pjesën më të madhe të kërkesave në këtë rekomandim.
Ofruesit e shërbimeve duhet të sigurojnë informacione thelbësore për shërbimet që ata ofrojnë, të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe tarifën e shërbimeve, në vend që të sigurojnë vetëm përshkrim të thatë, burokratik të informacionit bazë. Diferencat midis shërbimeve elektronike dhe shërbimeve personale nëse janë evidente duhet gjithashtu të specifikohen qartë.	I pazbatuar	Asnjë portal elektronik ose informacion fizik për shërbimet nuk është identifikuar në përputhje me elementet e përcaktuara në këtë rekomandim.

Rekomandimi	Statusi	Komenti
Udhëzime miqësore për qytetarët duke përdorur përmbajtje mediale, udhëzime dhe broshura të kuptueshme lehtë, mekanizma inovative për komunikim, informacion bazë për qasje në shërbimet administrative, dhe informacioni mbi të drejtat dhe detyrimet e një përdoruesi duhet të jetë i disponueshëm në faqen e internetit të institucioneve që ofrojnë shërbime - si në rastin e Agjencisë së Regjistrimit të Biznesit të Kosovës, Agjencisë Kadastrale dhe Administratës Tatimore.	I iniciuar	Ekzistojnë disa iniciativa, por një qasje sistematike për të zbatuar këtë rekomandim mungon.
Kutitë elektronike duhet të implementohen në të gjithë ofruesit e shërbimeve. Për më tepër, përveç kësaj iniciativa duhet të promovohet në faqen e internetit të ofruesve të shërbimeve si dhe përmes kanaleve ekzistuese të mediave sociale.	I zbatuar pjesërisht	Platforma OPI është publikuar në mënyrë elektronike dhe fizike (përmes vendosjes së disa kutive elektronike në disa institucione), megjithatë, shërbimet që u prezantuan për herë të parë nuk janë zëvendësuar.
Informacioni në lidhje me shërbimin duhet të publikohet në formatet e të dhënave të hapura në faqet zyrtare të internetit dhe deri më tani asnjë institucion në mostrën tonë nuk publikon të dhëna në një format të tillë.	I iniciuar	Një link i të dhënave të hapura ekziston në http://opendata.rks-gov.net por nuk është funksional për të konfirmuar nëse të dhënat janë në atë format
Ofruesit e shërbimeve dhe organet e tjera të administratës publike duhet të publikojnë në mënyrë aktive rezultatet dhe trendet e reagimit të paktën përmes faqeve të tyre të internetit. Për më tepër, duhet të ketë një qasje të integruar ndërmjet institucioneve që ofrojnë shërbime në vlerësimin e kënaqësisë së klientit në lidhje me shërbimet e ofruara nga institucioni i tyre. Kjo do të shërbente si një bazë fillestare për të ndihmuar institucionet për të vlerësuar kënaqësinë e qytetarëve me ofrimin e shërbimeve, për të nxjerrë në pah fushat që kanë nevojë për prioritet sipas perceptimit të klientit, për të identifikuar karakteristikat e klientëve në mënyrë që shërbimet të hartohen dhe ofrohen në një mënyrë që nevojat e secilit grup të mund të plotësohen në e ardhmja.	I pazbatuar	Asnjë raport nuk është prodhuar në lidhje me kënaqësinë e përdoruesve të shërbimeve
Ofruesit e shërbimeve duhet të inkurajojnë përdoruesit të dërgojnë vetë propozime për përmirësime. Të mbledhura në internet, ose në ambientet e ofruesve të shërbimeve, rezultati i këtyre propozimeve duhet të raportohet në publik, dhe kanalet për paraqitjen e tyre dallohen nga pjesa e përgjithshme e komenteve	I pazbatuar	Asnjë iniciativë e tillë nuk është vërejtur

Rekomandimi	Statusi	Komenti
Ofruesit e shërbimeve duhet të sigurojnë qasje për këtë grup qytetarësh së pari duke siguruar qasje në ndërtesat publike për njerëzit me nevoja të veçanta. Për më tepër, nevojat e personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të cenueshme në vend duhet të identifikohen dhe të pasohen nga zhvillimi i një qasjeje të bazuar në nevoja, e cila do të lejojë marrjen e duhur të shërbimeve dhe zvogëlimin e diskriminimit.	I zbatuar pjesërisht	Sa i përket qasjes në ndërtesa, pothuajse të gjitha ndërtesat në të cilat akomodohen institucionet publike janë të pajisura me qasje për personat me aftësi të kufizuara, por kjo nuk ndodh me mjetet për disa kategori të personave me aftësi të kufizuara (për shembull pajisje për të lexuar dhe shkruar për personat e verbër, mekanizma dëgjimi për të shurdhrit, etj.)

6.6. Rekomandimet e Monitorimit të RAP 2019/2020

Vetëm disa nga ofruesit e shërbimeve model në Kosovë botojnë në internet disa informacione në lidhje me shërbimet që ata ofrojnë. Prandaj, ka vend për përmirësim në strukturë, cilësi dhe shikueshmëri të informacionit:

- Ofruesit e shërbimeve duhet të sigurojnë informacione thelbësore për shërbimet që ata ofrojnë, të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve dhe tarifën e shërbimeve, në vend që të ofrojnë vetëm përshkrim të thatë, burokratik të informacionit bazë. Ndryshimi ndërmjet shërbimeve elektronike dhe shërbimeve personale nëse janë evidente duhet gjithashtu të specifikohen qartë.

Kanalet zyrtare të disponueshme për komunikim të dyanshëm me marrësit e shërbimeve ende nuk lejojnë mbledhjen e reaguesve domethënëse dhe sistematike. Si pasojë, politika e ofrimit të shërbimeve vështirë se bazohet në kënaqësinë e klientit.

- Ofruesit e shërbimeve dhe organet e tjera të administratës publike duhet të publikojnë në mënyrë aktive rezultatet dhe trendet e reagimit të paktën përmes faqeve të tyre të internetit. Për më tepër, duhet të ketë një qasje të integruar në mesin e institucioneve që ofrojnë shërbime në vlerësimin e kënaqësisë së klientit në lidhje me shërbimet e ofruara nga institucioni i tyre. Kjo do të shërbente si një bazë fillestare për të ndihmuar institucionet për të vlerësuar kënaqësinë e qytetarëve me ofrimin e shërbimeve, për të nxjerrë në pah fushat që kanë nevojë për prioritet sipas perceptimit të klientit, për të identifikuar karakteristikat e klientëve në mënyrë që shërbimet të hartohen dhe ofrohen në një mënyrë që nevojat e secilit grup të mund të plotësohen në të ardhmen.
- Ofruesit e shërbimeve duhet të inkurajojnë përdoruesit të dërgojnë vetë propozime për përmirësime. Të mbledhura në internet, ose në mjediset e ofruesve të shërbimeve, rezultati i këtyre propozimeve duhet të raportohet në publik, dhe kanalet për paraqitjen e tyre dallohen nga pjesa e përgjithshme e komenteve.
- Baza ligjore duhet të jetë e thjeshtë dhe e harmonizuar për sa i përket ligjeve të veçanta që përmbajnë procedura të veçanta administrative me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
- Duhet të vendoset një bazë ligjore për përdorimin e shërbimeve elektronike, duke përfshirë miratimin e projektligjit për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara në transaksionet elektronike dhe zbatimin e tij në praktikë.
- Administrata publike duhet të jetë më pro aktive në publikimin e shërbimeve publike administrative në faqen e internetit dhe duke publikuar të paktën këto informacione: të gjitha shërbimet e ofruara, me pagesë ose pa pagesë, kohën për realizimin e shërbimit dhe personin përgjegjës me të dhënat e tij.
- Institucionet duhet të fillojnë krijimin e qendrave për informim të qytetarëve në mënyrë që t'u ofrojnë qytetarëve shërbime administrative publike në mënyrë sa më të shpejtë dhe efikase.

7. MENAXHIMI I FINANCAVE PUBLIKE

The background features a large, abstract geometric design. A bright blue triangle is positioned in the top right corner. Below it, a white diagonal line separates the upper section from a larger area. This area is dominated by a large, dark blue triangle that points upwards, outlined by a thick orange border. The overall composition is clean and modern, using a limited color palette of blue, orange, and white.

7.1. Treguesit e WeBER të përdorur në Menaxhimin e Financave Publike dhe vlerat e vendit për Kosovën

P5_I1: Transparenca dhe qasja e dokumenteve buxhetore					
0	1	2	3	4	5
P6_8_I1: Disponueshmëria publike e informacionit mbi kontrollet e brendshme financiare publike dhe shqyrtimi parlamentar					
0	1	2	3	4	5
P16_I1: Komunikimi dhe bashkëpunimi i Institucionit Suprem të Auditimit me publikun që ka të bëjë me punën e tij					
0	1	2	3	4	5
P11_13_I1: Disponueshmëria e informacionit lidhur me prokurimin publik për publikun					
0	1	2	3	4	5

7.2. Gjendja aktuale në Menaxhimin e Financave Publike

Brenda reformave të parashikuara në Reformën e Administratës Publike (RAP) në Kosovë, sigurimi i një Menaxhimi modern të Financave Publike (MFP) është një hap vendimtar. Fusha e reformës në Menaxhimin e Financave Publike bie nën përgjegjësinë e Ministrisë së Financave (MF). Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP 2016-2020) mbetet dokumenti kryesor strategjik i reformës në këtë fushë. SRMFP është themeluar nga 4 shtylla, e cila përmban edhe 12 prioritete kryesore. SRMFP është një strategji gjithëpërfshirëse e ndarë në katër shtylla kryesore dhe synon të arrijë një menaxhim të mirë funksional financiar duke përmirësuar sistemet që sigurojnë disiplinën fiskale, efikasitetin operacional dhe alokimin efektiv të burimeve publike të Kosovës, si dhe çështjet e ndërlidhura të MFP-së (ndër të tjera transparenca e buxhetit).⁸⁷ Prioritetet janë bazuar në gjetjet e boshllëqeve kryesore në fushën e MFP në Kosovë, dhe disa prej tyre janë thelbësore në mirë-funksionimin e efikasitetit të përgjithshëm të sistemit, siç janë kontrollet efektive të angazhimit, zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve, forcimi i auditimit të brendshëm/të jashtëm dhe përmirësimi i sistemeve të IT, ndër të tjera. SRMFP parashikon planet kryesore të reformës në menaxhimin e procesit të buxhetit, mes tjerash "planifikimin strategjik dhe përgatitjen e buxhetit", "ekzekutimin e buxhetit", "kontabilitetin dhe raportimin" dhe "auditimin dhe mbikëqyrjen".

Progresi i kënaqshëm i SRMFP është deklaruar gjatë vitit 2019, 38 nga 49 aktivitetet e planifikuara u zbatuan. 78% e aktiviteteve janë zbatuar, ndërsa 22% kanë ngecur⁸⁸. Gjatë vitit 2019, 19 tregues ishin në radhë për t'u arritur, rezultatet tregojnë se 12 prej tyre janë arritur, ndërsa 7 prej tyre janë arritur pjesërisht. Përsëri, gjatë vitit 2019, trendët pozitive u përshkruan në devijimin mesatar të parashikimeve të të ardhurave nga taksat, në zvogëlimin e numrit të trasfereve dhe një rritje të numrit të tatimpaguesve që deklarojnë të ardhurat e tyre vullnetarisht.⁸⁹

SRMFP përfshin tregues që monitorojnë progresin në lidhje me objektivat specifike. Praktika ishte për të përshkruar dhe përcaktuar në detaje treguesit në pasaportat treguese të zhvilluara veçmas për secilën strategji. Sidoqoftë, pasaporta e fundit treguese u prodhua në vitin 2017.

Raportet mbi progresin e zbatimit të SRMFP janë nxjerrë dhe janë në dispozicion të publikut në faqen e internetit të MF.⁹⁰ Raporti mbi SRMFP shpreh qartë rezultatet për secilin aktivitet të planifikuar dhe raportin brenda kornizës strategjike të RAP për të përfshirë një pasqyrë të qartë të vlerave për të gjithë treguesit e nivelit të rezultatit, në lidhje me Planet e Veprimet. MF e ka hartuar Planin e Veprimet 2019-2020 për zbatimin e SRMFP-së 2016-2020, që përmban

87 Në dispozicion në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Public_Finance_Management_Reform_Strategy2016-2020.pdf

88 Në dispozicion në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/56B47DA6-0475-4A99-BBB5-409A66A32E4E.pdf>

89 Në dispozicion në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/D2B405EB-1A0C-4F67-A35B-486227F19BFF.pdf>

90 Në dispozicion në: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,117>

katër shtylla (disiplina fiskale, efikasiteti i alokimit, efikasiteti operacional dhe çështjet e lidhura me MFP), dymbëdhjetë prioritete dhe disa aktivitete nën secilin prioritet dhe objektiv.⁹¹ Plani i veprimit është i koordinuar, zhvilluar dhe përfshin kostot për këtë fushë.⁹²

Procedurat e prokurimit publik kanë tendenca pozitive për këtë periudhë raportuese dhe kanë qenë gjithnjë e më transparente, përveç zbatimit të kontratës, e cila mbetet subjekt i parregullsisve dhe e prirur për korrupsion.⁹³ Ligji për Prokurimin Publik (LPP) strukturon prokurimin publik në Kosovë dhe hyri në fuqi në tetor të viti 2011; përveç kësaj ishte ndryshuar dy here në vitin 2016.⁹⁴ Organi kryesor përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e sistemit të prokurimit publik është Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP). Anëtarët propozohen nga Qeveria dhe miratohen nga Kuvendi, të përbërë nga një bord me një kryetar dhe dy anëtarë drejtojnë këtë organ.

Strategjia Kombëtare e Prokurimit Publik 2017-2021 ofron objektiva, masa dhe hapa që Qeveria dhe organet kryesore të prokurimit publik synojnë të ndërmarrin.⁹⁵ Strategjia përfshin përparësitë për KRPP-në dhe Grupin Kombëtar të Monitorimit të Strategjisë së Prokurimit Publik për t'u zbatuar gjatë kësaj periudhe, me qëllim të transparencës më të madhe dhe trajtimit të barabartë. Plani i veprimit 2017-19 është botuar në faqen e internetit të KRPP-së, megjithatë, versioni i vitit 2020 nuk është i disponueshëm.⁹⁶

Çfarë monitoron WeBER dhe si?

Monitorimi i fushës së MFP kryhet kundrejt gjashtë Parimeve të SIGMA-s.

- Parimi 5:** Raportimi dhe shqyrtimi transparent i buxhetit janë siguruar.
- Parimi 6:** Kuadri operativ për kontrollin e brendshëm përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat, dhe zbatimi i tij nga organizatat buxhetore është në përputhje me legjislacionin që rregullon menaxhimin e financave publike dhe administratën publike në përgjithësi.
- Parimi 8:** Kuadri operacional për auditimin e brendshëm pasqyron standardet ndërkombëtare dhe zbatimi i tij nga organizatat buxhetore është në përputhje me legjislacionin që rregullon administratën publike dhe menaxhimin e financave publike në përgjithësi.
- Parimi 11:** Ekzistojnë kapacitete institucionale dhe administrative qendrore për të zhvilluar, zbatuar dhe monitoruar politikën e prokurimit në mënyrë efektive dhe efikase.
- Parimi 13:** Operacionet e prokurimit publik përputhen me parimet themelore të trajtimit të barabartë, mos diskriminimit, proporcionalitetit dhe transparencës, ndërsa sigurojnë përdorimin më efikas të fondeve publike dhe përdorimin më të mirë të teknikave dhe metodave moderne të prokurimit.
- Parimi 16:** Institucioni suprem i auditimit zbaton standardet në një mënyrë neutrale dhe objektive për të siguruar auditime me cilësi të lartë, të cilat ndikojnë pozitivisht në funksionimin e sektorit publik.

Ndërsa këto parime vlerësohen plotësisht nga SIGMA, WeBER përqendrohet dhe rrit elementet e transparencës dhe mundësisë së përdorimit të informacionit, komunikimit të jashtëm, si dhe qasjet proaktive dhe miqësore ndaj qytetarëve për informimin e qytetarëve.

Si një zhvillim shtesë që nga monitorimi fillestar, u zhvillua një tregues i ri për të mbuluar nën-

91 Në dispozicion në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/E9D97D58-F376-41CB-96DE-A957A711ABD2.pdf>

92 Raporti i KE-së për Kosovës, (2020). Në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

93 Ibid.

94 Ligji Nr. 04/L-042 mbi Prokurimin Publik. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

95 Strategjia Kombëtare e Prokurimit Publik 2017-2021 dhe Plani i tij i veprimit janë në dispozicion në <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Home&LID=2&PCID=-1&CtlID=HTMLStatic&CID=PPRCNews&ID=234>.

96 OECD/SIGMA Institucioni Qendror i Prokurimit Publik në Ballkanin Perëndimor (me shembuj të zgjedhur të vendeve të BE-së). Letra Sigma nr.60 (2020)

fushën e prokurimit publik të MFP (Parimet 11 dhe 13 të SIGMA-s), i cili nuk u monitorua në ciklin e parë, dhe si rezultat katër indikatorë u matën në këtë publikim të Monitorimit të RAP. Me këtë shtesë, studiuesit e WeBER monitoruan politikën e prokurimit publik për herë të parë, së bashku me politikën vjetore të buxhetit, KBFP-në dhe auditimet e jashtme. Ndërsa u mat për herë të parë, treguesi mbi prokurimin publik në këtë publikim të monitorimit të RAP përcakton vlerat fillestare në këtë fushë.

Treguesi i parë vlerëson transparencën dhe mundësinë e pranimit të dokumenteve buxhetore, duke matur se sa të arritshme janë për qytetarët dokumentet kryesore buxhetore (siç janë buxheti vjetor i nivelit shtetëror dhe raportet e ekzekutimit të buxhetit), si dhe në çfarë mase prezantohet dhe përshatet informacioni buxhetor me nevojat e qytetarëve dhe shoqërisë civile. Për këtë qëllim, burimet kryesore në internet janë të dhënat e disponueshme në faqet e internetit të ministrive të ngarkuara me financat dhe të dhënat e disponueshme për to, si dhe portalet zyrtare qeveritare dhe portalet e të dhënave të hapura.

Treguesi i dytë mat disponueshmërinë dhe komunikimin e informacionit thelbësor për KBFP-së tek publiku dhe palët e tjera të interesit (përfshirë raportimin e konsoliduar, rishikimet e cilësisë së AB dhe informacionin procedural të MFK). Analiza konsideron faqet zyrtare të internetit dhe dokumentet në dispozicion nga institucionet qeveritare të ngarkuara me politikën e KBFP-së. Faqet e internetit të të gjitha ministrive janë analizuar për disponueshmërinë e informacionit specifik në lidhje me MFK-në, ndërsa dokumentacioni zyrtar parlamentar shërben për matjen e rregullsisë së kontrollit parlamentar të KBFP-së.

Në fushën e auditimit të jashtëm, qasja e treguesit merr në konsideratë praktikën e jashtme të komunikimit dhe bashkëpunimit të ISA me publikun. Kjo fushë përfshin ekzistencën e qasjeve strategjike, mjetet e komunikimit të përdorura, mirëdashjen e qytetarëve të raportimit të auditimit, ekzistencën e kanaleve për raportimin e çështjeve të identifikuar nga palët e jashtme të interesit dhe konsultimet me shoqërinë civile. Për këtë qëllim, u përdor një kombinim i analizave të ekspertëve të dokumenteve të ISA dhe analizave të faqeve të internetit të ISA, të plotësuara me intervista gjysmë të strukturuar me stafin e ISA për të mbledhur informacione shtesë ose që mungojnë.

Së fundmi, në fushën e prokurimit publik, treguesi mat disponueshmërinë e informacionit në lidhje me prokurimin publik për publikun. Ai përqendrohet në faktin nëse autoritetet qendrore të prokurimit dhe autoritetet kryesore kontraktuese publikojnë plane dhe raporte vjetore, si dhe sesa janë portalet qendrore informuese dhe miqësore për qytetarëve lidhur me prokurimin publik. Për më tepër, ky tregues shqyrton disponueshmërinë e të dhënave të prokurimit të hapur, si dhe përqindjen e proceseve të prokurimit publik të zhvilluara në procedura të hapura. Ky tregues bazohet tërësisht në rishikimin e dokumentacionit zyrtar mbi politikën e prokurimit publik.

7.3. Rezultatet e monitorimit të WeBER

Parimi 1: Qeveria ka zhvilluar dhe miratuar një agjendë efektive të reformës së administratës publike që adreson sfidat kryesore

Parimi 5: Raportimi dhe shqyrtimi transparent i buxhetit janë siguruar

Treguesi i WeBER MFP P5_I1: Transparenca dhe qasja e dokumenteve buxhetore

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Buxheti vjetor i miratuar është lehtësisht i qasshëm në internet	4/4	4/4
Raportet e ekzekutimit të buxhetit brenda vitit janë lehtësisht të qasshme në internet	4/4	4/4
Raportet e ekzekutimit të buxhetit në mes të vitit janë lehtësisht të qasshme në internet	4/4	4/4

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Raportet e ekzekutimit të buxhetit (në vit, në mes të vitit, në fund të vitit) përmbajnë të dhëna për shpenzimet e buxhetit për sa i përket klasifikimit funksional, organizativ dhe ekonomik	2/4	2/4
Raporti vjetor përmban informacion jo-financiar në lidhje me performancën e Qeverisë	0/2	0/2
Prezantimi zyrtar i buxhetit vjetor miqësor për lexuesit (Buxheti i Qytetarëve) është i publikuar rregullisht në internet	2/4	4/4
Të dhënat buxhetore publikohen në formatin e të dhënave të hapura	2/2	2/2
Rezultati i përgjithshëm	18/24	20/24
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5)	4	4


Analiza e informacionit buxhetor dhe dokumentet përkatëse tregojnë rezultate shumë të kënaqshme, të njëjta si në monitorimin e mëparshëm për sa i përket transparencës dhe disponueshmërisë së të dhënave. Buxheti vjetor i miratuar është në dispozicion në faqen e internetit të Ministrisë së Financave dhe mund të gjendet në më pak se tre klikime larg faqes kryesore; duke i bërë ato shumë lehtë të qasshme për publikun. Raportet vjetore të ekzekutimit të buxhetit mujor, tremujor, gjashtëmujor dhe vjetor janë të gjitha në dispozicion në internet, dhe gjithashtu lehtësisht të arritshme. Raportet mujore të ekzekutimit të buxhetit publikohen dhe azhurnohen në kohën e duhur në një bazë të dhënash të konsoliduar në Excel që përfshin të dhëna të shpenzimeve mujore që nga janari i vitit 2006.

Këta skedarë janë në dispozicion në një skedar Excel të shkarkueshëm (format i të dhënave të hapura) dhe pa pagesë. Raportet e vjetore paraqiten në një mënyrë shumë gjithëpërfshirëse, dhe përfshijnë të dhëna të hollësishme bazuar në ekzekutimin e shpenzimeve të çdo institucioni lokal dhe qendror d.m.th. shpenzimet për paga dhe mëditje, shpenzime për mallra dhe mëditje, shpenzimet për subvencione dhe transfere, shpenzimet kapitale, shpenzimet për shërbimin e borxhit, etj. në krahasim me mesin e vitit, ku klasifikimi funksional ofrohej vetëm mbi pagesat për Covid-19.

Në këtë mënyrë, raportet e buxhetit paraqiten vetëm sipas klasifikimit ekonomik dhe organizativ. Klasifikimi funksional nuk ishte i dukshëm dhe raportet përmbajnë vetëm informacion financiar.

Si qëndron KOSOVA në aspektin rajonal?

Treguesi P5_I1: Transparenca dhe qasja e dokumenteve buxhetore



Parimi 6: Korniza operationale për kontrollin e brendshëm përcakton përgjegjësitë dhe kompetencat, dhe zbatimi i tij nga organizatat buxhetore është në përputhje me legjislacionin që rregullon menaxhimin e financave publike dhe administratën publike në përgjithësi;

Parimi 8: Kuadri operacional për auditimin e brendshëm pasqyron standardet ndërkombëtare dhe zbatimi i tij nga organizatat buxhetore është në përputhje me legjislacionin që rregullon administratën publike dhe menaxhimin e financave publike në përgjithësi.

Treguesi i WeBER MFP P6_8_I1: Disponueshmëria publike e informacionit mbi kontrollet e brendshme financiare publike dhe shqyrtimi parlamentar

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
Raporti vjetor i konsoliduar i KBFP-së hartohet dhe publikohet rregullisht në internet	0/4	0/4
Rishikimet cilësore të raporteve të auditimit të brendshëm hartohen dhe publikohen rregullisht në internet	0/2	0/2
Ministritë publikojnë informacione në lidhje me menaxhimin dhe kontrollin financiar	0/2	0/2
NJQH në mënyrë pro aktive angazhohet me publikun	0/2	0/2
Kuvendi rregullisht diskuton/shqyrton raportin e konsoliduar të KBFP-së	0/2	2/2
Rezultati i përgjithshëm	0/12	2/12
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5)	0	0

Ministria e Financave harton raportet e KBFP-së, por këto raporte nuk janë publike. Duke pasur parasysh faktin që komisione të caktuara parlamentare diskutojnë raportet, është e qartë që raportet prodhohen, por ato nuk janë në dispozicion të publikut.


Sa i përket rishikimeve të cilësisë, asnjë raport mbi auditimin e brendshëm nuk është publikuar për dy ciklet e fundit të raportimit. Drejtorit të NJAB-së i kërkohet të ketë vëmendje të veçantë për sigurimin e cilësisë. Një program i sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë është krijuar për të mundësuar një vlerësim të përputhshmërisë së veprimtarisë së auditimit të brendshëm me Standardet dhe një vlerësim nëse auditorët e brendshëm zbatojnë Kodin e Etikës. Programi gjithashtu vlerëson efikasitetin dhe efektivitetin e aktivitetit të auditimit të brendshëm dhe identifikon mundësitë për përmirësim. Shefi ekzekutiv i auditimit duhet të inkurajojë mbikëqyrjen e bordit në programin e sigurimit të cilësisë dhe përmirësimit. Duhet të theksohet se monitorimi i mëparshëm deklaroi që NJQH ka përgatitur një raport vjetor mbi progresin e zhvillimit të KBFP-së. Ky raport përfshiu informacione gjithëpërfshirëse, përfshirë statistikat dhe gjendjen në zbatimin e kontrollit të brendshëm në organizatat e sektorit publik. Gjetjet e SIGMA-s mbi monitorimin e mëparshëm demonstrojnë, megjithatë, se zbatimi i menaxhimit të rrezikut është akoma në një nivel të ulët.

Një vlerësim i përgjithshëm i rrezikut për të gjitha organet shtetërore është bërë nga Ministria e Financave në vitin 2019, në thelb është një raport mbi zbatimin e reformave për administratën publike mbi strategjinë e reformës për menaxhimin e financave publike 2016-2020. Dhe përveç Ministrisë së Financave, asnjë nga Ministritë nuk ka informacion mbi regjistrat e rreziqeve dhe librin e procedurave. Faqja e internetit e Ministrisë së Financave dhe mediave të saj sociale dhe raportet e konsoliduara të NJQH u analizuan për të identifikuar aktivitetet në lidhje me publikun për periudhën e monitorimit. Dëshmitë e njoftimit me publikun përfshijnë seksionin në faqen e internetit të ministrisë me titull "Divizioni për Komunikim Publik" dhe seksionin me titull "Lajmet", si dhe broshurat e Auditimit të Brendshëm. Manualët për vitin 2020 janë në dispozicion në internet në mënyrë proaktive dhe angazhimi me publikun u bë përmes njoftimeve për shtyp dhe paraqitjeve në media. Nuk ka pasur asnjë diskutim parlamentar për raporte të tilla në periudhën kohore në fjalë. Legjislacioni gjatë kësaj periudhe monitorimi ishte jofunksional për shkak të pandemisë dhe paqëndrueshmërisë politike që çuan në dy qeveri të ndryshme brenda një

periudhe 10 mujore. Kuvendi zbatoi më pak se 10% të programit të tij legjislativ. Provat nga ciklet e mëparshme të raportimit treguan se Kuvendi dhe komiteti përkatës rregullisht diskutonin mbi raportet e konsoliduara për KBFP; gjetjet kryesore u diskutuan në qershor të vitit 2016 dhe 2017, duke treguar një ndryshim negativ të treguesit.

Si qëndron Kosova në aspektin rajonal?

Treguesi MFP P6_8_I1: Disponueshmëria publike e informacionit mbi kontrollat e brendshme financiare publike dhe shqyrtimi parlamentar



Parimi 16: Institucioni suprem i auditimit zbaton standardet në një mënyrë neutrale dhe objektive për të siguruar auditime me cilësi të lartë, të cilat ndikojnë pozitivisht në funksionimin e sektorit publik.

Treguesi i WeBER MFP P16_I1: Komunikimi dhe bashkëpunimi i Institucionit Suprem të Auditimit me publikun që ka të bëjë me punën e tij

Elementet e treguesit	Rezultati 2019/2020	Rezultati 2017/2018
ISA zhvillon një strategji komunikimi për të arritur deri te publiku	4/4	0/4
ISA ka dedikuar të paktën një pozicion pune për komunikim pro aktiv dhe sigurimin e reagimeve ndaj publikut	2/4	2/4
ISA përdor mënyra të ndryshme të komunikimit me publikun	1 / 2	1/2
ISA prodhon përmbledhje miqësore ndaj qytetarëve të raporteve të auditimit	0/4	4/4
Janë zhvilluar kanale zyrtare për dorëzimin e ankesave ose iniciativave tek ISA nga palët e jashtme të interesit (publiku i gjerë, OSHC-të)	0/2	0/2
ISA konsultohet me OSHC-të dhe punën e tyre me qëllim të identifikimit të rreziqeve në sektorin publik	2/2	2/2
Rezultati i përgjithshëm	9/18	9/18
Vlera e treguesit (shkalla 0 – 5)	3	3

Në monitorimin e mëparshëm ZKAK nuk kishte një strategji specifike të komunikimit, ndërsa monitorimi i vitit 2020 njehe se një Strategji të Komunikimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës për periudhën 2020 - 2022 është zhvilluar me qëllime dhe objektiva të përcaktuara për ZKAK. Dokumenti është në përputhje me Planin e tij Strategjik 2018-2021. Në strategji është treguar që ZKAK duhet të mbajë marrëdhënie të mira me degët ekzekutive dhe legjislative për të inkurajuar zbatimin dhe për të lehtësuar mbikëqyrjen dhe llogaridhënien publike. Plani do të

rishikohet çdo vit dhe do të jetë nën departamentin e komunikimit brenda ZKAK.

